



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË



AKADEMIA E SHKENCAVE
TIRANË



FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË

KONFERENCË SHKENCORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË ATHANAS TASHKOS

(përmbledhje materialesh)

Korçë, 13 nëntor 2015



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË



AKADEMIA E SHKENCAVE
TIRANË



FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË

KONFERENCË SHKENCORE KUSHTUAR JETËS DHE VEPRËS SË ATHANAS TASHKOS

(përmbledhje materialesh)

Korçë, 13 nëntor 2015

REDAKSIA PËR BOTIMIN

Prof. dr. ALI JASHARI

Akad. JORGO BULO

Akad. FLORESHA DADO

Dr. PANDI BELLO

Prof.as.dr. DION TUSHI

Redaktimi dhe përgatitja për botim: Msc. OLGËR BRAME

Shtypshkronja "KOTTI" Korçë

ISBN:

Shkurt, 2016

Pasqyra e lëndës

Kronikë	5
FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS	6
Akad. FLORESHA DADO	
ATHANAS TASHKO DHE KOLONIA SHQIPTARE NË EGJYPT (1863-1915).....	7
Akad. JORGO BULO	
FAN NOLI TASHKOS – NJË LETËRKËMBIM SHOKËSH IDEALI	12
Prof. NASHO JORGAQI	
THANAS TASHKO: “BIR I BEKUAR I SHQIPËRISË”	16
Dr. PANDI BELLO	
ATHANAS TASHKO DHE KORÇA.....	22
ENO KOÇO	
SI E KAM PËRFYTYRUAR IMAZHIN E GJYSHIN TIM	27
Dr. RRAPO ZGURI	
ATHANAS TASHKO MES GAZETARIT DHE MISIONARIT	33
Prof. dr. ALI JASHARI	
PËR LIBRIN E ENO KOÇOS KUSHTUAR ATHANAS TASHKOS	41
Prof. as. dr. ANYLA SARAÇI (MAXHE)	
PIKËPYETJET E ATHANAS TASHKOS (Një vështrim pragmalinguistik në shkrimet e A. Tashkos).....	43
Prof. as. dr. DION TUSHI	
AMBIENTI KORÇAR PËRGJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEKULLIT XIX DHE ATHANAS TASHKOJA	50
Dr. ERIS RUSI	
MANJOLA TËRSHANA	
LIRIA NËN PSEUDONIM DHE KRITIKA SARKASTIKE NË PUBLICISTIKËN E ATHANAS TASHKOS	54
Dr. ILIR SHYTA	
THANAS TASHKO DHE EPISTOLARI FAMILJAR	62
Prof.as.dr. IRENA NIKAJ	
ATHANAS TASHKO-FRASHËRLIU ENTUZIAST. RILINDASI QË ME MENDJE DHE SHPIRT PUNOI PËR SHQIPËRINË PERËNDIMORE EVROPIANE.....	67
Prof.as.dr. JONELA SPAHO	
ATHANAS TASHKO DHE GAZETA “SHKOPI”	69

Msc. NELI NAÇO

IDE DHE MESAZHE NË LETRAT E ATHANAS TASHKOS DËRGUAR
VEPRIMTARËVE SHQIPTARË77

Msc. OLGER BRAME

KUNDRIME GJUHËSORE MBI PUBLICISTIKËN DHE LETËRKËMBIMIN E
ATHANAS TASHKOS82

Dr. SOKOL SUPARAKU

SHEMBULLI I ATHANAS TASHKOS MBI ZHVILLIMIN E IDENTITETIT ETNIK
SHQIPTAR.....87

Kronikë

Në datën 13 nëntor 2013, në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, zhvilloi punimet konferenca shkencore kushtuar jetës dhe veprës së patriotit Athanas Tashko.

Konferenca u zhvillua nga Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë i këtij fakulteti, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Në konferencë morën pjesë studiues nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, pedagogë të Universitetit të Korçës, të Fakultetit të Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, familjarë, mësues, studentë dhe admirues të veprës filantropike të patriotit Athanas Tashko.

Konferenca i filloi punimet me fjalën e hapjes së dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë prof. dr. Ali Jasharit, si dhe përshëndetjen e rastit të rektorit, prof. Gjergji Mero.

Në fjalën e tij rektori i Universitetit, prof. Gjergji Mero theksoi se kjo konferencë është vazhdim i ndihmesave që Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka ndërmarrë, për t'u dhënë sa më shumë dritë figurave të tilla, duke ua transmetuar veprën e tyre brezave, me qëllim që të mësojnë për historinë, punën dhe veprimtarinë e vazhduar e të ulerësuar, që kanë bërë njerëz të tillë me përmasa kombëtare.

Me propozim të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i dha patriotit Athanas Tashko titullin "Zytetar Nderi", pas udekjes, me motivacionin: "Personalitet i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, publicist e filantrop, i cili me jetën dhe veprën e tij mbrojti kombin shqiptar dhe shkollën shqipe". Titulli iu dorëzua mbesës së patriotit, Eva Papa, nga nënkryetarja e Këshillit të Bashkisë, zonja Evis Miço.

Në emër të Bashkisë së qytetit përshëndeti nënkryetarja e Bashkisë, zonja Benila Teroua.

Më pas u bë prezantimi i librit kushtuar jetës së Athanas Tashkos, shkruar nga nipi i tij, Eno Koço.

Konferenca i vazhdoi punimet me leximin e referatit kryesor dhe kumtesave kushtuar anëve të ndryshme të veprës së Athanas Tashkos.

Punimet e kësaj konference i përcollën edhe mediat televizive lokale dhe kombëtare.

FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS

Prof.dr. Ali Jashari

Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

Të nderuar pjesëmarrës!

Në emër të stafit akademik të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, ju falënderoj që jeni pjesë e kësaj veprimtarie, të cilën ne e organizojmë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, duke përmendur pjesëmarrjen e veçantë të akademikëve dhe profesorëve Nasho Jorgaqi, Jorgo Bulo, Floresha Dado dhe Rrapo Zguri, si dhe përkushtimit të pedagogëve të fakultetit tonë në përgatitjen e kumtesave për këtë konferencë.

Falënderoj familjarët që marrin pjesë në këtë veprimtari, si dhe Këshillin Bashkiak të Korçës që miratoi propozimin e stafit akademik të fakultetit për dhënien e titullit “Qytetar nderi” Athanas Tashkos.

Idenë për organizimin e një veprimtarie të tillë e dha dr. Pandi Bello, një intelektual i shquar i qytetit të Korçës, një propozim që u miratua menjëherë nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë. Dua të përmend veçanërisht ndihmesën bujare të z. Eno Koço për përgatitjen e kumtesave për këtë konferencë.

Besoj se punimet e kësaj konference do t'i shërbejnë përmbushjes së nismës që ka ndërmarrë fakulteti ynë për të studiuar dhe nxjerrë në dritë jetën dhe veprën e figurave të shquara historike të qytetit të Korçës, si një akt nderimi për vlerësimin e tyre, çka realizon njëherësh edhe dëshirën e shumë qytetarëve korçarë, sikurse janë konferencat dhe simpoziumet për Ilo Mitkë Qafëzezin, Mihal Gramenon, Sotir Pecin, Fan Nolin, Hafiz Ali Korçën, Thimi Mitkon etj., materialet e të cilave janë pjesë e kolanës së botimeve të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë.

Faleminderit!

Akad. FLORESHA DADO
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Tiranë

**ATHANAS TASHKO DHE KOLONIA SHQIPTARE NË EGJYPT
(1863-1915)**

Dihet se fundi i shekullit XIX dhe dy dhjetvjeçarët e fillimit të shekullit XX ishin vitet më aktive në historinë e lëvizjes së shqiptarëve për çështjen kombëtare. Kjo lëvizje përfshinte patriotë, intelektualë të shquar në vende të ndryshme, ku shqiptarët vepronin ose individualisht, në marrëdhënie me miq të idealeve të përbashkëta, por edhe të organizuar në shoqëri të gjera, duke konfirmuar koloni të shqiptarëve në disa vende. Egjipti ishte një ndër qendrat më aktive të organizimit të lëvizjes për çështjen kombëtare. Që në vitin 1869, Dora D'Istria shkruante :”Në Egjipt...ku shqiptarët gëzojnë një influencë të madhe, gjenden shumë patriotë që interesohen për ditë e më shumë për fatet e kombit.” Ndonëse përpjekjet për të krijuar shoqërinë “Vëllazëria” nuk qenë të suksesshme që në fillim, përpjekjet për aksione patriotike, të llojeve të ndryshme, ishin të pandërprera. Rezultatet ishin jo të vogla : krijimi i shoqërisë “Vëllazëria e shqiptarëve”, rritja e komunikimit me shqiptarë të shpërndarë në vende të tjera. Më 18 janar 1905, Thoma Avrami e lajmëronte nga Kajroja Asdrenin: “e lamë të bëjmë një shoqëri të fortë këtu, e cila të lidhet dhe me shoqëri të tjera që janë jashtë Shqipërisë dhe të punojnë si të jetë më mirë për çështjen tonë”.

Në shtator të vitit 1908, me iniciativën e Fehim Zavalanit, që vinte nga Manastiri, anëtarët e shoqërisë së Egjiptit organizuan një mbledhje të gjerë për nevojën e bashkëveprimit të të gjithë shqiptarëve, ku u krijua një komitet dhe u vendos që delegati i Egjiptit, të bashkohej me delegatët e Shqipërisë, të kolonive shqiptare të Rumanisë dhe të Amerikës dhe, së bashku, të parashtronin para qeverisë turke tri kërkesa themelore: njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare e vendit, njohjen e kombësisë shqiptare si dhe ndihmën e qeverisë për mbrojtjen e shkollave. Elementëve më të shëndoshë të kësaj shoqërie iu desh të luftonin jo vetëm kundër synimeve proxhonturke, por edhe kundër pikëpamjeve filogreke të disa personave që kishin siguruar madje njëfarë emri në kolonitë e atjeshme. Aktivitetet janë të shumta.

Patriotët shqiptarë të Kolonisë së Egjiptit vepronin në qendra të ndryshme, në të katër anët e Egjiptit. Krahas Kajros, Aleksandrisë, Mansurah etj., në Fajum e rreth, në jug

të Kajros, jetonin shumë shqiptarë. Sipas vëzhgimeve dokumentare të studiuesit N.Jorgaqi, lëvizja kombëtare në këto vise të jugut të Nilit ishte më e organizuar dhe më e gjallë se në veri... Shpirti i kësaj lëvizjeje dhe promotori i bashkimit të shqiptarëve, një ndër patriotët më aktivë, ishte Thanas Tashkoja, figura e të cilit meriton të ndriçohet më mirë. Pse? Sepse pas një emri, një individi vjen një ideal i rëndësishëm, dritësohet një moment apo situatë pak e njohur, plotësohet një pjesë e historisë sonë të çerekut të parë të shekullit XX. Aktiviteti dhe jeta e shqiptarëve në këtë rajon lidhet, pra, me këtë figurë të shquar mëmëdhetari, i cili sigurisht ka gjithnjë pranë vetës Jani Vruhon, me të cilin përballoi disa aksione kulturore-patriotike.

Figurën e Thanas Tashkos mund ta ndjekim në dy plane: 1. Egjipt (Fajum), ku ishte i pranishëm, dhe 2. Shqipëri (më e reduktuar), përmes letërkëmbimeve, shkëmbimit të informacioneve mbi lëvizjet politike që shoqëronin situatat, në mbështetje të përpjekjeve për hapjen e shkollave shqipe në Korçë.

Në historinë e lëvizjes patriotike të shqiptarëve të Fajumit ka hyrë “Grand Hotel Karoun”, hotel-restoranti i Tashkos, i cili shumë shpejt u bë qendra ku mblidheshin shqiptarë dhe diskutonin për çështjen shqiptare. Atmosferë shqiptare,- shkruan N.Jorgaqi: “ Thanas Tashkoja, me natyrën energjike, vepruese dhe praktike kish hedhur farën e shqiptarizms në Fajum, dhe ishte bërë qendra e bashkimit dhe koordinimit si me shqiptarët e Fajumit, ashtu dhe me shumë patriotë që jetonin në vende të tjera. ... Hoteli ish kthyer në një klub mbledhjesh dhe diskutimesh atdhetare, vendi ku vinin gazeta e libra nga Bukureshti e Sofia, letra nga Stambolli, Amerika, Kalabria, lajme nga Shqipëria. Në këtë restorant takoheshin shqiptarë nga vende dhe mjedise të ndryshme, poetë, intelektualë, gazetarë, folkloristë, gjuhëtarë. Ishte krijuar pra, një traditë kulturore në Misir. Aty strehoheshin edhe politikanë shqiptarë, kundërshtarë të Sulltanit apo Patriarkanës, etj., si Çajupi, F.Shiroka, Milo Duçi, Sotir Koleja etj. Athanas Tashkoja duket person i rëndësishëm në letra, mendime, shumë patriotë i kërkojnë ndihma, për shkolla, klube etj.

Lidhjet e Tashkos me kolonitë shqiptare të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes dhe më pas me arbëreshët e Italisë dhe shqiptarët e Amerikës, risjellin me të dhëna konkrete situata të ndryshme të lëvizjes sonë kombëtare, qartësojnë marrëdhëniet midis patriotëve të ndryshëm, dëshmojnë për vështirësitë dhe nevojat e ngutshme me të cilat përballej lëvizja kombëtare shqiptare. Tashkos i vijnë letra të shumta nga figura të lëvizjes patriotike, nga Amerika si Noli. Ai nga ana tjetër jep udhëzime për organizimin e lëvizjes në Amerikë, ku, me nxitjen e tij dhe të Jani Vruhosh, dërgohet Noli për të rigjallëruar lëvizjen shqiptare për çështjen kombëtare.

Duke punuar për mbarëvajtjen e shoqërisë patriotike të shqiptarëve të Egjiptit, ai, përmes mbështetjes që i dha Nolit, ishte ndër ata që kontribuan në ngritjen kolonisë së shqiptarëve në SHBA, mbante lidhje të vazhdueshme me udhëheqës të njohur të lëvizjes kombëtare etj. Botoi me pseudonimin “dera” gazetën satirike “Shkopi” si dhe shumë artikuj në organe të tjera të shtypit shqiptar. Në 1914 erdhi në atdhe, por me rënin e qeverisë së princ Vidit u kthye përsëri në Egjipt, por, dihet se në gjirin e kolonisë së Egjiptit, kishte edhe shumë mosmarrëveshje, siç ishte p.sh. midis Çajupit dhe figurave kryesore si Dr. Adhamidh Frashëri etj. Mosmarrëveshje të tilla pati edhe Tashkoja me figura të Kolonisë së Egjiptit. Në një letër që i drejtonte Sotir Pecit, më 11 gusht 1906, ai shprehte keqardhjen për faktin se Kolonia e Egjiptit nuk ishte në lartësinë e kërkesave që shtronte lëvizja patriotike.

“Shumë herë jemi maturë të bëjmë vëllazëri (shoqëri - F.D.) që të dukemi dhe ne se jemi të gjallë, dhe të gjitha herët përveç ave (laved - F.D.) e lëvdata asgjë tjetër s’kemi bërë, shkruante ai... Tani po të them edhe për ata veta që janë shkaku i prapësirës këtu në Egjipt dhe u lutem të mos pandehin se kam ndonjë zemërim të veçantë mbë zotërinë e tyre, po të besojnë me të vërtetë se u flas nga zjarri dhe për detyrën që kam. Shkakëtarë të prapësisë kanë qënë Dr. M. Turtulli dhe Dr. G. Adhamidhi, se po të ishin këta zotërinj mëmëdhetarë të vërtetë sa në fjalët ashtu edhe në punë, do të ishin bërë të gjitha ato që thamë më sipër, apo të mos ishim fare në Egjipt, prapë do ishin bërë, në mos të tëra, gjysmake”.

Fan Noli, i cili para pak kohësh kishte qënë në shoqërinë e Egjiptit dhe ishte larguar në Bufalo të SHBA-ve, duke njohur mirë rrethanat e brendshme të kolonisë, në një artikull, si përgjigje e letrës së Doras (Th. Tashkos) shkruante: *“Sa për Adhamidhin dhe Turtullin, kush ju tha se këta zotërinj mund të bëhen krerë? Që të dy s’duen, se s’janë të zotërit për një të këtillë trimëri. Turtulli është grekoman, dhe s’hyn fare në hesap. Adhamidhi prapë është besnik i një feje që quhet “viç i florinjte”. Të tëra mund t’i bëjë për shqiptarët, veç në fet të tij mos e ngash”.*

Po aq ashpër do të shprehej edhe gazeta “Rrufeja”, që do të dilte një vit më vonë si edhe J. Vruhoja e A.Tashkoja në letërkëmbimin me Sotir Kolenë. (në 14.V.1909 Tashkoja shkruan :” Digjo tani, Turtulli, Adhamidhi dhe Voilla (për mua sikur edhe dynjaja të përbyset) janë vënë nga “Elinismosi” për të kallur çarje midis shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë.) Çajupi edhe miqtë e tij më të mirë vazhdojnë përpjekjet për ta gjallëruar veprimtarinë e kolonisë shqiptare në Egjipt dhe për të demaskuar ata që i konsideronin si elementë turkomanë e grekomanë.

Një ndër organet e rëndësishme të kësaj kolonie ishte Gaz Shkopi – (1907-1908), një gazetë satirike, politike e shoqërore (një pjesë e shkrimeve edhe greqisht). E themeluar dhe e drejtuar nga Athanas Tashkoja, në bashkëpunim edhe me patriotin Jani Vruho, ajo përkrahu fuqishëm luftën për çlirim kombëtar, botoi portretet e figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare, kritikoi grekomanë e turkoshakë. Numuri i parë i saj u shtyp më 10 mars 1907, në shtypshkronjën “Mbrodhësia” në Sofje. Vijoi edhe më 1908. Vlerësohet nga shumë patriotë, si Noli etj. Në mënyrë të veçantë lidhjet me Kristo Luarasin prej të cilit merr informacione për shpërndarjen e “Shkopit”, për numura të ndryshëm, janë të vazhdueshme. Nga ana e tij botuesi komunikon edhe për të kërkuar artikuj për t’i botuar.

Duket se lidhja është e ngushtë, diskuton për çështje patriotike. Merr falenderime për mbështetjet financiare. Ndërkohë lidhjet e Tashkos dhe Vruhosh me gazetën “Drita” të Shahin Kolonjës, si bashkëpunëtorë, me artikuj politikë, vjersha patriotike, etj., dëshmonin një bashkërendim të menduar mbi çështjen kombëtare.

Gazeta “Shkopi”, mbante një qëndrim kritik ndaj atyre që i cilësonte si “grekë të flaktë”, të cilët, siç shkruan ajo gazetë, “kanë pirë ujin e Athinës, përpiqen me mish e me shpirt të ngjallin me pahir elinizmën”, apo ndonjë që e satirizonte si “Xhon Tyrk i flaktë”.

Por, gjatë 1905-1915 Thanas Tashkoja zhvillon një korrespondencë të gjerë me figura të shquara si Kristo Luarasi, Shahin Kolonja, S. Kolea, A. Xhuvani, Noli etj...

Roli patriotik i Tashkos, në gjirin e Kolonisë së Egjiptit, lidhet jo vetëm me aktivitetin energjik patriotik, por edhe me kontribute të vyera financiare që i shkonin në ndihmë çështjes kombëtare shqiptare. Ai ndihmoi materialisht për çeljen dhe mbajtjen e shkollave shqipe, për botime të ndryshme etj. Letërkëmbimet e disa patriotëve hedhin dritë pikërisht në këtë aspekt sa patriotik, aq edhe humanitar.

Kështu, Kristo Luarasi, i shkruante Andon Zakos: “Mora me anë të Z.J.P. Vruhosh të hollat që dhatë për shtypshkronjën, “Mbrodhësia”... U falem ndersë për ndihmën që bëtë për shtypshkronjën, kjo më jep kurajo të madhe që të punoj më me zell se kam patriotë me ndjenja të nalta, ndonëse shumë të pasur s’kanë marrë pjesë në punën e shënjtëruar për tërë kombin”. Njëherazi ai i shkruan dhe J.Vruhosh : Puna u vërteton mëmëdhetarinë që kini në shpirt ashtu edhe ... (s’lexohet - F.D.) Z. Athanas Tashko dhe Andon Çako. U lumtë!”.

Siç thamë më sipër, veprimtarinë e Athanas Tashkos mund ta ndriçojmë edhe lidhur me ato çka ndodhnin në Shqipëri. Ndonëse larguar prej vitesh, ai ishte në kontakt të

vazhdueshëm me patriotë, prej të cilëve merte informacion. Me ardhjen e princ Vedit, Thanas Tashkoja erdhi në Shqipëri, por me ikjen e princit, ai u largua përfundimisht për të mos u kthyer më. Megjithatë ai ndoqi vazhdimisht situatën në vendin e tij, për të qenë menjëherë reagues ndaj ngjarjeve që rrezikonin vendin. Kështu patrioti Milo Duçi shkruan për ngjarjet e Korçës lidhur me kërkesën e një grupi për ta shkëputur Korçën nga Shqipëria. Ai e informon Tashkon se ka qenë në Kajro dhe e njeh me propozimet për t'i dërguar telegraf Ambasadorëve (Londër) për punën e Korçës. Krahas reagimit të ashpër që mbajti Çajupi dhe patriotë të tjerë, Tashkoja ishte ndër ata që kontribuan në kërkesën/memorandum drejtuar Fuqive të Mëdha, për ta lënë Korçën brenda kufijve të Shqipërisë.

Sigurisht aktiviteti i plotë i figurës së A.Tashkos, nuk mund të ndriçohet plotësisht në një konferencë si kjo e sotmja, por ajo çka thuhet sot nga studiues të ndryshëm në këtë takim, është e mjaftueshme për të kuptuar se figura të tilla, që dhanë kontribute të gjithanshme për çështjen kombëtare, kudo që ishin, mbeten një peng për historianët e sotëm, të cilët duhet të sjellin më afër memories dhe të vendosin nën ndriçim vlera të tilla të historisë sonë kombëtare.

Akad. JORGO BULO
Akademia e Shkencave
Tiranë

FAN NOLI TASHKOS – NJË LETËRKËMBIM SHOKËSH IDEALI

“Mëmëdhetar i dashur dhe vëlla i përmallshim” – këto pak fjalë me të cilat i drejtohet shpesh përmes letrave Noli Tashkos, përmbledhin gjithçka i ka lidhur të dy në një miqësi të gjatë dhe prekëse. Ideali i përbashkët atdhetar, por dhe ndjenja e një nderimi e dashurie njerëzore që ushqejnë ndaj njëri-tjetrit, i bën këto letra me interes të dyanshëm: si dokumente të historisë së lëvizjes kombëtare e kulturore të kohës dhe si dëshmi për të njohur anën njerëzore të këtyre dy veprimtarëve të shquar të Rilindjes Kombëtare.

Marrëdhënia e Tashkos me Nolin është disi e veçantë: një njohje kohësisht e shkurtër, dhe një miqësi jetëgjatë, madje përtej jetës tokësore të Tashkos; një butësi elegante në bashkëbisedimin e tyre përmes letërkëmbimit, por dhe një nerv kritike të hidhur në këto shkëmbime ose në replikat në shtypin e kohës, që, për çudi, nuk e lëndon në asnjë rast miqësinë e tyre dhe konsideratën për njëri-tjetrin, një mirënjohje pa fund për mbështetjen bujare edhe financiare që Tashkoja i ka dhënë Nolit, por dhe një krenari dinjitoze e këtij të fundit: “mirënjohës, por jo i nënshtruar të pranoj gjithçka që mëton, miku im”, ja çfarë shprehin përmes rreshtave disa nga letrat e tij.

I dashur, natyrisht, kur e falënderon dhe e bekon, por i dashur dhe kur e paralajmëron se do ta “mallkojë”, si dhe mikun tjetër Vruhon, që nuk i dërgojnë në kohë paratë që i duhen për të botuar shqip një nga librat kishtarë, a për të mbyllur historinë e martesës së tij me “priftëreshën misirleshë”, martesë që s’u realizua kurrë.

Noli që qëndroi vetëm tre vjet në Misir, u njoh nga afër me Tashkon më 1905, pasi mbylli aventurën e suflerit të teatrit shëtitës e të endacakut bohem, por kjo kohë e shkurtër njëvjeçare mjaftoi, si u tha, për një miqësi jetëgjatë. Ndikimi i Tashkos ishte vendimtar në rrjedhën e jetës dhe të veprimtarisë atdhetare të Nolit. Ky i ri, që e ndiente së brendshmi se kishte talentin e një

gjeniu dhe predestinimin e një mesie, që do të shpëtonte “llauzin e vet nga vuajtjet dhe fajet e veta”, iu bind sakaq “urdhrit” të një atdhetari të thjeshtë për t’u nisur drejt kontinentit të ri, për të zhvilluar atje veprën atdhetare. Rezulton vizionar ky “urdhër” i Tashkos; Nolit i duheshin hapësira të tjera, për të manifestuar fuqinë e Herkullit në shërbim të çështjes kombëtare.

Shqiptarët e Amerikës ishin diaspora më e re shqiptare, por me të ardhme dhe potenciale të mëdha në shërbim të kësaj çështjeje; vetë Amerika si fuqi botërore, siç e tregoi koha, ishte një mundësi me peshë vendimtare për të ardhmen e Shqipërisë. Sado që në fillim Amerika nuk i pëlqeu Nolit, atje atij iu dha rasti i artë, t’i shkëpuste presidentit Uillson premtimin e njohur “Kam një votë në Konferencën e Paqes dhe do ta përdor atë në favor të Shqipërisë”. Tashkoja, si duket e parandjeu, edhe pse nuk e arriti ta shihte të realizuar këtë premtim.

Letërkëmbimi i Nolit me Tashkon, që përfshihet në librin e Eno Koços që sapo morën në dorë, u përket viteve 1906-1913 dhe hedh dritë në veprimtarinë e dendur të Nolit në disa drejtime për të aktivizuar një lëvizje të gjerë dhe të organizuar të kolonisë shqiptare në ShBA, për të kurorëzuar projektin e madh të pavarësisë së Shqipërisë, por ato hedhin dritë edhe në disa anë të karakterit të Nolit dhe të marrëdhënieve të tyre me të tjerët. I vetëdijshëm për epërsinë e tij intelektuale, por dhe i vendosur si trashëgimtar i një brezi kapedanësh, për të mos e lënë fushën e betejës, ai pranon të kryejë rolin e ushtarit në bashkëpunimin me Pecin për botimin e “Kombit”, sado që veten e ndjen gjeneral. I zhgënjyer jo vetëm nga Amerika që iu duk, siç i shkruan Tashkos, “një botë e fëlliqur”, por më shumë i zhgënjyer nga shqiptarët që “e duan mëmëdhenë, por që nuk dinë si ta duan”, nuk lë pa shkelur katund e qytet ku banojnë shqiptarë për të zgjuar me fjalën e tij ndjenjën atdhetare dhe për t’i përfshirë të angazhuar në lëvizjen patriotike. Shpirt plebejan, që s’i honeps pasunarët injorantë, të cilët diku në letrat e tij i quan “gomerë me samar të florinjte”, nuk i kursen së fshikulluari për kurnacërinë e tyre edhe pse, për t’i nxitur të zgjidhin qesen, më vonë do të shkruante “mbaju nëno mos ki frikë – se ke djemtë në Amerikë!”

Intelektual që fle me Niçen nën jastëk, i dashuruar me filozofinë e tij që nxjerr para gjyqit të arsyes historinë dhe krishterimin, skeptik ndaj dogmës, aq sa nuk lë rast kur përmend perëndinë, të shtojë në kllapa (*që unë s'e besoj*), i kushtohet pikërisht organizimit të kishës shqiptare, si njeri i Perëndisë. Themelimi i Kishës Autoqefale Shqiptare është një nga veprat madhore të Nolit, jo thjesht si një akt fetar, por si një akt patriotik kombëtar. Në letrat që i dërgon Tashkos kjo temë trajtohet gjerësisht, sepse përbën një nga preokupimet më të mëdha të Nolit. Ai është i bindur se emancipimi i kishës shqiptare nga suzereniteti i Patriarkut të Stambollit ishte i domosdoshëm, sepse ky gëzonte disa të drejta sovraane, të cilat i përdorte kundër kombësive jogleke të Perandorisë, sidomos kundër shqiptarëve, d.m.th. kundër ndërtimit prej tyre të një kisha ortodokse jogleke. Patriarkana e Kostandinopojës ishte një shtet brenda shtetit turk, një armë politike që në rastin e ortodoksisë shqiptare përdorej kundër interesave të tyre nacionale.

Fan Noli, i iluminuar nga idetë e revolucionit francez, ishte, si gjithë rilindësit, për ndërtimin e një shteti shqiptar të bazuar jo mbi një fe a një mbret, por mbi një kombësi me kulturë dhe gjuhë të përbashkët. Prandaj projekti i themelimit të Kishës Autoqefale Shqiptare dhe kombëtarizimi gjuhësor i saj ishte një akt i madh edhe kulturor.

Letrat e Nolit dërguar Tashkos janë dëshmi e një angazhimi dhe përkushtimi të veçantë për ngritjen e kishës shqiptare të Shën Gjergjit në Boston, si një hap i parë i themelimit në Shqipëri të kishës Autoqefale dhe për pajisjen e saj me librat shqip të liturgjisë ortodokse. Ky angazhim i mori shumë energji Nolit, i krijoi probleme që vinin prej pengesave që krijonte propaganda greke, prej moskuptimeve që krijojnë vetë disa shqiptarë jo aq mendjehapur e vizionarë sa Noli dhe, pa dyshim edhe prej mungesës së burimeve financiare. Noli e fitoi dhe këtë betejë me vendosmërinë e luftëtarit të bindur, siç i shkruan Tashkos, se “edhe me vdekë, do t’i vdesë më parë trupi dhe pastaj kurajua”.

Letrat e Nolit dërguar Tashkos janë pjesë e trashëgimit të tij shpirtëror dhe një pasuri edhe për vlerat gjuhësore të ligjërit nolian, edhe për humorin dhe stilin e tyre. Botimi i tyre prej Eno Koços në librin kushtuar gjyshit të vet,

Athanas Tashkos, e vë këtë pasuri në dispozicion të lexuesit të sotëm dhe të studimeve për historinë e kulturës kombëtare dhe për njohjen e këtyre dy personaliteteve të mëdha të botës shqiptare.

Prof. NASHO JORGAQI

Tiranë

THANAS TASHKO-"BIR I BEKUAR I SHQIPËRISË"

Kështu do ta quante Fan Noli Athanas Tashkon dhe, për ta bërë më tokësor e cilësoi "Shok i kryqëzatës kombëtare", një vlerësim ky që përmbledh e mishëron gjithë meritat dhe kontributet e tij të shquara në luftën për kauzën e lirisë së Shqipërisë. Ai hyri në lëvizjen kombëtare si një luftëtar i thjeshtë dhe brenda një kohe të shkurtër, falë përkushtimit atdhetar, virtyeteve burrërore, mençurisë dhe trimërisë së urtë, të shprehura këto në veprimtarinë e tij patriotike, u bë një figurë qendrore e kolonisë shqiptare të Misirit.

I lindur në Frashër të Dangëllisë (1863), prej nga kishin dalë një plejadë e ndritur patriotësh dhe intelektualësh, Athanasi 20 vjeçar mërgoi së bashku me tre vëllezërit e tij në Afrikën e largët. Ishte kjo fillimisht një aventurë e Tashkollarëve të rinj për mbijetesë, duke marrë parasysh endjet e tyre nga një vend në tjetrin, ku dy nga vëllezërit lanë kockat, njëri në Jemen e tjetri në Madagaskar, ndërsa Athanasi u dha për një kohë pas gjuetisë së luanëve dhe panterave në Abisini, për t'u vendosur përfundimisht në Egjipt. Pa ndonjë shkollë për të qenë dhe pa ndonjë zanat, ai e përballon jetën duke nisur nga punë të rëndomta, si sheqerxhi e kafexhi, për të hapur pastaj ndonjë dyqan, deri sa me përpjekje dhe sakrifica arriti të bëhet hotelxhi. Ngriti në Fajum, 100 km larg Kairos, një hotel që e quajti "Grand Hotel Caroun", ku me kohë solli dhe familjen dhe më vonë ngriti dhe "Hotelin Moeris" buzë liqenit Karun", në mes të shkretëtirës. Me një punë të tillë Athanasi gjeti dhe afirmoi veten, duke i kthyer hotelet e tij nga lokalet më të frekuentuara për turistët e huaj dhe, ç'është më e rëndësishme, në qendra të patriotëve shqiptarë, aq sa do t'i quanin Teqe shqiptare. Emri i nderuar dhe mikpritja e pronarit, kushtet dhe komoditeti i hoteleve i bënë lokalet brenda një kohe të shkurtër vende të preferuara. Në rrethana të tilla Athanas Tashkoja krijoi bazën dhe hapësirat e nevojshme për veprimtarinë e tij politike. Misiri ishte i mbushur me koloni shqiptarësh dhe në një terren të tillë s'kishte si të mos lindte e vepronte prej kohësh lëvizja kombëtare. Këtë e dëshmonin shoqëritë patriotike dhe shtypi që botohej. Nga gjiri i tyre kish dalë Thimi Mitko, babai i folkloristikës shqiptare, që kishte botuar librin "Bleta shqiptare". Athanasi nuk e arriti këtë kohë, por në kohën e tij, në Misir jetonin e punonin figura të shquara

intelektualësh patriotë, si A. Z. Çajupi, F. Shiroka, S. Dine. L. Ligor, M. Duçi etj. Mes tyre Athanasi do të gjente e lidhej ngushtë me mikun e tij të jetës, patriotin Jani Vruho, me të cilin do të bëhej një binom i pandarë. Në hotelin e Tashkos do të strehohej dhe Theofan Mavromati, një djalë i zgjuar e patriot i flaktë, ardhur nga një fshat shqiptar i Trakës. Aty do të vinin miq militantë të lëvizjes kombëtare, si B. Topulli, I. Temo, M. Grameno etj. Hotelet dhe shtëpia e Tashkos ishin një copë Shqipëri ku flitej shqip, ku lexoheshin gazeta dhe libra shqip, ku vinin lajme e informacione nga Shqipëria e mbi të gjitha, kuvendohej e diskutohej për kauzën dhe fatin e atdheut të robëruar. Sipas dëshmimeve të kohës, ai që i jepte tonin dhe i peshonte fjala ishte i zoti i shtëpisë. Athanasi tani kishte atributet e misionarit e propaganduesit të pjekur të çështjes shqiptare, të militantit energjik e të sakrificës, të burrit të hapur e kurajoz, të një inteligjence natyrale dhe të një kulture të fituar më shumë nga jeta se sa nga librat. Në lëvizjen kombëtare shqiptare të Misirit, Athanas Tashkoja do të përbënte një zë të vetin, duhet pasur parasysh që situata politike e komunitetit shqiptar përballej me plot probleme. Kryeproblemi ishte çështja e bashkimit, lufta kundër përçarjes që sillnin elementët grekomanë dhe turkoshakë, prapa të cilëve qëndronin interesat të shtetit grek dhe atij turk. Për fat të keq këto interesat gjenin mbështetje të disa nga pasanikët dhe intelektualët shqiptarë të Misirit, mes të cilëve dallonin Dr. Adhamudhi dhe Dr. Turtulli. Ishin këta më shokët e tyre që shkaktonin probleme në shoqëritë “Vëllazëria” dhe “Bashkimi” apo dhe në shtypin e tyre. Duke qenë njerëz me emër dhe të kamur, me përvojë intrigash, kjo kategori shqiptarësh përbënte krahun konservator dhe oportunist. Sigurisht këtij krahu do t’i kundërviheshin shqiptarët patriotë të shtresave të ulëta e të mesme me në krye Athanas Tashkon, i cili, i frymëzuar nga ide demokratike, ishte i ndërgjegjshëm për kufirin klasor që ndante komunitetin shqiptar dhe sillte përçarje. Në këtë situatë të ndërlikuar Athanas Tashkoja do të tregojë një organizator i shkëlqyer për afrimin dhe bashkimin e vëllezërve të një gjaku. Ai do të dallohej dhe për aftësitë e veçanta që kish për t’u lidhur e bashkëpunuar me vatrën e tjera të diasporës shqiptare nëpër botë, nga Ballkani në Siberinë e largët, nga Afrika në Amerikë. Korrespondenca e tij e gjerë dhe e pasur është pasqyrë e qartë e veprimtarisë së suksesshme politike dhe organizative për të përfshirë dhe aktivizuar mërgatën shqiptare në kauzën dhe aksionet e lëvizjes kombëtare. Temat dhe problemet e letërkëmbimit janë nga më të ndryshmet, sa jetike aq të ndërlikuara, çështje që për t’u zgjidhur kërkojnë mençuri, kurajë, njohje dhe informim, sakrificë dhe veçanërisht karakter të fortë, cilësi këto që i gjejmë të

mishëruara në personalitetin e Tashkos. Në epistolarin e tij, që e konsideronte si një nga mjetet kryesore të luftës politike, do të gjejmë dy lloj letrash: letra private, dërguar miqve dhe aktivistëve të lëvizjes dhe letra të hapura, të botuara në shtypin e kohës. Të parat kanë të bëjnë me emra të njohur të historisë sonë, si A. Z. Çajupi, S. Kolea, F. Noli, K. Luarasi, I. Temo, M. Duçi etj., ku hidhet dritë jo vetëm në marrëdhëniet miqësore, por dhe në qëllimet dhe përpjekjet e përbashkëta atdhetare. Mjafton të përmendim letrat e Nolit, që përbëjnë një nga faqet më të bukura të epistolarit shqiptar, ku Tashkoja zbulohet si mentor, mësues dhe udhëheqës shpirtëror i Nolit. Fondi më i pasur i letërkëmbimit privat është ai mes S. Kolesë dhe Tashkos, mbushur me probleme dhe shqetësime, me kritika, madje dhe polemika të rrepta nga ana e Tashkos, ku manifestohet pjekuria dhe drejtësia e mendimeve të tij, principialiteti dhe natyra burrërore që e karakterizojnë.

Nga letrat publike do të veçojmë dy prej tyre, njëra drejtuar L. M.T Sulltan Mehmetit V në Stamboll (1908) dhe tjetra dërguar Faik Konicës (18.12.1912). E para duket gati e pabesueshme, duke pasur parasysh karakterin e theksuar kritik, qortimet e rënda dhe konstatimet tepër të guximshme që i zbulon sundimtarit tiran. Ai e akuzon se “nuk ke haber se ç’bëhet në shtëpinë tënde, se nuk mentonesh pak edhe ti si njeri dhe jo si mbret.” Ai i kujton se “mbretëria e juaj rrojti në Europë 500 vjet, nën hijen e nën mbrojtjen tonë, të shqiptarëve.” Bile e kërcënon kur i shkruan: “Sulltan, Sulltan, pa neve shqiptarët, nuk qëndron dot në fron të Mbretërisë Osmane as ti, as ndonjë tjetër nga shtëpia juaj.” Kurse në fund guxon ta këshillojë: “mos kërko mbrojtjen e ndonjë Fuqie të Madhe, kërko mbrojtjen tonë, eja me neve dhe mos ki frikë.” Letra mban nënshkrimin “Komiteti i fshehur dhe i reshtur D. Sh. (Dora e shkopit)

Letra shkruar Faik Konicës është nga të rrallat shoqe në epistolarin e Rilindjes sonë për nga fryma e thellë kritike, për nga vërtetësia me të cilën zbulon karakterin dhe natyrën e Konicës. Ai nuk e mohon se kur është “në orë të mira shkruan shumë bukur dhe i shërben çështjes sonë kombëtare.” Por në realitet, arsyeton Tashkoja, “zotrote një herë në mot shkruan për të gëzuar zemrat tona dhe nëntëdhjetë e nëndë për t’i ftohur.” Me ironinë e tij të hollë vë në dukje se Konica kërkon ta bëjë monopol patriotizmin. “Zotrote, - i shkruan, - kërkon që të mos ketë në botë tjetër shkrimtar, gazetar, politikan ose kryetar përveç teje. Mirëpo shqiptarët nuk duan kështu e në qoftë se ajo do të bëhet nga një Faik, për një Faik e me një Faik kurrë mos u bëftë!” ndaj në fund e mbyll me këto fjalë të rrepta, pa u ndrojtur nga autoriteti i tij publik: “Mblith mendjen, pra, o zotëri se na plase shpirtin. Na plase zemrën sepse nuk ke lënë

gjë pa sharë, të duruam shumë, por që tani e tutje, nuku do të durojmë se nuku durohesh.”

S’ka dyshim që Athanas Tashkoja, në historinë e Rilindjes sonë Kombëtare, bëri emër të nderuar jo vetëm si një nga organizatorët energjikë dhe veprimtarët aktivë, por dhe si publicist i talentuar me shkrimet kombëtare që botoi në shtypin e diasporës, nëpër faqet e gazetave autoritare si “Drita”, “Kombi”, “Dielli”, “Liria e Shqipërisë”, “Koha”, “Rrufeja” etj. Publicistika e tij karakterizohet nga tipare të veçanta si për nga stili origjinal, ashtu dhe për nga fryma optimiste, tonet kritike, trajtimi realist i problemeve, konceptet demokratike dhe popullore. Ai u qëndronte besnik rrënjëve të prejardhjes fshatare, siç qe treva e Dangëllisë, e njohur për psikologjinë burrërore, kulturën e brendshme dhe zakonet fisnike, të cilat ai do t’i shfaqte në publicistikën e tij. Ai mbante në gazetën shqiptare të diasporës, rubrikën e tij “Letra nga Egjipti” ose “Letra nga Misiri”, ku ngrinte dhe trajtonte me guxim dhe profesionalizëm disa nga problemet jetike të lëvizjes kombëtare, si: mbi bashkimin e shqiptarëve, mbi nevojën e të shkruarit shqip, për kualifikimin e shtypit shqiptar, luftën kundër megalidhësë, stigmatizimit e mercenarizmit etj. Ai zhvillon polemika të rrepta me kundërshtarët, madje dhe me miqtë e tij të afërt, si Sotir Kolea, Fan Noli etj. Me firmën e tij gjejmë dhe vargje të tilla si: “O Jemen i Arabisë / Varr’ i zi i Shqipërisë / Na përpive që të gjithë / Se jemi katran me pisë.”

Në vitin 1907 Tashkoja nxjerr gazetën “Shkopi”, të cilën e përgatiste në Kajro dhe e botonte në shtypshkronjën “Mbrothësia” të Sofjes. Ishte i pari organ satirik në historinë e gazetave shqiptare, me profil kryesisht politik. Ai u botua në gjuhën shqipe dhe greke, me një format modest prej 6 faqesh, shoqëruar me shënimin “Del kur mundet në Kajro të Misirit dhe shpërndahet pa të holla.” Direktor i saj është Dora (pseudonim i Tashkos) dhe pjesa më e madhe e artikujve kanë autorësinë e tij, por nuk mungojnë dhe bashkëpunëtorë si Jani Vruho, Çajupi, M. Grameno etj. Që në krye, “Shkopi” bën të qartë misionin që ka marrë përsipër: “Të mprojë të drejtat e kombit shqiptar”, por nga ana tjetër të fshikullojë e të godasë, të tallë e të thumbojë armiqt’ e Shqipërisë, sidomos grekët e turqit, duke mos kursyer as sulltanin. Një vend me rëndësi zinin kritikën dhe tallja e dobësive e dukurive negative të shqiptarëve. “Shkopi” që në numrin e parë hapet me artikullin kushtuar dëshmorit kombëtar Spiro Jovan Kosturi, vrarë e masakruar nga shovinistët grekë. Duke vrarë Spiron, shkruan Dora, janë vrarë të gjithë shqiptarët, të krishterë e myslimanë, ndaj bën thirrje për

hakmarrje dhe vigjilencë. “O burra, o shokë, - thotë, - ta ruajmë nderin e Shqipërisë e të baballarëve tanë.”

Pesha e “Shkopit” do të ngrihet më tej në numrat pasues, kur do të trajtojë problemin e gjuhës shqipe si frymëmarrjen e patriotizmit të shqiptarëve për të cilët ata duhet të luftojnë, duke e mbrojtur nga armiqt’ e kombit. Në një artikull tjetër shtron rëndësinë e alfabetit shqip dhe mbështet alfabetin e Stambollit. Akoma më e thellë dhe kurajoze është publicistika politike e Tashkos, kur vë në shënjestër armiqtë sa të rrezikshëm e të pabesë, siç janë qarqet greke e turke që nuk ia duan të mirën shqiptarëve (“Ç’ ishte Turqia? Ç’ janë shqiptarët” ose “Xhuxhë-majmunët e Vllahisë” apo “Turqit bënë sikur të vunë vetulla dhe të nxuarnë sytë” etj.)

Te “Shkopi” një vend të posaçëm zë dhe poezia satirike, që vë në lojë dhe demaskon antishqiptarët, tradhtarët, oportunistët dhe dobësitë e veset e bashkatdhetarëve. Autori kryesor i vargjeve satirike është vetë Tashkoja, por nuk mungojnë dhe bashkëpunëtorët, midis tyre dhe A. Z. Çajupi. Vargjet e “Shkopit” janë të thjeshta dhe të kuptueshme, godasin në shenjë dhe shquhen për humorin e hollë e të mençur, në frymën e satirës popullore. A. Tashkoja, s’ka dyshim, është nga pionierët e parë të letërsisë humoristike e satirike shqiptare. Publicistika e tij mbetet shëmbëlltyrë dhe për gjuhën shqipe, të cilën e lëvroi për afro dy dekada. Një shqipe burimore, e natyrshme dhe e rrjedhshme, e qartë dhe e thjeshtë, por dhe me ngjyrimet stilistike dhe plot shprehje popullore.

Tashkoja njeri është një dimension tjetër i vlerave të tij: i thjeshtë dhe popullor, shpirtmadh, mendjehollë dhe i kthjellët, i drejtë e i ndershëm, largpamës, i qartë e i vendosur në rrugën që kish nisur, temperament i gjallë, shpesh shpërthyes dhe njeri i aksionit. Ai do të njihej e çmohej dhe si njeri zemërbardhë, i gatshëm për sakrificë për të ndihmuar të tjerët dhe me të drejtë konsiderohej si një filantrop i madh. Mjafton të kujtojmë ndihmën e pakursyer që i dha Nolit, kontributet për shkollat e Korçës, dërgimin në Korçë me shpenzimet e tij të dirigjentit italian të Bandës së Lirisë, ndihma e rregullt për arkën e kishave (Llason) të ndërtimeve publike, ndihma për shtypshkronjën “Luarasi”, pa përmendur faktin e njohur publikisht që hotelet e tij në Fajum u kthyen në vatra dhe streha falas të sa e sa patriotëve.

Në mes të Afrikës Athanas Tashkoja krijoi familjen e tij, një familje tipike shqiptare për nga gjuha, zakonet, virtytet, kultura. U bë babai i gjashtë fëmijëve, të cilët jo vetëm i edukoi dhe i brumosi shqiptarisht, por përballoi dhe shpenzimet e

shkollave të larta që ata kryen. Jeta dhe fati i tyre përbën një sagë të vërtetë. Djali i madh, Koço, kreu studimet në Harvard dhe u bë nga liderët e lëvizjes revolucionare në Shqipëri, Anastasi ose Arturi studioi në Vjenë dhe Harvard dhe u njoh si muzikant dhe si piktor me famë botërore, Gaqua u bë doktor i shkencave ekonomike në Vjenë dhe arriti të jetë një nga ministrat e nderuar të bujqësisë në Shqipëri, Alekua studioi në Paris për fizikë të lartë dhe u çmua si një nga pionierët e arsimit të mesëm shqiptar. Pjesë e kësaj sage, më e nderuar dhe më e famshme, do të ishte sopranoja e madhe Tefta Tashko, që u nda shpejt nga jeta, po që rrugën e saj muzikore do ta ndiqte i biri, Eno, si dirigjent, muzikolog dhe instrumentist i talentuar. Ç'mund të kërkonte e të priste tjetër një baba si Athanas Tashkoja nga fëmijët e tij, të cilët me jetën dhe punën e tyre të vyer nderuan jo vetëm prindërit, por edhe atdheun dhe kulturën shqiptare.

Për, atdheun , gjënë më të shtrenjtë që pati në jetë Athanas Tashkoja, për të cilin që sa që gjallë i qante zemra, aq sa erdhi dy herë për ta ndihmuar në vite të vështira krizash politike dhe ekonomike (1909, 1914) dhe u kthye rishtazi në Afrikën e largët nga rrethanat e mbrapshta të kohës, për të mbyllur sytë në tetor 1915 në moshën më të bukur të burrit. Diku ai do të shkruante: “Atdhetaria ime... nuk është për interes, është detyrë njeriu, me ndjenja të njerëzinjta.”

Gjithë jeta e tij në shërbim të Shqipërisë e tregoi dhe e vërtetoi këtë të vërtetë katërcipërisht. Ndaj me të drejtë Mihal Grameno do të shkruante: “Historia kombëtare do ta ketë në faqet e saj Athanas Tashkon duke zbukuruar shtyllat e saj me veprat dhe patriotizmin e tij.” Njëqind vjetori i shuarjes së Athanas Tashkos është rasti më i mirë për ta kujtuar e nderuar me mirënjohje të thellë këtë figurë, mendimet dhe veprimtaria e gjithanshme e të cilit sjellin në kohën tonë vetëm dritë besimi dhe optimizmi për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Dr. PANDI BELLO

Korçë

ATHANAS TASHKO DHE KORÇA

Në librin e Eno Koços për Athanas Tashkon, ndër të tjera lexojmë: Në një Leje Qëndrimi të datës 3 dhjetor 1889 të lëshuar nga Sekretariati për Punë të Brendshme të Kolonisë të Massaua-s të Eritre-së italiane të kohës, shënohet se Athanas Tashkoja ka lindur në Corizia, pra në Korçë.

Dihet se ekziston një lidhje e fuqishme në jetën e të voglit me vendlindjen. Kështu lojërat, vrapimi nëpër rrugica, ndërtesat me sekretet e tyre, fragmente të historisë, gjithë metafizika e qytetit ia mbushën fëmijërinë plot mbresa dhe sythe mendimesh edhe Athanasit të vogël.

Kur Athanasi burrërohej shihte se si qyteti e pasuronte shpirtin e vet dhe përpiqej të “shtrihej” në hapësira të reja, duke arritur të shfaqej si qyteti me autentik i Shqipërisë, njëkohësisht si qyteti më pak oriental, jo vetëm në kuadrin shqiptar, por edhe në plan rajonal. E gjithë kjo ushqejej nga përpjekja për t’ju afruar civilizimit europian dhe eksperiencia e epopesë së krijimit dhe mbrojtjes së kulturës dhe të gjuhës.

Kështu shpirti i këtij qyteti patriot jetonte edhe në mendjen dhe zemrën e Athanasit të ri. Këtu, në zemër të qytetit, karshi Mitropolisë, atje ku e kishte dyqanin i ati, iu formua ai shpirt. Këtu u edukua dhe pa veprimet e Efthim Mitkos, Anastas Lakshes, Jovan Bankës dhe të patriotëve e filantropëve të tjerë. E deshi shumë qytetin e lindjes dhe e deshi në mënyrën e vet. Kështu i mësoi edhe fëmijët e tij. Fëmijët e tij lindën në Misir, por ai çdo verë i dërgonte në Korçë, tek të afërmit, për t’u bërë ashtu siç dëshironte ai, pra, korçarë të mirë. Athanas Tashkoja i zgjodhi me kujdes modelet e veta dhe u bë edhe ai një model, së pari për fëmijët e vet, por edhe për të tjerë.

Athanasi u lind në vitin 1863. Ndërkohë në fillim të shek. XX, problemi shqiptar u bë një çështje ekzistenciale. Situata politike dhe shoqërore ishte tepër e ndërlikuar. Shumica absolute e popullsisë së vendit ishte analfabete. Në këtë mënyrë, tek kjo shtresë nuk mund të flitej për ndonjë kulturë politike. Nga ana tjetër interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë shqiptare të kohës krijonin edhe forma dhe mënyra të ndryshme të të menduarit. Një pjesë e njerëzve as nuk kishin një ndjenjë të shprehur qartë se ekzistonin, ndërsa situata gjeopolitike ndërlikonte edhe më shumë

gjithçka. Në rrethana të tilla kishte rëndësi të orientoheshë në mënyrë të drejtë dhe të ndershme, të orientoheshë në atë mënyrë sa të mbeteshe faqebardhë ndaj të ardhmes. Kështu pra, Athanasi, me mençuri e kuptoi dhe e ndjeu çfarë duhej të bënte. Ai e kuptoi se një komb nuk mund të çlirohej pa vepruar ai vetë. Në këtë mënyrë ai kishte kuptuar pulsën e historisë.

I ati i kërkoi të bënte atë që kishin bërë edhe shumë korçarë të tjerë. Të nisej nëpër botë, të ngrinte një lloj ekonomie dhe pastaj të martohej dhe të krijonte familje. Si shtetas (i krishterë) i Perandorisë Otomane e kishte të lehtë të udhëtonte në tokat e saj. Ishin nevojat ekonomike që e detyronin, por për Athanasin këto udhëtime ishin edhe refleksi i dëshirës për të qenë i lirë. Njihte gjuhët greke, turke dhe arabe dhe kjo ia lehtësonte aventurën. Themë kështu, sepse nuk ishte e lehtë (akoma pa hyrë shekulli XX) të udhëtoje në qoshet e kësaj perandorie dhe të siguroje jetesën në një mjedis natyror dhe social krejt të ndryshëm nga ai të cilit i përkisje. Udhëtonte drejt një bote të largët nga ku mendonte të vinte i pasur dhe ndoshta ajo botë me piramida, beduinë dhe shkretëtirë iu duk fantastike. Takoi njerëz të racave të tjera si greke, europiane, arabe dhe afrikane dhe kërkonte në ato vende, atë që i mungonte në vendin e vet. Një jetë si në përrallë. Udhëtonte dhe largohej për t'u afruar drejt lirisë dhe kështu ishte jo vetëm fillimi. Vitet që do të pasonin do dëshmonin se e gjithë jeta e tij do të ishte një udhëtim, të cilin ai e kreu më së miri.

Dorëshkrimet dhe dokumentet e tjera të shpëtuara si me magji nga pasardhësit e korçarëve të Kolonisë të Egjiptit na japin mundësinë ta njohim më mirë Athanas Tashkon. Nga letërkëmbimi, nga takimet me shqiptarë dhe të huaj nga artikujt e shkruar dhe veprat mirëbërëse shihet se ai mendonte, besonte dhe vepronte si një patriot. E donte vendin dhe për këtë nuk bënte lëshime edhe nëse do të hynte në konflikt me miqtë dhe bashkëpunëtorët.

E gjithë veprimtaria e tij tregon se ai ishte i ndershëm, realist dhe këmbëngulës. Poezia e Efthim Mitkos “Korç’ moj Korç’ e mjera Korçë” e shpreh në mënyrë simbolike edhe aktivitetin e pasur të Tashkos. Ja dhe vargjet e saj:

Hesht mos qaj, e mjera Korçë,
se ke diemzit kurbetlij,
ata do të të ndihmojnë
me para e me florij.
Jan’ të pasur e të mirë,
në Misir e në Vllahi,

plagëtë do t’i shërojnë,

si s’e pandeh asnjëri.

Athanas Tashkoja kërkonte dinamizimin e jetës shqiptare, në radhë të parë duke hapur shkolla. “Që të shpëtojë kombi ynë nga robëria e padijes – shkruante ai – s’ka tjetër mënyrë përveçse të bëjmë shkolla të mira”. Ai i zgjidhte me kujdes format e veprimit pa e shmangur qëllimin që synonte. Në plan politik, kur situata e donte, ai shfaqej luajal përballë qeverisë otomane, por, ai mendonte se as nën Sulltan Hamidin dhe as me xhonturqit nuk mund të kishe besim në një liri të vërtetë lidhur me zhvillimin e arsimit. Që kur u çel Mësonjëtorja e Parë Shqipe, korçarët i provuan në kurriz shumë herë dredhitë e turqve. Ai nuk besonte se “turqit do t’i lenë zakonet e vjetra” dhe nga ana tjetër luftoi për të mënjanuar tutelën e kishës në këtë sferë. Për këtë i u desh të ndeshej në Misir, të udhëtonte në Korçë dhe të ndeshej dhe atje me prirjet grekofile, të shkruante në shtypin e kolonive shqiptare në Sofje, në Boston dhe gjetkë. Hapjen e një shkolle në Korçë sipas modelit të *Robert College* të Stambollit, apo me atë të Bejrutit (niveLIN e të cilit ai e njihte sepse atje kishin mësuar djemtë e tij) Tashkoja e ktheu në një qëllim të madh. Me paratë që dhuroheshin për shkollat ai kërkonte njohjen e gjuhëve europiane, por edhe të turqishtes në mënyrë “që të ndriçohen djemtë e korçarëve e të mos bëhen hamej kur venë në kurbet” – siç shprehej ai.

Me hapjen e shkollave të reja ai synonte të zhvillonte më tej primatin kulturor të Korçës, por, ai dëshironte një komb të ndriçuar edhe kur bëhej fjalë për muzikë. Kërkesës së përfaqësuesve të kryesisë të “Bandës së Lirisë”, Pandeli Cale dhe Mihal Bimbli, për ndihmë financiare për djemtë e kësaj orkestre, që synonin të zhvillonin muzikën kombëtare, ai iu përgjigj me shumë entuziazëm. E ndihmoi financiarisht “Bandën e Lirisë” dhe pas një viti do t’i dërgonte ndihmë në të holla edhe bandës “Afërdita” që porsa qe ngritur në Elbasan.

“Kur u proklamua Hyrieti i Turqisë [ai] u ngrit me fëmijën [familjen] e vajti në Shqipëri, duke pandehur se do të jetë liri dhe për këtë deshi të blinte Shtypshkronjën e Manastirit, por, kur kuptoi qëllimet turke shkoi përsëri në Misir, ku bashkë me mikun e tij të pandarë, Vruhon, zunë luftën kombëtare” – shkruante Mihal Grameno në gazeta “Koha” më 9 dhjetor 1915, me rastin e vdekjes së tij.

Mungesa e unitetit politik të shqiptarëve bëri që elita politike europiane t’i ofrojë fronin e Shqipërisë një princi të huaj. Ishte një vendim jokohorent, por patriotët e ndershëm shihnin këtë veprim një formë mesianike të mishërimit të idealit

të Rilindjes Kombëtare. Atëherë Tashkoja viziton Durrësin, për të “çelur atje tregti të madhe”, por i madh u bë zhgënjimi i tij nga kryengritja e turmave fanatike anadollake që rrëzuan princin Wilhelm de Wied pas gjashtë muajsh mbretërim dhe e dëbuan. Këtë zhgënjim do ta shprehte edhe në artikujt që shkroi pas ngjarjes.

Artikujt e Athanas Tashkos karakterizohen jo vetëm nga guximi dhe nga një stil polemist, por edhe nga një qartësi e madhe, nga një lloj perspektive, të cilën kohët e reja e konfirmuan. Në gazetën e tij ”Shkopi”, ai nënshkruante me pseudonimin *Dora* dhe *D i Sh*, ndërsa, te gazeta “Liri e Shqipërisë”, “Koha” etj., ai nënshkruante me emrin e plotë dhe me cilësimin që do ta identifikonte tërësisht, pra, Athanas Tashko Korçari. Emri i përdorur në këtë formë e pasuroi identitetin e tij kulturor – shpirtëror. Prej këtij momenti ai e ka të cilësuar edhe një lloj identiteti kolektiv. Atë kohë edhe patriotë të tjerë si, Anastas Lakshe, Kristo Luarasi, Nikolla Naço përdornin si mbiemër edhe epitetin Korçari. Në këtë mënyrë edhe identiteti kulturor– shpirtëror i korçarëve u pasurua dhe u zbukurua.

Athanas Tashkoja zotëronte genin e iniciativës. Filozofimet e shumta nuk e tërhiqnin. Ai ishte njeri i fjalës dhe këshillës të mençur dhe sidomos i veprimit të mençur dhe të sigurt. Nuk pranonte robërinë e mendimeve të të tjerëve dhe nuk preokupohej nëse të tjerët mendonin mirë apo keq për të. I interesonte më shumë e tashmja dhe e ardhmja dhe përpiquej të tërhiqte edhe ata që ishin të pavendosur apo të paorientuar. Ishte një idealist, një njeri me karakter. Ndoshta u shpreh ashpër për ndokënd, por përballë ndërgjegjes së vet ka vepruar siç duhej.

”Athanas Tashkon do ta gjejmë në çdo lëvizje kombëtare në ballë, duke mos u kursyer për asgjë”, – shkruante Mihal Grameno.

Ai e pa triumfin e idesë kombëtare, por pa edhe shpërbërjen e këtij triumfi. Pas kryengritjes kundër princ Widit (De Wied), iu duk sikur gjithçka duhej të fillonte nga e para, por fati nuk punoi për të. Vdekja e papritur nuk i la kohë të vështronte pas dhe të shihte frytet e punës së tij dhe të idealisteve të tjerë.

Njeriu i ditës, roli i të cilit ishte vendimtar në veprimin e Kolonisë së Misirit dhe në realizimin e misionit historik të Fan Nolit, njeriu për të cilin patriotizmi ishte si një fe (religjion), u harrua në festimet e 100-vjetorit të Pavarësisë. Fjalëtarët e panumërt atë vit nuk e kujtuan as Korçën, as Nolin.

Sigurisht, për Athanas Tashkon është folur edhe më parë, nga Dhimitër Shuteriqi, Nasho Jorgaqi, Floresha Dado dhe Fatos Tarifa, por ne të gjithë sot në këtë konferencë mendojmë se duke e përkujtuar, vemë në dukje të gjitha meritat e tij.

Figura e tij prej tregtari të zot, shikimi tej përshekruës të kujton tipin e korçarit energjik, që kishte shëtitur nëpër botë dhe përpigjet për të mirën e vendit të tij. Athanas Tashkoja pjesën më të madhe të jetës dhe pjesën më të mirë të shpirtit e dha për afirmimin e popullit të cilit i përkiste.

Për Athanas Tashkon, Korça ishte jo thjesht vendlindja, por, siç shprehet ai, “Atdhelindja” (gazeta “Koha”, Korçë, 6 Prill 1912). Kemi në këtë rast një transformim esencial. Qyteti nuk është thjesht vendi ku ke lindur, por, kthehet në një qytet–shtet, në Mëmëdhe dhe në Atdhe.

Kështu ai nuk luftoi vetëm për një qytet, por për një atdhe dhe, kishte një forcë sa që dukej sikur të gjitha perënditë ishin me të. Në këtë përpjekje, Korça dhe Athanasi kanë lartësuar me krenari emrat e njeri–tjetrit.

Fiolozofi Johann Gottfried von Herder thoshte: ”Njeriu nuk ka një fjalë më fisnike për të treguar se kush është, se sa emrin e tij”.

Sido që jetojmë në një kohë tjetër dhe me një mentalitet të ndryshuar, duke shqiptuar emrin Athanas Tashko Korçari, krijojmë një lidhje me vlerat dhe virtytet që nuk mund të ndryshohen lehtë nga korentet moderne, me vlerat e përhershme kombëtare.

ENO KOÇO
Tiranë

SI E KAM PËRFYTYRUAR IMAZHIN E GJYSHIN TIM

Duke qenë se nuk kam trashëguar dokumente e letra personale të gjyshit tim, por që edhe fare pak kam dëgjuar rrëfime mbi jetën e tij të përditshme në Egjipt, nga ato që do të lexoja, më vonë më dilte të kishte qenë njeri sa energjik e pasionant, aq dhe me bindje të forta ndaj atyre vlerave që ai i konsideronte parësore siç ishte çështja shqiptare. Më del të ishte edhe filantrop i madh e, mbi të gjitha, njeri që nuk donte të lëvizte nga kredoja apo ndoshta fanatizmi i tij, nga këmbëngulja në arritjen e saj që ai ëndërronte - të bërit të Shqipërisë.

Ka qenë ky imazhi atdhetar i tij me të cilin u mësova ta përfytyroj tim gjysh. Historitë që vinin në veshin tim mbi të ishin kryesisht në formë bëmash. Vonë, fare vonë, kur fillova të merrem se çka kishte shkruar ai vetë në formë artikujsh, çfarë i patën shkruar atij e çfarë u kishte shkruar ai të tjerëve apo se çfarë shkruan të tjerët për të më vonë, vetëm atëherë imazhi i bëmave nisi të më kthehet në një realitet të prekshëm.

Gjithsesi, duke iu referuar materialit arkivor dokumentar dhe fare pak bëmave, më del të ketë qenë njeri aspak i dukjes e i bujës, përkundrazi, të ketë qenë shumë më afër anonimatis. Rolin e tij në mbrojtje të shqiptarisë ai e kuptonte në frymën e Rilindjes Kombëtare, i bindur që puna e tij individuale do të duhej të shkrihej me atë të përgjithshme dhe se Shqipëria nuk do mund të bëhej nga ata që shprehnin egot e tyre personale, pra nga ata me atdhetari të dyzuar. Shqipëria do mund të bëhej vetëm falë frymës së përgjithshme të armatës së Rilindjes, ku secili atdhetar do të duhej të ishte ushtar i saj për t'i përcjellë brezave të ardhshëm aspiratën për mëkëmbjen ekonomike, arsimimin e qytetërimin e saj – kështu e kuptonte rolin e tij Athanasi. Me pak fjalë, ai e rendiste veten ndër ushtarët e veprimtarëve dhe jo prijës të tyre.

Kohët kaluan, Shqipëria u bë dhe anonimati i Tashkos pushoi së qeni. Megjithatë, jo pak gjurmues letrarë, anonimatin e Tashkos, atë të njësimi me frymën e Rilindjes, nuk arrinin të kuptonin se kush qëndronte, fjala vjen, pas pseudonimit “Dora” apo pas artikujve kryesorë anonimë të gazetës “Shkopi”, ku Tashkoja shërbeu si Direktor i saj (D. i Sh). Tashkoja zgjodhi gazetarinë qytetare, atë publike apo pjesëmarrëse, si armë ndikuese në shërbim të çështjes kombëtare e gërshetuar kjo

pazgjidhshmërisht me financat e tij, pasi e para nuk mund të realizohej pa mbështetjen e së dytës. Gazeta “Shkopi”, që gjyshi nxori më 1907 dhe 1908 nuk mund të realizohej pa të ardhurat e tij, të cilat i nxirrte nga puna me tregtinë, hotelerinë dhe restorantin, duke mbajtur kështu familjen e tij, por edhe për të financuar vepra bamirësie, kryesisht në Korçë (Bandën e Lirisë, Shoqërinë Shkollare, Llason e ndonjë tjetër), si dhe duke mbështetur veprimtarë të veçantë (më së paku Fan Nolin) apo kryengritësit shqiptarë të çetave të Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos, ashtu dhe ata të Malit të Zi të përfaqësuar nga Ferid Toptani apo Sokol Bazi.

Nga letrat dhe artikujt e Tashkos, ndihet dukshëm se satira, ironia e sarkazma të ketë qenë tipar karakteristik brenda qenies së tij, veti këto që më së miri do t'i përshtateshin gazetës së tij satirike “Shkopi”, të cilën e pati aq për zemër. Në vitet që mori drejtimin e gazetës, 1907–1908, pseudonimin “Dora” apo “A. T. Korçari” që e kish përdorur përpara këtyre viteve apo që do ta përdorte edhe më shumë pas këtyre viteve, do ta zëvendësonte me anonimatin e plotë. Për një arsye apo një tjetër, lidhur me shkrimet e tij me pseudonimin “Dora” janë hedhur hije dyshimi në këto njëqind e më shumë vjet edhe pse kur ishte gjallë pseudonimi i tij nuk ishte i panjohur, madje ai dilte herë pas here në dritë nëpër gazeta të ndryshme të kohës dhe që u përforcua në mënyrë shembullore në nekrologjinë e shkruar nga Jani Vruho me rastin e vdekjes së Tashkos. Që në 12 shtator të vitit 1909, gazeta “Lirija” e Selanikut, e drejtuar nga Lumo Skëndo, në numrin e saj të 58-të do të shënonte: “Zoti Athanas Tashko (Dora) drejtonjës’ i ‘Shkopit’ në Misir erdhi nga Misiri për në kongrest t’ Elbasanit, pasi s’punonin vaporet e Greqisë në Tyrqi, u vonua dhe nuk hariu dot për në kongrest; vajti gjer në Manastir, Ohri dhe u kthye prapë në Selanik ku ndenji një javë, parëdije shkoj për në Misir”.

Tashkoja ndonjëherë nënshkruante edhe me *D i Sh* (Direktor i Shkopit), nënshkrim që herë pas here merrte kuptim të dyfishtë, edhe si Dora i Shkopit, ku simboli i “Dorës” ishte ajo që mbante shkopin “për të fshikulluar e goditur të gjithë armiqtë e Shqipërisë”.

Fragmenti i mëposhtëm i Jani Vruhosh është nga ato citime që e kam patur shumë për zemër dhe që më dukej që ishte thelbi i gjithë veprimtarisë së Tashkos. Citoj: “Kur më 1908, Xhon Turqit proklamuan Konstitutën, Thanas Tashkua njohu bukur dinakëritë turke dhe u dëshpërua tepër, po, përsëri, nuk’ e humbi guximin dhe me çpejtim të math botoj të paharruarin ‘Shkopi’. Sa shkrime me shënim ‘Dora’ patën qënëur mendimet e ti; të katër númerat e “Shkopit” do të pasqyrojnë veprat e atdhetarit

të math i cili, kurrë nuk' mendohej për punët vehtiake aqe sa mendohej për ató të përbáshkëtat".

Një gjë që nuk ka mundur të dalë më e plotë në këtë libër, sepse i përkiste edhe anonimatit të rreptë, ishte mbështetja me të holla që Tashkoja u ka bërë kryengritësve shqiptarë në jug e veri. Për këtë lloj ndihme dëshmitë e shkruara janë letrat që i dërgojnë Tashkos nga Sofja apo Cetina. Duke njohur natyrën bujare të Tashkos në ndihmë të çështjes së atdhetarisë, të dhënat gojore mbi këto ndihma bëhen të besueshme, aq më tepër që Mihal Gramenoja e informon Tashkon për lëvizjet e tij "nëpër fshatrat kryengritje", ndërsa Kristo Luarasi i shkruante nga Sofja më 15 Mars 1908 se "Çerçizi me Gramenon e me të tjerë shokë shëtijnë si liona (dragonj) nëpër Shqipëri, hynë në Kostur, vranë me petka nizamësh ditën më drekë, gjer i kuptuan, ata fluturuan".

Sokol Bazi, nga Cetina e Malit të Zi, më 8 maj 1911 i përshkruan gjerë e gjatë Tashkos ç'ndodhte në teren mes malësorëve shqiptarë të veriut dhe që e lidh me atë që do të ishte më konkrete - ndihmën financiare për ta: "Më vjen se dot' bahet' shumë mirë ndihma qi dot' báni, t'a dërgoni këtu me Tashkon, e Zotnija e Tij të shofinj këta petritat e maleve e t'i kënaqet zemra se gjithë bota â tui met' me gisht' në gojë prej trimnijas të Shqyptarëve". Kuptohet, kërkesa e Bazit ishte sa simbolike me këshillën që jepte, që Tashkoja të shkonte vetë midis malësorëve me ndihmat e tij, por aq dhe konkrete, sepse zgjodhi pikërisht Tashkon e jo ndonjë zengjin tjetër të Misirit, nisur nga prirjet e tij filantropike atdhetare që ishin bërë të njohura kudo në diasporë.

Padyshim, ato që kanë mbizotëruar më së tepërmi në njohjen e Tashkos mes studiuesve shqiptarë kanë qenë marrëdhëniet e tij kryesisht me Fan Nolin. Është shkruar më se një herë për qëndrimin njëvjeçar të Nolit në Fajum, kur ky i fundit kalonte një pjesë të mirë të kohës në ambientet e Tashkos. Letrën që do t'i dërgonte këtij nga Bostoni më 17 gusht 1906, Noli mes të tjerash do të shprehej: "Nukë munt të ju rrëfenj me fjalë gëzimnë që ndjenj kur marr të ra nga Misiri të cilin e kam në zemër vetëm nga shkakut i atinjë moti që shkuam bashkë". Kjo periudhë përforcohet me letrat e shumta të Nolit dërguar Tashkos nga ShBA-ja dhe Europa pas largimit të tij nga Misiri, letra të cilat janë bërë disa herë publike, por që kanë gjetur shtjellim dhe analizë të mirëfilltë nga Nasho Jorgaqi. Këto letra janë i vetmi material i njohur që është përfshirë edhe në librin tim mbi Athanasin, pasi gjithçka tjetër, pra i gjithë letërkëmbimi me të tjerët, jepet këtu për herë të parë sot e pas 100 e më shumë vitesh.

Noli do ta ndjente detyrim moral, por dhe nevojë materiale, të mbante marrëdhënie me Tashkon. Përgjegjësinë për shërbimet që Noli kishte marrë përsipër me vajtjen në Amerikë dhe detyrimet që do të rridhnin prej saj, do t'i shprehte herë pas here në letra, artikuj a libra duke gjetur mundësinë t'ia kthente kësisoj mirënjohjen udhërrëfyesit apo mirëbërësit të tij: “Këtë shërbim ja kam borç mëmëdheut dhe juve që më dërguat”, apo që “jam mjaft njeri që kupëtoj përse më dërguat këtu dhe desha gjithënjë t'i nderoj të hollat që më dhatë kur shkova nga Misiri”.

Por nuk mund të thuhet se marrëdhëniet e Tashkos me Nolin shkisin gjithnjë si mbi vaj. Si më i madh që ishte, por që e ndjente ende veten në rolin e udhëzuesit, Tashkoja nuk do të linte pa i thënë Nolit atë që ai mendonte se e kishte të drejtë:

“At Fan Noli pra le të lajmërohet mirë përpara e pastaj të kritikojë njerëzit. Duhet të gjykonjë pakëz pastaj të kritikojë, se kështu ftohen atdhetarët, kur nuk çmohet pun' e tyre. Me të tilla mënyra dijnë që janë ftohur sa e sa atdhetarë, se neve Shqipëtarët zëmë më një e më dy e kritikojmë e shajmë njerëzit pa gjykuar mirë punërat e tyre. Pastaj është dhe një tjetër sent. At F. Nolin e nderojmë si Prift Shqipëtar, po jo si politikan. At Fan Noli është një Prift, edhe si Prift duhet të shikonjë punëzën e tija; duhet të kthenjë libra kishe; të thotë meshën në kishë, të pagëzonjë, të varrosnjë të vdekur, të predikonjë në kishë, edhe më tepër të bëjë propagandë për kishën kombëtare; këto duhet të bëjë At Fan Noli e jo të merret me politikë edhe të kritikojë botën pa arsye e pa të drejtë. Sicili të shëkonjë punën e tijë. Një ditë Fan Noli shkroi te “Dielli” që të bëhet Profesor në Shkollë Normale, se duket që ju paska mërëzitur priftëria; nesër At F. Noli do të shkruanjë, si duket, që t'a zgjedhin Shqipëtarët deputet për në Parlament të Turqisë; pas nesër munt të shkruanjë t'a bëjnë edhe Ministër! At Fan Noli le të rrinjë urtë e le të nderohet me priftëllëkun, se t' atilla gjëra nuk i japin nder.”

E si mund ta merrte me mend Tashkoja, që jo ministër arriti të bëhej Fan Noli, por kryeministër i Shqipërisë, dhe jo vetëm prift, por peshkop e kryepeshkop! Fajumi i Tashkos ishte tepër i vogël të rrokte atë frymëmarrje të gjerë që kishte Amerika, ku Fan Noli përveçse e përthithi lirinë e saj, u pasurua me ide nga më krijueset e frymëzueset dhe falë këtyre ideve që në fazën e parë të qëndrimit atje, krijoi shoqërinë “Besa–Besë”, inicioi themelimin e Federatës “Vatra”, ndihmoi në konsolidimin e gazetave “Kombi” e “Dielli”, përktheu dhe botoi libra kishtarë në gjuhën shqipe,

krijoi kishën shqiptare të “Shën Gjergjit” në Boston, inkurajoi “Bandën e Lirisë” në Korçë dhe forcoi lidhjet me patriotët shqiptarë kudo që ndodheshin.

Ndjesia filantropike e Tashkos përmes dëshirës për të dhuruar kohën dhe të hollat për çështjen shqiptare, ishte nga ato anë që ai duket se e kishte më së shumti për zemër. Kjo bie në sy nga letrat që i shkruajnë njerëz të ndryshëm për t’i kërkuar mbështetje në të holla për shoqëritë atdhetare, për gazetatat e reja, për *Bandën e Lirisë* që u themelua në Korçë me dirigjentin e ardhur nga Egjipti, italianin Anibal de Pasquale, për “Shoqërinë Shkollare të Korçës”, për arkën e bashkësisë “Llaso” të Korçës, për individë të veçantë, numri i të cilëve nuk dukej i vogël.

Më ka bërë gjithmonë përshtypje fakti se sa me zemërgjerësi i shpenzonte gjyshi im paratë. *Mos harro që rrojten time e ke në dorë ti. Mos e harro këtë gjë*, – i shkruante Noli nga Bostoni më 23 mars 1907. *Vetëm shpres’ e madhe e Atdhetarisë tuaj të cilën e keni treguar kurdoherë, na forcon në këtë veprë të shënjtëruarë. Andaj që më parë u-ngjatjetojmë për ndihmën që dot na bëni* – i shkruanin nga Korça në tetor të vitit 1908 Pandeli Cale dhe Mihal Bimbli, duke e argumentuar me faktin se *pas lirisë që na u fal në të shtrenjtin Atdhe, Kombi ynë Shqipëtar gjendet ndë një shkallë më të poshtërë se gjithë kombet ndë mbretërit Osmanie, andaj për të përparuar ndë udhë të qytetërimit filluam një Shoqëri të Muzikës me emër “Band’ e Lirisë”, e cila ka për qëllim të bërit e një muzike kombiare edhe për të mësuarë djemt’ e shkollavet muzikën dhe gjimnastikën.* Por edhe atëherë kur veprimtarët e qortonin Tashkon që do duhej të ishte më i urtë në gjykimet mbi ta, letrën do ta përmbyllnin me kërkesën: *“Të lutem në ke para, verë 5 lira nga mua, në mos dërgo vetëm 2 lira”*. Shumëkush mendonte që kur të gjendej në nevojë, do të ishte Athanasi ku do mund të falej që të dilte nga halli!

Së fundi edhe nja dy fjalë për natyrën e tij si njeri, pra për karakterin e tij. Natyrën e kishte të vullshme për t’u këmbyer shpejt edhe në shpërthyesë, por arsyeja dhe veçanërisht parimet e bënin të shtrohej e të gjykonte. Edhe në shkrimet e tij i gjen të dy aspektet e karakterit: atë të shpërthimit, si dhe atë të urtësisë, këshillave e arsyetimit. Shkrimi, pra të shkruarit, flet më së shumti për karakterin e tij; kur koka i ndizej, shkrimi i hallakatej, zhgarravinat dhe gabimet ortografike i shtoheshin, radhët e rreshtave dukeshin sikur vallëzonin në faqen e letrës. Kur e nxehta i binte dhe koka i ftohej, niste të mbizotëronte gjykimi e urtësia, shkrimi latohej, rregullsia merrte vlerë, ë-të në fund të fjalëve shtoheshin si për t’i dhënë kohë mendimit të shtrohej. Forca e karakterit dhe e shpirtit, parimet, besimi dhe bindjet ushqenin kredon e tij, për ta

shndërruar atë në aksiomën personale se *Atdhetarija ime nuk' është për reklamë, për qejf, a për interes, është detyrë njeriu me ndjenja të njerëzinjta.*

Me gjithë natyrën e ndezur dhe shpesh ndeshëse të Tashkos, ai pati miq të mirë rreth e rrotull tij, të cilët i vlerësonin para së gjithash ndershmërinë dhe patriotizmin dhe si të tillë këta miq i qëndruan deri në fund, madje edhe për vite të tëra pasi ai u largua nga jeta. Një nga më të veçantët të tillë ishte Jani Vruho, i cili ndihmoi edhe për shitjen e pronave përpara se e shoqja, Eleni dhe fëmijët të ktheheshin përfundimisht në Shqipëri më 1921. Fan Noli, në forma nga më të ndryshmet e në kohë të ndryshme iu referua herë pas here jo vetëm Tashkos vetë (përveç letrave), por edhe fëmijëve të tij, madje me dy djemtë e mëdhenj, Koçon dhe Anastasin (Arturin), ai punoi ngushtë për çështjen shqiptare, ndërsa njëerës vajzë i doli në mbrojtje me një artikull në “Republika” të Bostonit më 27 nënor 1931, kur asaj iu pre bursa në Francë nga administrata shqiptare e kohës.

Athanasia ishte i lidhur shumë me Korçën. E kam shkruar që në krye të librit që ishte bërë traditë që çdo verë familja Tashko të shkonte në Korçë për të kaluar një copë kohë edhe tek familja e së shoqes, Zografëve, shtëpia e të cilëve qëndroi si ndërtesë, ndonëse në rrënim e sipër, deri fare vonë, në vitet 2000. Çdonjëri prej fëmijëve i lindur në Fajum, do të sillej edhe në Korçë që në moshë të mitur si për të marrë bekimin e qytetit. Në një letër që i dërgon nga Korça e ëma të birit, Athanasit, më 6 mars 1911, tregon për atë që edhe ime më të ishte larguar nga Misiri dhe të ndodhej në Korçë kur ende ishte tre muajshe. Ja një fragment nga letra e të ëmës së Athanasit e përkthyer nga greqishtja: “Fëmijët tuaj, Caci, Katina, Gaqoja, Lekoja dhe Tefta ju puthin të djathtën dhe janë mirë deri tani, shëndeti s’u ka pësuar asgjë. Po ashtu, edhe zonja tënde, Eleni, të përqafojnë ngrohtësisht dhe është mirë. Motrat e tua, Zoica dhe Parashqevi të përqafojnë” (*AQSH, F 9, D. 15, fl. 4*). Fotografitë e kohës gjithashtu i kanë të fiksuara këto momente familjare me karakter thellësisht solemn.

Ndonëse në këtë libër i kam qëndruar kryesisht fakteve dokumentare dhe më pak interpretimeve personale, e aq më pak atyre emocionale, dashur pa dashur marrëdhëniet e Tashkos me Korçën më dalin të kenë qenë jo vetëm intensive, por të shihet një lloj graviteti me këtë qytet deri në kufijtë e të habitshmes. Gjithsesi, faktet janë kokëfortë dhe me sa duket kanë dalë në pah edhe jashtë prirjes sime për t’u përmbajtur.

Dr. RRAPO ZGURI
Fakulteti i Histori –Filologjisë
Universiteti i Tiranës

ATHANAS TASHKO MES GAZETARIT DHE MISIONARIT

Veprimtaria mediatike e Athanas Tashkos nis në vitin 1905, rreth 10 vjet përpara se ai të ndërronte jetë. Gjatë kësaj dekade ai shfaqet si botues, por edhe si autor shkrimesh. Shkrimet e Athanas Tashkos i gjejmë në tre grupe:

1. Një pjesë e tyre janë botuar në gazetat “Drita”, “Kombi”, “Dielli”, Liri e Shqipërisë”, “Lirija” dhe “Koha”,
2. Një pjesë janë botuar në gazetën që ai vetë e themeloi në vitin 1907, me emrin “Shkopi”,
3. Pjesa tjetër janë shkrimet e mbetura në dorëshkrim të cilat sot gjenden më së shumti në Arkivin Qendror të Shtetit.

Pothuajse i gjithë korpusi i shkrimeve të tij janë përmbledhur gjithashtu edhe në monografinë dinjitoze me titull “Athanas Tashko” të Eno Koços, e cila sapo ka dalë nga botimi.

Për nga numri, artikujt e Athanas Tashkos nuk i kalojnë disa dhjetëra të tillë, por për nga përmbajtja dhe rëndësia ato mund të konsiderohen si një kontribut me vlerë në historinë e shtypit shqiptar. Modest, por edhe i ndërgjegjshëm për vlerën e punës së tij, Tashkoja shkruan: “*Po të ketë vënt në këtë kohë për fjalët e mija, atëherë arrijnë dhe këto të pakta*”(AQSH,F.97,D.5,fl.6).

Ky punim merr përsipër të analizojë kontributin mediatik të Athanas Tashkos, duke u fokusuar në akset kryesore të diskursit të përmbajtjes si dhe në zhanret gazetareske të lëvruara prej tij. Nga pikëpamja metodologjike, studimi është bazuar në analizën e përmbajtjes, analizën tekstuale dhe në analizën e zhanreve. Ndërkohë, gjetjet sasimore alternohen me gjetje cilësore, për ta bërë më të plotë kuadrin analitik të punimit. Punimi ka shmangur analizën e standardeve profesionale, për faktin se pothuaj i gjithë shtypi shqiptar i periudhës së Pavarësisë nuk u krijua si një shërbim profesional i shtypit, por kryesisht si një kanal informimi dhe mjet mobilizimi i vënë tërësisht në shërbim të lëvizjes për identitet kombëtar dhe për liri e pavarësi të vendit.

Diskursi i përmbajtjes së shkrimeve të Tashkos

Veprimtaria mediatike e Athanas Tashkos u zhvillua në një periudhë të rëndësishme të procesit të sendërtimit të kombit dhe të identitetit kombëtar shqiptar.

Jemi në kohën kur krahas lëvizjeve të armatosura për liri dhe pavarësi, ka nisur të krijohet dhe të konsolidohet edhe infrastruktura kulturore e identitetit dhe e lëvizjes kombëtare, me elementë të rëndësishëm të saj si gjuha e shkruar, shtypi dhe letërsia shqipe. Krahas evokimit të traditave dhe të historisë, krahas komunikimit ritual, mitologjisë dhe metaforave të fuqishme të risjella edhe përmes letërsisë dhe folklorit dhe të vëna në shërbim të krijimit të vetëdijes kombëtare, krahas edukimit shkollor kombëtar që po rimëkëmbej me mjaft vështirësi, një rol të veçantë në procesin e komb-ndërtimit do të luante edhe shtypi i kohës, i cili, e ritheksojmë ishte krijuar dhe vënë në punë kryesisht për t'i shërbyer këtij procesi. E tillë ishte edhe krijimtaria gazetareske dhe veprimtaria botuese e Athanas Tashkos; një kanal komunikimi si dhe një tribunë sensibilizimi dhe mobilizimi në shërbim të lëvizjes kombëtare.

Qysh në fillimet e veta, shtypit në botë i është njohur një funksion i veçantë: ai i *agenda setting*, pra i përcaktimit të agjendës së opinionit publik. Këtë funksion, shkrimet dhe botimet e Athanas Tashkos e kanë përmbushur më së miri, duke sjellë në agjendën e ditës problematikën më të mprehtë dhe më emergjente të kohës, atë të çështjes kombëtare.

Nuk gjen pothuajse asnjë shkrim të Tashkos që të mos trajtojë qoftë edhe në një aspekt të ngushtë probleme që lidhen me çështjen kombëtare, andaj, më shumë se sa një punë gazetari, krijimtaria e tij ishte një punë e një misionari të përkushtuar të çështjes kombëtare. Ja se si e formulon Tashkoja kredon e tij personale: *“Unë nukë kam zakon t’i lë punët kombëtare në heshtje, heshtja për mua në të tilla punëra është një turp i madh, punërat e mia tregëtare munt t’i lë pas, po punët kombëtare jo!”*¹

Kjo zgjedhje e gazetarit dhe e botuesit Tashko, bën që edhe përmbajtja e shkrimeve të tij të përshkohet kryesisht nga tri linja kryesore të diskursit:

- diskursi i identitetit kombëtar
- diskursi i unitetit kombëtar,
- diskursi i mëvetësisë kombëtare.

Duke folur për rolin e medias në procesin e komb-ndërtimit, studiuesi Peter Plener vë në dukje se ky rol është i dyfishtë. Nga njëra anë media mund të kontribuojë në mënyra të shumta për formësimin e identitetit kombëtar dhe, nga ana tjetër, ajo mund të shërbejë si një kanal shumë i rëndësishëm komunikimi për komunitetet dhe shoqërinë (Plener, 2005). Disa studiues dallojnë identitete

¹ *Letr’ e Hapët S. Koleas*, P. O. B. 490, Aleksandrie, “Liri e Shqipërisë”, 20 Maj 1912 (No. 42), f. 2, 3.

individuale dhe identitete kolektive dhe, në këtë të fundit, ata përfshijnë edhe identitetin etnik. Lëvizjet identitare kombëtare konsiderohen si lëvizje në kërkim të cilësive dhe vlerave që e dallojnë një komunitet etnik nga komunitetet e tjera.

Në kontekstin historik shqiptar në fillim të shekullit XX, çështja e identitetit kombëtar, e njohjes, afirmimit dhe e përqafimit të tij, kishte marrë përmasat e një çështjeje emergjente. Duke e pikasur me zgjuarsin këtë emergjencë, Tashkoja e trajton dhe analizon atë në disa prej shkrimeve të tij.

Në editorialin e numrit 3 të “Shkopit” me titull “Ç’është Turqia? Ç’janë shqiptarët”, Tashko shkruan: “Shqipëtarët kanë tri besë të huaja: një të Sulltanit të Stambollit, i cili është veqil i Muhametit nga Arabistani, një të Patrikut të Stambollit i cili është veqili i Krishtit grek nga Shami, një të Papës Romës, i cili është veqil i Shën Pjetrit, që mban kyçet e paradajës latine. Besë më vehte shqipëtarët nuk kanë. Ata të Sulltanit thonë: jemi Tyrq. Ata të Patrikut thonë: jemi Grekë. Ata të Papës: jemi Latinë.” Tashkoja vë në dukje në këto radhë faktin se ndarja fetare në tri “besë të huaja”, pra identiteti fetar i trefishtë i shqiptarëve, ka vënë në rrezik identitetin kombëtar të tyre. Edhe mungesa e gjuhës së shkruar, siç vëren në editorialin tjetër të botuar në numrin 2 të gazetës “Shkopi” me titull “Rot’ e botësë t’onë”, ka sjellë të njëjtin rrezik. “Sot për sot, kombi Shqipëtar ndahet nga shkakut i mospasjes së gjuhës të liruarë në dy degë pa trup. Degë Tyrke dhe degë Greke. Degën Greke e bëjnë ata shqipëtarë që janë të krishterë dhe mësohen me gjuhën e Grekutë. Degën Tyrke e bëjnë ata shqipëtarë që janë myslimanë dhe mësojnë gjuhën Tyrke.”

Në editorialin me titull “Destur’ i Myqeremit i Xhonërvet”, botuar në numrin 4 të “Shkopit”, Tashkoja flet për një rrezik të ri që i është qasur identitetit kombëtar shqiptar, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Xhonturqve. Sipas Tashkos, në këtë akt të ri konstitucional Turqit e Rinj i njohin në mënyrë të kushtëzuar shqiptarëve të drejtën e gjuhës dhe të feve, por kur bëhet fjalë për identitetin kombëtar në territoret e kontrolluara prej tyre, ata duan të imponojnë një identitet të vetëm: identitetin Osmanli. “Tani, Turqit’ e Rinj me desturë’ e Mid’hat Pashësë, (i cili për Turqit e për Turqinë është njeri i madh, se u – madhon kombësinë e tyre duke treturë kombet’ e tjerë) thonë jo: Shqipëtarët janë vëllezërit tanë (adhelfoi) dhe janë të lirë të thonë si fshehtazi a në gjumë kur flenë se janë Shqipëtarë, ama, në sy të botësë, n’ evraketë të thuhën’ e të shkruhenë Osmanxhik!” – shkruan autori.

Evidentimi i rreziqeve që i kanosen identitetit kombëtar, bëhet prej Tashkos përmes një retorike të tillë, që tingëllon si një këmbanë alarmi e cila bën thirrje për

shpëtimin, mëkëmbjen dhe afirmimin e këtij identiteti. Kjo strategji e tij si gazetar dhe botues, përputhet edhe me strategjinë e rilindasve të tjerë shqiptarë, të cilët e vlerësojnë njohjen, ndërtimin dhe afirmimin e identitetit etnik kombëtar si një element të rëndësishëm të procesit të komb-ndërtimit në të cilin po kalonte edhe shoqëria shqiptare.

Athanas Tashkoja vlerëson gjithashtu në mënyrë të veçantë edhe rolin e gjuhës në këtë proces identitet-ndërtues dhe komb-ndërtues. Për shumë studiues, gjuha është një nga tiparet më të qenësishme të identitetit kombëtar. I ndërgjegjshëm për këtë, Tashkoja i kushton një vend të konsiderueshëm në shkrimet e tij çështjes së mësimin të gjuhës shqipe dhe përdorimit të saj si në komunikimin ndërpersonal edhe në komunikimin administrativ, profesional dhe atë masiv. Në fejtoren e shkurtër “Vallë pse?”, të botuar në gazetën Drita dhe që deri më sot njihet edhe si shkrimi i parë i Tashkos i botuar në shtyp, përmes pyetjeve retorike synohet sensibilizimi i popullsisë për nevojën e mësimin dhe përdorimit të gjuhës amtare shqipe.² Për autorin, të mësuarit e gjuhës së shkruar amtare është e barabartë me daljen nga verbëria apo nga errësira.

Tashkoja nuk mjaftohet me ngritjen e çështjeve të gjuhës amtare thjesht në rrafsh teorik apo deklamativ. Ai përfshihet me pasionin e tij karakteristik edhe në debatet mbi çështje konkrete që kanë të bëjnë me mësimin e gjuhës. Kështu në disa shkrime rresht ai debaton në gazetën “Koha” me autoritetet lokale dhe Mitropolinë e Korçës për një rregullore të miratuar prej tyre, në të cilën injorohet e drejta për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat greke të Korçës. Në një shkrim tjetër ai debaton me shoqërinë “Bashkimi” të shqiptarëve të Egjiptit për mungesën e gatishmërisë së këtij unioni për t’iu përgjigjur një kërkesë për ndihmë financiare për shkollat shqipe në Korçë. Tashkoja përfshihet gjithashtu edhe në debatin për alfabetin, duke marrë në analizë variante të ndryshme të alfabetit të shqipes që qarkullonin në atë kohë, siç ishin alfabeti i Stambollit apo ai i Shkodrës. Në debatin për alfabetin, këmbëngulja e Tashkos ishte që të huajt dhe sidomos turqit dhe grekët, nuk duhet të përziheshin në punët e alfabetit shqip.

“E mira është të mbledhim mëntë në kokë e të mos rimë të na heqin të huajtë.

Duhet ta dimë se asnjë i huaj nuku është miku jynë, mos pandehin myslimanët shqipëtarë se turku apo xhoni është vëllai jynë, as të krishterët mos e besojnë se greku

² Vallë pse?, “Drita”, Gazet’ e Përdyjavëshme, Mpron të drejtat e kombit shqiptar (Organe albanais bi-mensuel), Adresse: Schahin Kologna, Sofia (Bulgarie), 2 gusht 1905, No. 65. f. 2.

është një me neve sepse falemi në një kishë. Që të dy palët egërsira janë për neve dhe që të na çajnë e të na pinë gjakun përpiqen. Që të dy si kope dhësh na quajnë dhe për të na mjelë na duan. Dëshira e tyre mirret vesh nga puna e abecesë. Ç'kanë ata që na trazonen në punët tona? Përse na duan turqit që kërkojnë të na futin në tufë të tyre duke na bërë abecenë e gjuhës tonë me shkronja turku? Përse greku prapë ashtu kërkon?" (AQSH. F. Athanas Tashko, D. 13, V. 1910–55, fl. 51, 52) - shkruan Tashkoja.

Në vijimin të nevojës për mësimin dhe zhvillimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare, Athanas Tashkoja vlerëson lart edhe rolin e shtypit dhe të librit shqip në këtë proces. Me vizionin tipik të një rilindasi, në një letër drejtuar Faik Konicës ai thotë: "... sa më tepër libra e gazeta ka një Komp, aqë më tepër i qytetëruar quhet." (AQSH, F.9, D.14, fl.5).

Në pranëdhje dhe në alternim apo vijimësi me diskursin e identitetit kombëtar në shkrimet e Tashkos gjendet edhe diskursi i unitetit kombëtar. Ky unitet shihet nga autori në dy plane: Në planin e bashkimit ndërshqiptar, pa dallim feje e krahine, si dhe në planin e njësimin territorial kombëtar. Në një shkrim të pabotuar me titull "Një ngjarje politike", Tashkoja shkruan: "Shqipëtarët nuku ka kush t'i ndajë për shkak feje. Shqipëtarët kanë rrojtur dhe rrojnë të Krishterë e Muhamedanë si një kombësi. As ata që u bënë Muhamedanë Turq, as ata që mbetën të krishterë thanë se janë Grekë a Bullgarë."

Në shkrimin tjetër "Destur' i Myqeremit i Xhonërvet", Tashkoja jep alarmin për ndarjen në vilajete që i bën Kushtetuta e xhonturqve hapësirës ku banonin shqiptarët, duke mos njohur unitetin territorial të Shqipërisë.

"...Kanuni Esasi i Turqëve të Rinj nukë të njeh Shqipëri, po të njeh Janina vilaeti, Shkodra vilaeti, Ysqyp vilaeti, Manastir vilaeti edhe bukadar. Po i ndyeri vjershëtori ynë Naim be Frashëri, i cili u dogj si qiriri për atë Shqipërinë t'onë, si ka thënë për ata që duanë të na shuajnë kombësinë? Na si ka thënë:

N'është se doni të na përpini, atëhere

Nuk është vdekja fundi i njeriut?

Zjarr adha dhe le të digjetë bota e tërë

Kur të humbasëmë neve ta dashurin tënë Atdhe

Le të bjerë dhe qielli dhe perënditë bashkë me të.

Zjarr adha që tani dhe le të digjetë Turqia e tërë me Shqipërinë bashkë. Kur të

humbasim neve të dashurën Shqipëri, atëhere në djall të venë edhe Janina, Shkodra, Ysqypi dhe Manastir vilaetleri!”

Pra, për autorin , alternativat janë: Ose ekzistenca e Shqipërisë si një e tërë, si një njësi unike shtetërore, ose le të shkatërrohet gjithçka, duke nënkuptuar se në vetvete copëzimi në vilajete të çonte në një fund të tillë. Natyrisht, ashtu si edhe në poezinë e Naim Frashërit, edhe në komentin e Tashkos, alternativa e shkatërrimit të gjithçkaje, më shumë se sa një alternativë reale përdoret si një alternativë alegorike, për të theksuar domosdoshmërinë jetike të ruajtjes së unitetit territorial të Shqipërisë.

Përsa i takon diskursit të mëvetësisë kombëtare, ai zhvillohet në kuadër të shkrimeve apo paragrafëve që trajtojnë mes të tjerash edhe çështjen e pavarësisht shtetëror dhe territorial të Shqipërisë. Në artikullin me titull “Ç’është Turqia? Ç’janë shqiptarët” Tashkoja shkruan:

“Ç’duhet të bëjnë Shqipëtarët e vërtetë?”

Titoni me Gorlukofskin, më parë dhe Titoni me Erentalë më pastaj kur u hasnë në Venetik thanë: *“Nëqoftëse Shqipëtarët dot rinë kështu në heshtje si kanë ndenjturë gjer sot, do të rëfejnë se janë të kënaqurë nga qeveria Tyrke dhe neve s’mundim tu bëjmë gjë; dhe le të rinë nën të Tyrkutë. Ama nëqoftëse qahenë dhe këta kundër qeverisë Tyrke (për të cilën është me hak për të qarë) atëhere Shqipërinë dot’ e bëjmë principatë (bejlik) më vehte që të rrojnë dhe shqipëtarët rojtje prej njeriu si gjithë bota”. Tani pas këtyre fjalëve që ka thënë Evropa, Shqipëtarët pa fjalë duhet të bëjnë kryengritje kundër qeverisë Tyrke që të mundnjë dhe Evropa të marrë anë në çështjen e tyre e t’i shpëtonjë nga zgjedha e Anadollakëve.”*

Me një qasje që merr në konsideratë konjunkturën, aktorët dhe faktorët gjeopolitikë të kohës, Tashkoja thekson se që të arrihet mëvetësia dhe që ajo të njihet edhe nga Europa, duhet që shqiptarët të nisin kryengritjen për pavarësi kundër Turqisë. Sipas tij kjo kryengritje “duhet të jetë dy llojesh: një kryengritje brenda në Shqipëri kundër qeverisë Tyrke dhe qeverisë Patrikane dhe një kryengritje e fshehtë në Stamboll brenda, kundër shokëve të Sulltanit...”

Zhanret e lëvruara në gazetarinë e A. Tashkos.

Pas këtij kundrimi të tre akteve kryesore të përmbajtjes, në këtë pjesë do të hedhim një vështrim në terma më të ngushtë profesionalë të gazetarisë, duke u fokusuar tek zhanret e lëvruara në gazetarinë e Athanas Tashkos. Në korpusin e

shkrimeve të Tashkos, dallojmë pesë lloje zhanresh të gazetarisë të lëvruara prej tij: Editoriali (kryeartikulli), Letra e hapur, Fejtoni lokal, Satira dhe Lajmi ose kronika.

Zhanret janë të lidhura ngushtësisht, nga njëra anë me politikën editoriale dhe qëllimet që do të arrijë një gazetar apo organ shtypi dhe nga ana tjetër me përmbajtjen dhe natyrën e informacionit që publikohet. Në këtë këndvështrim, të pesta llojet e zhanreve të lëvruara nga Tashkoja, mund të konsiderohen si më të përshtatshmet dhe më të mirat të mundshme për të përcjellë atë lloj përmbajtjeje që kërkohet dhe që është e lidhur ngushtësisht me sensibilizimin dhe promovimin e çështjes kombëtare.

Sipas studiuesit gjerman të gazetarisë, Stephan Russ-Mohl, editoriali, (ose kryeartikulli siç emërtohet shpesh në shqip), është komenti i nxjerrë veçanërisht në pah dhe më i rëndësishmi i një numri gazete, që jo rrallë pasqyron edhe vijën e saj (gazetës), lidhur me një çështje të caktuar (Russ-Mohl, 2010 :69). Ndër editorialet e shkruara nga Athanas Tashkoja, më të spikaturit janë ata të botuar në tre numra të gazetës *Shkopi*, me tituj: “Ç’është Turqia? Ç’janë shqiptarët”, “Rot’ e botësë t’onë” dhe “Destur’ i Myqeremit i Xhonërvet”. Që të tre këto editoriale paraqesin qasjen dhe politikën editoriale të Shkopit si dhe bindjen dhe predispozitën e botuesit të saj, e cila bazohej thellësisht dhe i shërbente interesit të çështjes kombëtare.

Letra e hapur është një zhanër tjetër shtypi, i përdorur disa herë nga Tashkoja (si përshembull në shkrimet “Letr’ e Hapët S. Koleas”, “Letr’ e Hapur Dhimogjerondisë Voskopojare të Korçës”, “Letr’ e Hapët L. M. T. Sulltan Mehmetit të V në Stamboll”, “Letrë nga Egipti”, “Letër nga Misiri”, etj.). Në rastin e përdorimit të këtij zhanri interesant, kemi të bëjmë me një kalim nga komunikimi ndërpersonal i bazuar tek letra e zakonshme e shkëmbyer mes dy personash, në komunikimin masiv të bazuar tek letra e hapur, ku debati tashmë bëhet publik. Në të gjitha rastet e përdorimit të letrës së hapur, Tashkoja ia ka dalë që të kapërcejë debatin personal dhe të fokusohet në probleme të rëndësishme me interes publik dhe kombëtar, duke i qëndruar zotimit se ai dhe gazeta e tij “Lëvdon ata që janë për të lëvdur dhe qërtan ata që janë për të qërtuarë në punë kombësie; në mërirë të veçanta nuk ngatërronet”.

Edhe Fejtoni dhe Satira janë lëvruar gjithashtu me sukses prej Tashkos. Madje ngjyrimet apo linja të satirës përshkojnë jo vetëm satirat e mirëfillta, por edhe pjesën më të madhe të shkrimeve të tij si dhe vetë gazetën *Shkopi* që u krijua që në fillim si një gazetë satirike. Në monografinë “Athanas Tashko”, Eno Koço shkruan: “Satira e sarkazma ishin tipare të vërteta të Tashkos, tipare këto që mishëroheshin edhe në

qenien e tij, por dhe që u transmetuan në gazetën e tij”. Ajo që bie në sy në lëvrimin e këtyre zhanreve të gazetarisë është një lloj gjuhe e drejtpërdrejtë, si dhe një përdorim i dendur i elementëve dhe i sintaksës së sarkazmës apo të satirës popullore shqiptare dhe veçanërisht të asaj të zonës së Korçës.

Përsa u takon lajmeve të shkruara nga Thanas Tashko, ato nuk janë të shumta dhe paraqiten në formën e kronikave të shkurtra. Numri i pakët i kronikave apo i lajmeve lidhet edhe me faktin se gazeta “Shkopi” dilte një herë në disa muaj dhe kjo nuk favorizonte botimin e të rejave (news) që lidheshin me shqiptarët dhe Shqipërinë, pasi këto të reja deri në daljen e gazetës ishin ‘vjetëruar’.

Në përfundim mund të themi se veprimtaria mediatike e Athanas Tashko mbetet një vlerë e shënuar në historinë e shtypit shqiptar, si për përmbajtjen e botuar edhe për elementë të natyrës profesionale gazetareske, të cilat e bëjnë këtë figurë një ndër pionierët e shtypit të shkruar në gjuhën shqipe.

Literatura:

- Fondi Thanas Tashko, Arkivi Qëndror i Shtetit, Pjesa e fondit e botuar në: Koço, Eno, *Athanas Tashko*, Botime Flesh, Tiranë 2015
- Gazeta “Shkopi”, Kajro, numrat 1, 2, 3 dhe 4, 1907, 1908
- Koço, Eno, *Athanas Tashko*, Botime Flesh, Tiranë 2015
- Plener, Peter, *Media of/and/in nation building - Markers and Scenarios of Identity Formation*, botuar në *Kakanien Revisited*, prill 2005, Link: <http://www.kakanien.ac.at/beitr/theorie/PPlener4.pdf>
- Russ-Mohl, Stephan, *Gazetaria*, K&B, përkthyer në shqip nga Ardian Klosi, Tiranë, 2010

Prof. dr. ALI JASHARI

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

PËR LIBRIN E ENO KOÇOS KUSHTUAR ATHANAS TASHKOS

Sonte Eno Koçoja, nuk ka ardhur në Korçë si artist, por si njeri i letrave, me një dhuratë të çmuar për historinë shqiptare dhe më gjerë, duke na sjellë librin e tij për jetën dhe veprën e Athanas Tashkos, të cilin ua kushton gjithë korçarëve “që im gjysh, sikurse shkruan autori në hyrje të këtij libri, Athanasi, aq shumë u kushtoi energjinë, vëmendjen dhe dashurinë e tij”.

Po cilat janë motivet që e shtynë Eno Koçon të shkruajë këtë libër? Kësaj pyetjeje autori i jep përgjigje në hyrjen e librit, ku shkruan: “Gjatë jetës sime m’u bë mënyrë të vepruari, ashtu e pavetëdijshe, pa më mësuar njeri, që të mbaja shënime për gjithçka që kishte të bënte me familjen time. E kam përmendur diku më herët se kjo mënyrë e të fiksuarit në letër të episodeve jetësore erdhi edhe si pasojë e mungesës së prindërve dhe çdo rrëfim të ri që dëgjoja apo shkrim të panjohur për mua që lexoja, e hidhja menjëherë në fletore duke menduar se një ditë ndoshta edhe do të më duheshin. Koha e solli që shumë nga këto shënime të hershme tani së fundi të më jenë dashur së tepërmi, madje duke i konsideruar ato si burime nga më të besueshmet, më të drejtpërdrejtat, duke u kthyer edhe unë vetë, shënimmbajtësi, në një personazh arkivor për ruajtjen e të dhënave gojore të personazheve që “intervistoj” për t’i fiksuar”.

Ky libër prej afër 540 faqesh nuk mund të futet në kallëpet e klasifikimeve për librat, si monografi, libër dokumentar etj. Për mua ai është një enciklopedi, në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse jep informacione të qëmtuara për një periudhë të gjatë kohore të jetës shqiptare, brenda dhe jashtë, por që ka në qendër një personazh historik, si është Athanas Tashkoja.

Libri është ndërtuar mbi bazën e tre kapitujve, si Egjipti (Misiri), Publicistika, Letërkëmbimi, të shoqëruar me një pashënie, të cilën Eno Koçoja e parashtroi në këtë seancë plenare, pastaj me disa shtojca që përmbajnë materiale shumë interesante si libri i bujtësve në hotel “Moeris”, për letrat e familjarëve të Tashkos etj.

Megjithëse autori është treguar shumë modest në paraqitjen e këtij libri, unë po e mbur atë publikisht, sepse ka shkruar një libër të frymëzuar me fakte dhe

argumente të shumta për të nxjerrë në dritë gjithë personalitetin e Athanas Tashkos, si atdhetar, përkrahës i flaktë i çështjes kombëtare, publicist etj. dhe, shumë drejtime të tjera të veprimtarisë së tij, që e plotësojnë më së miri këtë figurë e që u trajtuan në kumtesat e kësaj seance, si dhe seancën e dytë të kësaj konference.

Libri i Enos Koços nuk do të ishte i tillë, në qoftë se nuk do të kishte dhe bashkautorë të tjerë, të cilët ai i përmend me shumë miradije, siç janë përkthyesit e materialeve nga greqishtja, osmanishtja, frëngjishtja, rusishtja e vjetër, gjermanishtja, polonishtja, estonishtja, holandishtja, suedishtja etj., apo shfrytëzimi i një bibliografie të gjerë me referenca për Athanas Tashkon.

Nuk mund ta lë pa përmendur faktin që Eno Koçoja këtë libër, ende të pabotuar, me shumë zemërgjerësi, e vuri në dispozicion të pedagogëve për ta shfrytëzuar gjatë përgatitjes së kumtesave të tyre për këtë konferencë.

Besoj se nuk e teproj po të them se puna e Eno Koços është si guri i Sizifit, një punë e rëndë, por ndryshe nga Sizifi, Eno Koçoja këtë gur të mbrujtur me dije dhe dashuri për Athanas Tashkon e ngjiti në majë, e nxori në dritë, duke na i dhënë të gjithëve sot këtu, ndaj ju ftoj që ta marrim në dorë atë, bashkë me firmën e autorit, për ta patur si një kujtim të vyer nga kjo veprimtari.

Prof. as. dr. ANYLA SARAÇI (MAXHE)

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

PIKËPYETJET E ATHANAS TASHKOS

(Një vështrim pragmalinguistik në shkrimet e A. Tashkos)

“Ka fraza që përshkruajnë botën, fraza që pyesin për botën dhe të tilla që kërkojnë të ndryshojnë botën” (Kerbrat-Orrechioni, 1991:5). Padyshim pyetjet, si akt pragmatik, lidhen ngushtë me të tri këto rrafshë. Pyetja, si një mjet për të pasur hyrje të lirë në dije, e përfshin praninë e vet në të gjitha tipet e diskursit. Diskursi mediatik është një burim informacioni, ku pyetja përbën një prej proceseve të vjeljes së tij. Gazetarët i përdorin pyetjet për të hetuar, për t’u hetuar apo për të nxitur njerëzit për të hetuar. Diskutimi mediatik, si një proces i larmishëm (politik, social, filozofik, letrar) është shumë afër lexuesit, në kontakt të përditshëm dhe në vazhdimësi.

Shtypi i shkruar në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të kaluar është një nga përfituesit dhe përdoruesit kryesorë të pyetjeve. I paraqitur në forma dhe lloje të ndryshme (kronikë, editorial, reportazh, opinion, portret), pyetja nuk mund të përcaktohet vetëm si proces shkëmbimi informacioni, por edhe proces i ndërlikuar që sjell pas dhe kompleksitetin e diskursit gazetaresk në disa këndvështrime:

- Së pari, në mënyrën se si gazetari i adresohet publikut përmes një pozicionimi të thënies dhe transformon një informacion të thjeshtë në një mendim, ideologji a mesazh politik e kulturor.
- Së dyti, sepse ky lloj informacioni priret të ngjallë debat midis dhënësit dhe tipave të ndryshëm të lexuesit.

Secili lexues mund ta kapë në mënyrën e vet atë që shkruhet dhe efektin që ka mbi të. Në këtë mënyrë pyetja duket të luajë një rol polemik, shpesh duke qenë edhe ironike.

Dihet që vlera ilokutore e një thëniejeje varet në radhë të parë nga karakteristikat sintaksore dhe semantike e frazës gjegjëse. Që një thënie të marrë vlerën e një pyetjeje në planin diskursiv duhet që në planin e strukturës së fjalisë t’i përshtatet një modeli (Jacques, 1981). Në këtë pikëpamje një numër i caktuar karakteristikash gjuhësore të qëndrueshme që karakterizojnë fjalitë pyetëse (sintaksore, semantike, intonative) na lejojnë të specifikojmë tërësinë e strukturave pyetëse dhe të karakterizojmë forcën ilokutore, që mund të specifikohen si veprime të

tilla, si: të kërkosh një informacion, të kërkosh një konfirmim, të kërkosh një gjykim të bashkëkomunikuesit, të tërheqësh vëmendjen e tij, t'i bësh një kërkesë, t'i kërkosh të reagojë (Jacques, 1981: 70).

Nocioni i thënies pyetëse dhe thënies deklarative lidhen pikërisht me referimin ndaj fjalisë si njësi gjuhësore, ndërkohë që, pyetja i referohet aktit ligjërimor që lidhet me vlerën ilokutore të thënies (Therkelsen, 2009: 114). Pyetja, nga pikëpamja logjike nuk është gjë tjetër veçse një dubël i neutralizuar i një përgjigjeje të mëparshme të supozuar që kalkohet kështu mbi përgjigje të pranueshme, të mundshme apo të dëshirueshme (Jacques, 1981: 72).

Kur flasim, ndodh që arsyetojmë, argumentojmë, nxjerrim përfundime, çka na bën të mundur të përcaktojmë një funksion "retorik" të ligjërimin, i cili jo vetëm në termat e logjikës mund të quhet konkludues (inferentielle) (Anscombe 1989: 13). Në këtë mënyrë, analiza e një shkrimi mund të bazohet në mënyrën se si një shkruer, në rastin tonë një gazetar, i përdor strukturat sintaksore me funksion inferencial.

Nëse u referohemi shkrimeve të A. Tashkos, shumica e tyre janë të destinuara për shkrime gazetareske. Ajo çka bie në sy në pjesën më të madhe të këtyre tip shkrimesh (përfshi dhe artikujt e pabotuar, dorëshkrimet apo artikujt e pambaruar) është përdorimi i pyetjeve (në kuptimin e mirëfilltë si një akt pragmatik). Po e theksojmë, pyetjeve dho jo fjalive pyetëse, sepse është pyetja ajo që konsiderohet si një akt ligjërimor (Searle 1969) për të vënë në dukje forcën shprehëse, bindëse dhe argumentative në mënyrën e ndërtimit të shkrimit në dy drejtime:

1- Nga pikëpamja e e ndërtimit të tipit të një lloj "dialogu" të veçantë që merr në konsideratë lidhjen me lexuesin;

2- Nga pikëpamja e ndërtimit të argumentit si një akt për të bindur dhe nxitur reagimin e lexuesit.

Bazuar në këtë përfundim, pyetja është një nga aket e ligjërimin që bazohet në veprimtarinë diskursive dhe përmban lidhje komplekse me to, duke zënë pozicion qendror në gji të të trijave. Kështu, vështrimi pragmatik i fjalive pyetëse në shkrimet e Tashkos do të shihte akte ilokutive, të cilat, në pikëpamje të ndërveprimit verbal sipas konceptit të Anscombe & Ducrot (1976) përbëjnë pyetje polifonike (gjenerojnë më shumë se një përgjigje të vetme).

Për të bërë këtë analizë pragmatike korpusi i studiuar përbëhet nga 35 shkrime të A. Tashkos që u përkasin: a-11 shkrime të plota të nënshkruara me pseudonimin Dora apo AT Korçari të botuar në gazetatat të kohës (janë përjashtuar dy shkrimet në

vargje), në to rezultojnë 9 shkrime me fjali pyetëse; b-4 dorëshkrime të pabotuara, ku vetëm një nuk ka fjali pyetëse; c- 20 shkrime të pambaruara dhe copëza shkrimesh ku 10 rezultojnë pa fjali pyetëse; d- 16 shkrime dhe dorëshkrime të gazetës “Shkopi”, ku 6 rezultojnë pa fjali pyetëse.

1. Në këtë korpus dallojmë tri shkrime në formë dialogu pyetje-përgjigje, njëra dialog me veten si bashkëbisedues dhe dy të tjerat në formën e një bisede të lirë me bashkëbisedues të supozuar konkretë. Shkrimi i parë është shkrimi i mëposhtëm:

VALLË PSE?

“Drita”, Gazet’ e Përdyjavëshme, Mpron të drejtat e kombit shqiptar (Organe albanais bi-mensuel), Adresse: Schahin Kologna, Sofia (Bulgarie), 2 gusht 105, No. 65. f. 2.

1. “Shumë Shqipëtarë janë që duan të mësojnë, të shkruajnë e të lëçitin shqip, po nuk’ e bëjnë dot, vallë pse?

– Pse u ritnë të verbër dhe tani u vjen turp të bënen me sy.

** * * * **

2. Shumë Shqipëtarë dinë mirë të shkruajnë e të lëçitin shqip, po radhonj’t e tregtisë (defteret) i mbajnë në gjuhë të huajë, vallë pse?

– Pse ende s’u ka plasur mirë cipa e erësirësë.

** * * * **

3. Shumë Shqiptarë kanë turp përpara Grekut të thonë që janë Shqiptarë, vallë pse?

– Pse janë njerës të poshtër e të tjerë veshgjatë, janë nga atá që lëpijnë çanakët’.

Ky shkrim titullohet me një pyetje në formën e një fjalie pyetëse të paplotë. Këtë fjali pyetëse e gjejmë më pas në tekst të përfshirë në dy periudha të përbëra nga pjesë të bashkërenditura kundërshtuese me vlerë konstatuese (1, 2) dhe në një periudhë me dy pjesë të nënrenditura kundrinore po me vlerë konstatuese (3). Si pyetjet ashtu edhe përgjigjet kanë vlerën e konstatimit, por ndërtuar mbi bazën e ironisë si ballafaqim i të kundërtave; *duan - nuk e bëjnë dot, shqip-në gjuhë të huaj; Shqiptarë - përpara Grekut*. Përgjigjet përgjithësuese të të Tashkos në fund të fundit janë përmbledhje e të gjitha përgjigjeve të lexuesve në kontekstin e rrethanave historike e sociale në të cilin është shkruar artikulli, që na nxjerrin në kuptimin e derivuar: *të verbër na lanë- deshëm të jemi vetë-nuk u kujdesëm të arrijmë të përfitojmë- nuk mundemi më (shqipja duket si një gjuhë e huaj e cila nuk ka pasurinë e nevojshme për t’u shprehur - kemi frikë ta përdorim se bëjmë gabime - na ul prestigjin)*

Në shkrimin e mëposhtëm kemi një organizim tjetër të tekstit:

YQYMETI TYRK DHE GAZETA SHQIPËTARE

(me shkrimin e Tashkos, pa datë, titulli si në origjinal;

AQSH. F. Athanas Tashko, D. 13, V. 1910–55, fl. 95)

Y. T. – 1. Pse shkruan ti gazetar Shqipëtar, se shoqëria e zonjave Shqipëtare lojti rol në shkollën shqipe? 2. Nuku e di ti se *kanun i esasio kabull etmes* që të ketë në këtë botë shoqëri shqiptare prej zonjash? 3. Nuku e di ti se Liria Tyrke nuku do hicbir vakit të dëgjohenë se ka shkolla shqipe? vërtetuese

G. Sh. – *Aman efendem: ben zan etsen* që konstitucioni *oldu icin: Turkler da adam oldular*

Y. T. – *Alt edersen sen; biz Türkler hiçbir vakitte kabul, etmexiber* që *atam alazlam zire adamolursak poza ghaur oluruz.*

G. Sh. – *Peki efendim, shindi amadem.*

Y. T. 4. Epo pse *jazijor* që Xhavit Pasha *sebependan* u derdh gjaku i Shqipëtarëve? Me demek gjak isqupetari; *kaç para eder ojl gjak, sen bilmesen de bisem ala Turka sheriat dior* që gjaku u malu u ajalu, i shqiptarit janë *ganimet El Turkiin?* [A. T.]

Konteksti i këtij krijimi lidhet ngushtë me një shkrim të Tashkos të po këtij viti, ku shprehet qartë kontradikta e tij me “intelektualët e asaj kohe”

“Të ishinë tradhëtorëtë tanë njerës të pa mësuar dot’ kishim shpresë të bënen njerës të ndershim tani që u lirua gjuha jonë në shkollat me mësime. Po këta janë nga ata q’ i kanë rënë pash e krye Europës, e si dot’ i bëjë njeriu njerës këta? (AQSH. F. Athanas Tashko, D. 13, V. 1910–55, fl. 47, 48).”

Pikërisht për të nxjerrë në pah kontradiktën midis dialogu midis Yqymetit turk dhe Gazetës shqiptare ndërtohet në pyetjet drejtohen nga Yqymeti dhe jo nga gazeta në formën e thënieve pyetëse, e para në formën e periudhe me një fjali pyetëse të pjesshme dhe një dëftore si një thënie pyetëse vërtetuese, kurse pyetja e dytë përbëhet nga dy thënie pyetëse po vërtetuese me periudhë pyetëse të zhdrejta, ku zënë vend fraza me fjalë turke. Ndërfutja e këtyre dy frazave nxit reagimin përmes përgjigjeve të ndërtuara tërësisht me fjalë turke.

Edhe pyetja e fundit (4) ndërtuar me thënie pyetëse ku përzihen fjalët shqipe me turke presupozon një përgjigje si e mësipërmja. Në aspektin ilokutiv këtu kërkohet një pohim, pranim, por nënkuptimi është i qartë, ai nuk lidhet me situatën e diskursit që zhvillohet (intervista), por me faktin që vetë të ashtuquajtuarat “gazeta shqipe” nuk e përfaqësojnë veten si të tilla.

2. Në një pjesë të mirë shkrimesh dallojmë bllok fjalish pyetëse të cilat kanë të njëjtën fjalë pyetëse (ndajfolje a përemër pyetës). Fjalitë pyetëse janë të vendosura të shkëputura, pavarësisht se mund të ishin në një periudhë me bashkërenditje me pjesë pyetëse.

Në shkrimin e mëposhtëm:

LETR’ E HAPËT S. KOLEAS, P. O. B. 490, ALEKSANDRIE

Cairo 17 Korik 1906. “Liri e Shqipërisë”, 20 Maj 1912 (No. 42), f. 2, 3

Këto janë shënimet e mia q’i çova Shoqërisë s’onë, dhe për të cilat kjo Shoqëri S.

Koleas P. O. B. 490, Aleksandrie, me kryetar D-r Adhamidhë, më jep të kupëtonj se



gazeta shqipe, dhe ata që shkruajnë në to, i kanë nënë këpucët në mos gjetkë ku!

Tani unë pyes: Me kësisoj njerës a bëhet dot punë? Një Shoqëri e tillë që, le vetëm se s'bën gjë po s'le as të tjerët të bëjnë nonjë ndihmë për Shkollat Shqipe është më për të vështruar? Këta njerës që quajtkan intrigan dhe njeri shumë të poshtër e pa shok në botë atë që u përpjekërka për të mbledhur ndihma për shkollat shqipe çfarë njerës janë? Këta nukë deshnë t'i ndihnin Shkollës së Korçës as me një mënyrë, unë desha të ndihnja ca me qesen t'ime dhe ca me qesen e shokëve t'im, dhe bëra një radhua ndihmash, e dërgova në shokët, ata e pritën me gëzim të madh, pastaj këta njerës e shtjenë në dorë dhe ja humpasin fare tragën. Përse vallë e bëjnë këtë këta? Ç'është qëllim' i tyre dhe ç'duan? Ç'kërkojnë? Ç'mpshihet nënë rogos? Me ç'të drejtë zaptojnë radhuan dhe s' e lenë të vinjë rrotull e të mbledhin ndihma? Ç'janë këta?

konteksti lidhet me qëllimin e Vëllazërisë, i vënë që në Hyrje: “të përpiqej me anë të shkollave, librave, gazetave, dhe me një fjalë, në ç' do fër udhe për të përndarë diturijen' ndë Shqipërije me anën' e gjühësë Shqip, dhe për të hariturë qëllimin' e vëllazërimit dhe bashkimit të Shqipëtarevetë”.

Nga ana tjetër Tashkoja bën të qartë refuzimin e vëllazërisë për të ndihmuar shkollën shqipe në Korçë.

Forma sintaksore paraqitet në një varg fjalish pyetëse të drejtpërdrejta pyetëse kryefjalore dhe kundrinore me të njëjtin përemër pyetës Ç' dhe derivojnë prej një fjalis kryesore që kërkon qëllim. Renditja e këtyre pyetjeve më tepër se kërkim informacioni jep kuptimin e derivuar se tashmë Vëllazëria e ka humbur qëllimin e vet, duhet të ndryshojë.

3. Disa prej shkrimeve dallohen për bllok fjalish pyetëse ku përgjigja e njërës gjeneron tjetrën po në fjali pyetëse. Në artikullin e mëposhtëm, Tashkoja pas një pranimi të thënies ekzekutuese ku citohet një nen i rregullores për Llason:

ÇUDI E MADHE ME PELLAZGONË No. 51 (16)


“Koha”, Korçë, 16 Prill 1912 (No. 9)

Nyji 7 për Llason thotë: “Krerët e Llasos duhet të jenë vënë në Bankën Kombëtare të Greqisë a në nonjë bankë tjetër Greke”. Mirë, përse zotëni duhet (!!!) të jemi vënë në bankët e Grekëve? Kaqë të sakta janë Bankatë Greke? Pa dhe pse? Parat' e Korçës e të Korçarëve, t'i punojnë Grekëtë, e të mos i punojnë Korçarëtë? Më batakçinj se Grekëtë janë Korçarëtë? Dhimogjerondia Voskopojare e Korçësë thotë se: “Po t' ua japë paratë Korçarëve t'i punojnë do i humbasë Llasoja”. Atere dhe ne themi: “Pse Rafaili i Risto Avramit Sulejman ef. Mborja, e shumë fajdexhinj të tjerë, nuku i humpnë parat e tyre po përkundrazi, duke i dhënë me Belbefa, i shtuan aqe sa kanë zaptuarë po thuaj se gjysmën e Korçësë? Pse nuku na thotë kanonizma sheshazi që ta dimë edhe ne, se ... Korçënë Dhimogjerondia e ku i dërgon kjo Mitropolia

Orthodhokse? Të venë të bëjnë një komunitate Shqipëtare më vehte. Po atëhere pse gris robotë Patrikana (dhia ta pronomia) kur këta kërkojnë komunitet më vehte? Ajo pandeh se akoma gjendemi në kohërat e Sulltan Hamiditë që nuku njihte Shqipëtarë e të tjerë po vetë Rumër.

Konteksti lidhet me polemikën me gazetën “Pellazgoz” të cilin ai e konsideron si: “...një organ i Greqisë ngrehur në Korçë për të ndezurë e të mos shuhenë ndjenjatë greke (ta Eliniká fronimata) që kanë Korçarëtë grekomanë. Ai referohet pikërisht Nyjit 7 për Llason ku thuhet se: “Krerët e Llasos duhet të jenë vënë në Bankën Kombëtare të Greqisë a në nonjë bankë tjetër Greke”. Forma sintaksore paraqitet përmes skemës së dhënë .

Tërësia e fjlaive pyetëse na drejtojnë te kuptimi i derivuar se Llaso mbledh fonde nga të krishterët (por përdoren vetëm nga të krishterët helenë - sipas përcaktimit në nyjën e parë të Kanonizmës së Bashkësisë Greke), favorizim qarqesh të caktura ekonomikisht në dëm të çështjes kombëtare.



4. Së fundi dallojmë dhe përdorimin e pyetje për të ndërtuar strukturën e tekstit. Këtu mund të vëmë në dukje dy shkrime shumë interesante në përdorimin e pyetjeve.

Në shkrimin e parë me titull “Ç’është Turqia? Ç’janë shqiptarët?”, secila pyetje shërben si titull për ndarjen e tekstit në tri pjesë. Pyetjet marrin përgjigje të drejtpërdrejtë duke u vendosur në lidhjet e tyre shkak-pasojë. *Si qeverisen Tyrqitë? Ç’janë Shqiptarët? Ç’duhet të bëjnë Shqiptarët e vërtetë?*

Në shkrimin e dytë pyetja në fakt është një, pavarësisht formës sintaksore.

DONME

(me shkrimin e Tashkos, pa datë, titulli është origjinal;

AQSH. F. Athanas Tashko, D. 13, V. 1910–55, fl. 80–90)

- (1) Të pakë njerës në këtë botë janë ata që e dinë ç’do me thënë “Donme”...

- (2) Neve tani dot’ mundohemi ti japim botësë me anë të shtypitë të kuptonjë ç’është “Donme” dhe u lutemi atyre zotërinjve që dot’ mos u vinjë mirë të çpallurit e këtyre mendimeve tona...

- (3) Çdo me thënë “Donme”? Donme thuenë gjithë sa Çifutë kanë ndëruar farën dhe janë bërë Muslimanë...

Pyetja e parë (1) është një konstatim në formën e një pyetjeje të zhdrejtë, e cila nuk merr përgjigje, por bëhet burim argumenti për pasojat e kësaj dukurie. Edhe

pyetja e dytë (2) nuk ka për qëllim të shpejtojë konceptin “Donme”, por shërben si një mundësi për autorin të shpallë dhe të mbrojë mendimin e vet përballë atyre që nuk pajtohen me të. Vetëm pyetja e tretë (3), më tepër se një përgjigje të drejtpërdrejtë, është një shpjegim sa i lidhur me kontekstin historik, po aq dhe me qëndrimin e vet politik.

Mbështetur në këtë panoramë, stili i të shkruarit të Tashkos mund të karakterizohet si një stil polemoko-ironik, shpesh në kufijtë e konfliktualitetit qoftë për konotacionin negative të fjalëve që përdor, por mbi të gjitha për ndërveprimin verbal të mbështetur mbi pyetjet gjithmonë në kërkim të debatit, kundërshtisë si mjet argumentimi. Ndoshta këtu qëndron dhe forca shprehëse e një gazetarie polemizuese për kohën, ku kundërsharët, pavarësisht pozitës, numrit dhe madhësisë vihen në provën e detyrimit të përgjigjes.

Referenca

- Anscombe J.-C., Ducrot O., (1976) *L'argumentation dans la langue*: Langages, 10^e année, n°42, 1976. Argumentation et discours scientifique. pp. 5-27.
- Anscombe, J. C., (1989) *Théorie de l'argumentation, topoi, et structuration discursive*, Revue québécoise de linguistique, vol. 18, n° 1, 1989, p. 13-55.
- Francis, J., (1986), *L'interrogation, force illocutoire et interaction verbale*. In: Langue française, n°52, 1981. L'interrogation. pp. 70-79.
- Kerbrat-Orrechioni, C., (1991) *La Question*, Lyon: PUL.
- Searle, J.R. (1969) *Speech acts: an essay in the philosophy of language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Therkelsen, R., (2009) *Comment identifier une question polyphonique*, Langue française 2009/4 (n° 164), p. 113-122.
- <http://id.erudit.org/iderudit/602639ar>
- <http://www.cairn.info/revue-langue-francaise-2009-4-page-113.htm>.
- http://www.persee.fr/doc/lfr_0023-8368_1981_num_52_1_5107.
- http://www.persee.fr/doc/lgge_0458-726x_1976_num_10_42_2306.

Shënim: Si burim i gjithë materialit dokumentar të shfrytëzuar në këtë kumtesë, ka shërbyer vepra e të mirënjohurit Eno Koço “Athanas Tashko (1863-1915)”, botimet FLESH, Tiranë, 2015.

Prof. as. dr. DION TUSHI
Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

AMBIENTI KORÇAR PËRGJATË GJYMËS SË DYTË TË SHEKULLIT XIX DHE ATHANAS TASHKOJA

Poeti i njohur Lasgush Poradeci, rilindës për nga formimi siç është cilësuar, me aktivitet të gjerë në Bukuresht, kur ka dashur të shprehet për shpjegimin e nyjeve më të rëndësishme në historinë e kombit tonë ka thënë: “Në zinxhirin e historisë së kombit tonë ndalemi në disa pika të rëndësishme, së pari tek Pellazgët, për të cilët nuk kemi dhe aq shumë për të thënë, së dyti tek Ilirët, së treti tek figura e Skënderbeut dhe së katëri tek Rilindja. Pa Rilindje nuk ka qytetërim, dhe Rilindjen tonë Kombëtare e bënë korçarët, që për nga vetë natyra ishin njerëz të mençur dhe kishin edhe intelektualë të zotë, por mbi të gjitha në rradhët e tyre ishin dhe milionerët që e sponsorizuan këtë lëvizje”(Poradeci ,1998). Midis mjaft patriotëve, në krye të të cilëve qëndronte plaku milioner Anastas Lakçe, poeti përmend edhe Athanas Tashkon, për ndihmën e tij të madhe monetare dhe morale, ku ndër kontributet e tij më të përmendura është ndihma e përgjithshme që ai i ofroi Fan Nolit, për përmbushjen e objektivave të tij, në ShBA, për të cilin ky i fundit do t’i ishte përjetë mirënjohës, ndjenjë që do ta shprehte edhe në mënyrë publike me një veprim mjaft fisnik dhe të veçantë, në përkthimin e pjesës së parë të “Don Kishotit”, ku në krye të kopertinës lexojmë dedikimin kushtuar: “Athanas Tashkos dhe Joan Vruhos”.

Është shumë i rëndësishëm fakti të shpjegohen disa karakteristika të veçanta, të qytetit të Korçës, prej të cilit dolën një grupim shumë i madh patriotësh, donatorësh dhe filantropësh, të cilët si brenda dhe jashtë atdheut u përpoqën për emancipimin kulturor dhe ndërtimin e një fizionomie europiane të qytetit të tyre edhe më gjerë. Për këtë, është mëse e nevojshme një analizë retrospektive e gjendjes sociale të këtij qyteti, sidomos përgjatë gjymës së dytë të shekullit XIX, kur qyteti forcon së tepërmi karakterin e tij urban dhe interesohet për një arsimim cilësor, të fëmijëve të tij.

Grupimet shoqërore qytetare korçare në fillimet e shekullit XIX, të karakterizuara nga një shpirt pragmatist dhe dëshirë për një jetë më të civilizuar, synuan drejt një hopi të ndjeshëm cilësor të nivelit të tyre jetësor. Pikërisht, në këtë

periudhë, kur Korça konsiderohej si një qytet i vogël i Perandorisë Otomane në Turqinë Europiane, ajo vuante para së gjithash koseguencat negative që rridhnin prej një pushteti absolut të centralizuar, administrata e korruptuar dhe regressive e të cilit nuk të krijonte as iluzionin më të vogël se gjërat mund të përmirësoheshin së brendshmi dhe, për pasojë, as dëshirat dhe aspiratat e popullatës nuk mund të gjenin realizim qoftë dhe në një minimum të mundshëm, brenda politikave që ndiqeshin. Kështu në këto kushte edhe këta, fillimisht si emigrantë të thjeshtë në vendet ku u instaluan, me pikënisje Egjiptin, apo Misirin, siç quhej rëndom në gjuhën popullore, me kalimin e kohës filluan të bënin diçka për atdheun e tyre, për të inkurajuar besimin dhe shpresën e patriotëve të tyre në vend, si dhe për t'i dhënë një fytyrë të re vendit të varfër, i cili u fali atyre vetëm një gjë; udhën pa alternativë të emigrimit. Kështu e nisën veprimtarinë e tyre filantropët dhe emigrantët e parë korçarë si Anastas Avramidhi (Lakçe), Jovan Banga, vëllezërit Adhamis, vëllezërit Doko etj. Mënyra e atëhershme e organizimit e komunitetit ortodhoks me qendër administrative Mitropolinë e Shenjtë dhe Dhimogjeroninë afër saj, dha shembullin më të mirë në mirëmenaxhimin e shumave të dërguara nga djersa e emigrantëve, duke i dhënë prioritet arsimimit të fëmijëve në vend, krijimit të infrastrukturës optimale për këtë gjë, duke tërhequr nëpërmjet pagave të larta profesorët më të mirë të rajonit, dhënies së bursave për në Perëndim për përgatitjen e intelektualëve, ndërtimeve social – kulturore si dhe urbanizimit të qytetit.

Pikërisht në këtë kohë dhe në këtë klimë të përgjithshme, fillon të formohet dhe merr mësimet e para në shkollën elementare dhe më pas në gjimnazin e këtij qyteti edhe Athanas Tashkoja, për t'i vazhduar ndoshta edhe në Lice, i cili funksiononte i plotë në Korçë qysh nga viti 1856.

Në përgjithësi arsimimi në gjuhën greke, jo vetëm në arsimin fillor, por edhe në atë të mesëm me licetë cilësore që u ngritën në Janinë, Voskopojë, Korçë e gjetkë, të cilat u krijuan dhe u mbajtën nga komunitetet ortodokse dhe kisha, u parapërgatit një kultivim dhe arsimim elitari i një plejade, që më vonë do të luante një rol të rëndësishëm jo vetëm në jetën shoqërore, por sidomos në atë gjeopolitike, si dhe në zhvillimet gramatologjike dhe filologjike të gjuhës shqipe. Kështu emra të tillë si Ismail Qemali, Naim e Sami Frashëri, Jani Vreto, Kostandin Kristoforidhi, Thimi Mitko, Themistokli Gërmenji, Mihal Grameno, e sa e sa patriotë të Rilindjes dhe shkrimtarë me emër që e filologjizuan dhe kultivuan gjuhën shqipe, kanë qenë pa përjashtim nxënës të këtyre shkollave, ku nëpërmjet edukimit klasik, merrnin njohuri

jo vetëm në dije, por edhe në letërsinë dhe filozofinë antike greke dhe nëpërmjet vargjeve të Homerit, Pindarit, e poetëve të tjerë klasikë, njiheshin me koncepte të tilla; si rëndësia e gjuhës amëtare, e shkrimit dhe arsimimit, atdhedashuria, sakrificat sublime në emër të idealeve, ku ai patriotik ishte më i larti, të lëna këto në harresë në atë kohë, jo vetëm për popullin tonë, por për pothuajse të gjitha popullatat e Ballkanit, që për shekuj me rradhë, duke jetuar nën hijen e perandorive që i linin vendin njëra - tjetërs, i kishin humbur këto nocione.

Pikërisht, diçka e tillë, është konstatuar edhe në një konferencë ndërkombëtare filologjike mbajtur në vitet '50 të shekullit të kaluar në Bukuresht të Rumanisë, ku u përfaqësua edhe vendi ynë. Studiuesi Ilo Mitkë Qafzezi, si pjesëmarrës në këtë eveniment, na informon se njëzëri nëpërmjet argumentimit, u arrit në konkluzionin se gjuha dhe kultura greke e përhapur nëpërmjet shkollave në Ballkan, ka luajtur një rol parësor në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popujve ballkanas, pasi nëpërmjet madhështisë dhe frymës patriotike dhe demokratike të letërsisë dhe filozofisë antike, u arrit të krijohen premisat për një emancipim dhe edukim kombëtar dhe europianist të një plejade të tërë ballkanike, që do të merrte më pas në dorë fatet e vendeve për të luftuar pushtuesin, si dhe për liri dhe prosperitet. Produkt i një formimi, të tillë ka qenë edhe Athanas Tashkoja. Vlen të pëmendet fakti se gjuha frënge në shkollat fillore të qytetit të Korçës mësohej si gjuhë e dytë qysh që nga viti 1850, kur ajo u fut që në klasën e parë fillore për të vazhduar deri në lice.

Pikërisht diçka e tillë ndihmoi mjaft emigrantët e vendosur kryesisht në Egjipt, për të ushtruar tregtinë dhe bizneset e tyre dhe për t'u shtrirë më gjerë në Europë. Konsekuencë e këtij formimi është dhe krijimi i gazetës "Shkopi", e cila i shërbeu si një tribunë për shprehjen e idealeve të tij në shërbim të kombit, si dhe letërkëmbimi me dhjetëra personalitete të fushës së kulturës dhe nacionalizmit si Kristo Luarasi, Shahin Kolonja, Abdyl Kardhiqi, Aleksandër Xhuvani, Spiro Gjika, Th. Thanasi, Thanas Dine, Loni Llogori, Veli Këlcyra, Fehim Zavalani, Konstantin Mitko, A. Bonatti, Pandeli Cale, Dhori Qiriazi, Vaskë Gorguzi, Koço Kotova, Cile Vreto, D. Adhamidhi, Ferid Toptani, Fezil Toptani, Fejzi Deshnica, Orhan Pojani, Ibrahim Themo, Sokol Bazi, Vasil Llogori, Vani Çekani, Vëllazëria Qerenxhi, Milo Duçi, Llambi Petri, Jani Vruho, A. Konomi, Sami Kulla³ etj.

Ajo që të bën para së gjithash përshtypje, është fakti se Athanas Tashkoja,

³ Letra të veprimtarëve shqiptarë drejtuar Athanas Tashkos

nëpërmjet edukimit dhe frymës që përçoi brenda familjes së tij, vazhdoi të kontribuojë, edhe mbas vdekjes së tij. Kështu, gjatë gjysmës së dytë të dhjetëvjaçarit të dytë të shekullit XX , familja e tij kthehet në atdhe, vendoset në Korçë dhe vazhdon të edukojë dhe arsimojë me shumë sakrificë dhe largpamësi fëmijët e saj, për t'i kthyer pothuajse të gjithë përsëri, për të kontribuar për atdheun e tyre. Nëse ata nuk do të vinin, por do të ndërtonin jetët e tyre në Perëndim apo kudo gjetkë, ndoshta do të krijonin një jetë shumë më cilësore dhe më të lehtë se ajo që pinjollët e radhës së parë të Athanas Tashkos, jetuan në Shqipëri. Prapa këtij vendimi, qëndronte patriotizmi i vërtetë, që bazohej në vlerat dhe kontributet, për emancipimin dhe europianizimin e vendit, që ata e trashëgonin nga babai i tyre dhe kontributi i gjithsecilit ka qenë me të vërtetë më tepër se i çmueshëm, pavarësisht fatalitetit dhe kushteve politike.

E theksojmë këtë fakt, pasi është një ndër rastet e rralla, kur potenciale të tilla intelektuale dhe ekonomike, të drejtuar nga një idealizëm i pastër, vinë dhe vendosen në këtë periudhë, sidomos mbas viteve 20 të shekullit të kaluar në Korçë. Në Maj të vitit 1920 (Zoi, 2000: 130) , Korça i bashkohet zyrtarisht administratës së shtetit të sapoformuar shqiptar. Nëse do të vërejmë statistikën e kësaj periudhe, do të konstatojmë se përgjatë viteve 20 – 30, të shekullit të njëzetë, dhjetëra familje të vjetra qytetare korçare janë larguar për të mos u kthyer më kurrë, për t'u vendosur përfundimisht në qendra të zhvilluara të Ballkanit, Europës dhe botës.

Të frymëzuar nga një shpirt pragmatik ata morën me vete kapitalet monetare dhe intelektuale dhe e ndërtuan jetën e tyre të sigurt për pinjollët e tyre larg vendit. Po të futim këtu edhe ata mijëra emigrantë, të evidentuar nga zyra e emigracionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ikën nga zona e Korçës për në ShBA në këtë periudhë, mund të kuptojmë rëndësinë e këtij veprimi të familjes Tashko, për t'u kthyer dhe kontribuar në vendin e të parëve, dhe vetëm për këtë veprim kombi shqiptar duhet t'u jetë përjetë mirënjohës.

Referenca

Lasgush Poradeci: “Ditar dhe Kujtime”, Tiranë 1998.

Nikollaq Zoi “*Memorjet e mia*”, Korçë 2000.

Sotir Papahristo “*Shënime biografike*”, Dorëshkrim.

Letra të veprimtarëve shqiptarë drejtuar Athanas Tashkos.

Dr. ERIS RUSI

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

MANJOLA TËRSHANA

Universiteti i Arteve, Tiranë

LIRIA NËN PSEUDONIM DHE KRITIKA SARKASTIKE NË PUBLICISTIKËN E ATHANAS TASHKOS

Ky punim mund të nisë me një nga rastet më polifonike të krijimit artistik, shembulli i autorit portugez Fernando Pessoa, i cili ekstremizon përthyerjen e identitetit të tij në dhjetëra pseudonime dhe identitete të tjera. Është 8 marsi 1914, një nga ato ditët me “dritën e përsosur” gjatë të cilave, duke flakur tutje erërat atlantike të lumit Tago, Lisbona shndërrohej në verbuese. Rrugët kryqëzohen nga njerëz me etni dhe idioma të ndryshme, me aromën e një nostalgjie të perandorisë së vjetër të dikurshme portugeze, tashmë në kalbëzimin e saj. Anijet e ankoruara në port gati të shkarkojnë kafënë që mbërrin nga Brazili, çajin nga Makao, aroma dhe erëza nga Timori, dru nga Angola. Në dhomën e një shtëpie me nr. 24, në rrugën Passos Manuel, një njeri shkundet nga topitja e së dielës. Kërcen më këmbë duke u luhatur si nën ca drithërima nga ku nuk arrin të përcaktojë natyrën, mbështetet mbi një komo të lartë, merr fletë dhe i vë në makinën e shkrimit.

Pessoa prej muajsh dëshiron t’i bëjë një shaka një mikut të tij, duke shpikur një poet bukolik, goxha të sofistikuar, për t’ia shitur sikur të ekzistonte vërtet. Nën këtë përfytyrim, hedh në letër 30 poezi shpejt e shpejt dhe i firmos me emrin e poetit të ri “të shfaqur” brenda tij nga një botë paralele: Alberto Ciero, neopagan dhe antimetafizik. Rrëmben pastaj letër dhe krijon gjashtë poezi të reja, ku shkruan duke u rikthyer në vetën e parë, një provë e vetvetes dhe e ekzistencës së jetës.

Nuk mjafton, pasi tashmë është nën tundimin e krijimit të jetëve të tjera: dalja nga anonimatit është shumim i identitetit të tij, në identitete të reja dhe të pavarura. Çdo krijesë me emrin e së cilës firmos, ka një jetë autonome, një biografi, shenjë horoskopi dhe filozofi, traditë dhe zakone personale. Këto figura hyjnë në marrëdhënie me njëra-tjetrën, e lind kështu mjeku monarkik i zhvendosur në Brazil Rikardo Reis; futuristi dhe nihilisti Alvaro de Campos, inxhinier detar i diplomuar në Skoci; Bernardo Soares, që i ngjan shumë atij, e më tej, akoma shumë të tjerë. Derisa bëhen 135 bashkautorë. Kjo është një antologji marramendëse, një letërsi e tërë.

“Ajo ishte dita triumfuese e jetës sime” (Tabucchi , 2001), do të tregojë më vonë Fernando Pessoa, në një letër që i dërgon Adolfo Monteiros, mikut të tij.

Sikundër shohim, prirja për të shkruar nën pseudonim, apo për të trajtuar ngjarje dhe situata nën petkun e anonimatit, ka qenë mjaft e fortë që në fillim të shekullit të shkruar. Në rastin e Pessoa-s kemi identifikimin me secilin nga personazhet e krijuar që nënshkruajnë për të.

Nëse e zgjerojmë interpretimin e këtij mendimi mbi jetën dhe veprën e Athanas Tashkos, ndërmjet të tashmes së turbullt dhe kaotike, lexuesi priret të vlerësojë përkushtimin e njerëzve të shekujve më parë. Athanas Tashkoja njihet si themeluesi i organit të parë satirik të shtypit shqiptar, me botimin e numrit të parë të gazetës “Shkopi” në vitin 1907. Studiuesi Fatos Tarifa përmend dhe pseudonimin “Dora” që firmoste pjesën më të madhe të shkrimeve nga ana e autorit. Pra kemi të bëjmë me një kombinim të përmbajtjes së tekstit (satirik- ironik- akuzues) dhe nevojës së përdorimit të pseudonimit si një shkëputje dhe përlligjje vërtetësie nga ana e autorit. Cilat mund të jenë atëherë arsytet që fshihen pas zgjedhjes së këtij autori për të vazhduar aktivitetin publicistik nën hijen e anonimatit apo duke përdorur pseudonim letrar?

I gjithë ky proces i udhëhequr nga një zhvendosje e emrit dhe reales, përmes ushtrimit të pseudonimit apo lënies pa emër të artikujve, mundëson të ngremë disa pyetje që janë me interes edhe në raport me bashkëkohësinë e krijimit në ditët e sotme:

- Cilat janë kriteret që mund të përdoren për të përcaktuar autorësinë e artikujve anonimë?

- Liria nën pseudonim, mendimi satirik dhe kritika sarkastike a janë përherë aleatë të detyruar të njëri tjetrit?

- Deri në cilën pikë komuniteti i lexuesve të kohës identifikonte artikujt e paemërt me autorin real të tyre?

Në fakt, artikujt e Tashkos gjenden në dy pamje: të botuara në gazeta të ndryshme shqiptare kudo që ato nxirreshin nëpër diasporë, si dhe të pa botuara, këto të mbetura me shkrim dore. Mjaft prej këtyre të fundit janë të një forme fillestare të hedhjes së mendimeve ose janë shtjelluar deri në një farë pike dhe janë lënë përgjysmë ose edhe atëherë kur mendohet të kenë qenë të plota, do të jetë që të mungojë ndonjë faqe të Arkivit në fillim a në fund; me pak fjalë do t'i mungojë data e shkrimit

Kujtesa dhe pasqyra e identiteteve. Pseudonimi letrar

Ne jemi kujtesa e përbashkët,

Ne jemi ky muze ajri, formash të paqëndruara,

Ky grumbull pasqyrash të thyera⁴.

Jorge Luis Borges

Nën blloku i tretë i publicistikës, gazeta “Shkopi”, ka vlerën e kontributit sa personal të Tashkos aq dhe misionar të tij:

“Anonimiteti ishte tipar i natyrshëm i Tashkos, i cili më tepër se ku u shfaq në këtë gazetë. Artikujt pa emër, anonimë, të “Shkopit”, ishin të tij dhe siç shkruan Vruhoja “sa shkrime me shënim Dora patën qënur mendimet e tij; të katër numurat e Shkopit do të pasqyrojnë veprat e atdhetarit të math i cili, kurrë nuk mendohej për punët vehtiake, aqe sa mendohej për atë të përbashkëtat” (në “Ish-Botonjësi i Shkopit Thanas Tashko nuk gjendet më”, nga Jani Vruho, “Dielli”, 29 Vjesht’ e III 1915) (Koço, 2015:76).

Bashkëkohësit e Tashkos, lexuesit që mund të shfletojnë gazetën e tij, por edhe ata që mund të gjejnë shpalosjen e mendimit të këtij autori në organe të ndryshme shtypi, e njohin dhe nuk e kanë të vështirë të dallojnë dhe përcaktojnë kush fshihet pas pseudonimit, apo cila është firma e munguar në artikujt e lënë anonimë. Është një procedurë kjo, që ngjason me një lloj rituali të përdorur dhe të interpretuar nga shumë autorë të tjerë të kësaj periudhe; a kemi të drejtë ta quajmë këtë prirje si një proces ku ndodh shpëputja e krijuesit apo mendimit krijues, nga kritiku apo mendimi kritik, për të nxjerrë në pah një paanshmëri objektive në dhënien e gjykimeve dhe vlerësimeve të ndryshme?

Filtri i gjykimit, bashkë me seleksionimin është i gjatë e i vështirë duke i njohur autorit edhe një tipar modestie që shfaqet me shkëmbimet epistolare si dhe aktet e bamirësisë që i ushtron pa tërhequr mbi vete vëmendjen e zhurmshme të botës. Por nëse një nga cilësitë e njeriut lidhet me tentativën e tij për të lënë gjurmë në histori, përdorimi i pseudonimit apo anonimati e sfumojnë mundësinë për t’i bërë ballë harresës.

Kjo, me përjashtim të rastit, kur krijuesi identifikohet me krijimin e tij, me idetë, me synimin madhor, që në rastin e Tashkos ishte patriotizmi dhe besimi tek çështja kombëtare dhe identiteti i kombit shqiptar. Nën këtë prizëm, edhe publicistika

⁴ Shkëputur nga intervista me Giovanni Gagga, mbi fillin e kujtesës, burimi: <http://www.artapartoculture.net/2015/08/08/intervista-a-giovanni-gaggia-sul-filo-della-memoria/>

e autorit mund të cilësohet si një mundësi e çmuar që ruan më së miri eksperiencat dhe njohjet e së shkuarës, duke interpretuar të tashmen historike të kohës kur janë bërë shkrimet, me orientim nga e ardhmja bashkëkohëse e sotme.

Mund të kuptojmë atëherë, që ky lloj afrimi i ditëve tona, me format dhe dokumentet e rralla të së shkuarës, nënkupton domosdoshmërisht ripërtëritjen e saj, kërkimin për ridaljen në dritë, të së mirës dhe fisnikes, me misionin e rivlerësimit dhe vendosjes në qendër të vëmendjes, të figurave që kanë lënë shenjë vite pas, në kohë.

Siç përforcohet në faqen 6 të No. 3 të “Shkopit” (1908) “*të gjithë ato artikulla që janë pa nënshkrim janë të direktorit të ‘Shkopit’, zotit ‘Dora’, të tjerat janë të bashkëpunëtorëve të ‘Shkopit’*” (Koço, 2015:76).

Anonimiteti i Tashkos, shprehet studiuesi Eno Koço, nuk ishte kamuflim, e kundërta, ai nuk donte të bënte protagonistin, misioni kryhej edhe më mirë, sipas tij, pa u shfaqur e pa u ngrehur. Ai ndjehej i bindur për ato që shkruante, jo vetëm në gazetën e tij, por edhe në të tjera gazeta ku ai do të nënshkruante si A. T. Korçari”.

Shkrimi i parë i Tashkos në gazetën “shkopi” nënshkruhet me pseudonimin “Dora” dhe është një akuzë therrëse, në formën e pyetje-përgjigjeve, ndaj atyre shqiptarëve që vazhdonin të tjetërsonin identitetin e tyre, duke fshehur origjinën e duke u ekspozuar në gjuhë të huaja, si për të ndryshuar të pamundurën, ADN-në dhe gjakun e origjinës nga vinin:

VALLË PSE?

Shumë Shqipëtarë dinë mirë të shkruajnë e të lëçitin shqip, po radhonj’t e tregtisë (defteret) i mbajnë në gjuhë të huajë, vallë pse?– Pse ende s’u ka plasur mirë cipa e erësirësë.

* * * * *

Shumë Shqiptarë kanë turp përpara Grekut të thonë që janë Shqiptarë, vallë pse?

– Pse janë njerës të poshtër e të tjerë veshgjatë, janë nga atá që lëpijnë çanakët’.

Në dhe të huaj, 1905 (Po aty:78).

Dora

Nëse do ndaleshim vetëm te kjo pjesë, do mund ta quanin një lloj paradoksi këtë thirrje të autorit: ai iu bën thirrje njerëzve të mos ngurojnë të shfaqen për ata që janë realisht, por ndërkohë nuk firmos me emrin e tij, por zgjedh një pseudonim. Realisht, nuk mund të jetë kështu, pasi identiteti i Tashkos krijues përkon me identitetin e Tashkos njeri të përfshirë në çështjen kombëtare.

Firma që ai krijon ka një jetë paralele me jetën e autorit, është zëri individual i tij, por edhe shumë zëra të tjerë patriotësh e njerëzish të thjeshtë që e mendojnë njëlloj si ai. Pseudonimi, por edhe anonimat i nënien pa firmë të një pjesë të artikujve, është identifikim me pjesën e mirë të shoqërisë së atëhershme shqiptare, identifikim me njerëz të palëkundur, që nuk ngurrojnë t'u vënë prapësive emrin që kanë dhe sulmojnë pa ndërmjetësi errësirën dhe jetët e lëna nën errësirë që iu kundërviheshin interesit dhe çështjes kombëtare.

Universi i emrave dhe paralelja e ironisë

“Nëse nuk ia dalim të njohim punën e bërë në të djeshmen, bota jonë do të mbetet përherë në verbërinë e padijes”(C. Moreschini, P. Parroni, 2012), - kumton Ciceroni mbi rolin e kujtesës dhe ripërtëritjes së identitetit të romakëve antikë. Të mos dish çfarë ka ndodhur në kohët e shkuara, është sikur të mbetesh përherë një fëmijë.

Nën këtë shtysë, çdo vepër që na sjell sinjale nga e kaluara e kombit, duhet të cilësohet për vlerat dhe përmbajtjen e saj, për rëndësinë përcaktuese të kujtesës dhe të nevojës për të plotësuar çdo hapësirë të zbrazët të kulturës shqiptare. Vendosmëria për të rimëkëmbur të shkuarën lidhet ngushtë me mundësinë e rinovimit të së nesërme, ndaj kontributi i njerëzve të djeshëm e pasuron jetën e na ofron mundësinë të bëjmë krahasime të çmuara.

Brenda këtij konteksti, Monografia dedikuar Athanas Tashkos është një vepër e gjerë, e plotësuar me materiale që shkojnë nga shkrimet zyrtare deri te shënimet e pabotuara, letrat apo sprovat e papërfunduara. Publikimi i kësaj vepre përkon me një vit jubile, sikundër shprehet autori i monografisë:

“Në këto 100 vjet që nga vdekja e Tashkos (1915) herë pas here është shkruar ndonjë gjë për të, por gjithnjë në kuadër të referencave apo të ndonjë mirënjohjeje. Kështu, në gazeta, revista e libra, Tashkoja është cituar pothuajse gjithmonë si një mbështetës moral i patriotëve, veçanërisht i Nolit, si drejtor i gazetës “Shkopi” (ndonëse edhe për këtë fakt është vënë në diskutim), si një filantrop që ndihmonte shoqëritë e shkollat shqipe të Korçës dhe më pak si një njeri që gjatë jetës së tij mori vendime të rëndësishme në shërbim të çështjes shqiptare, për të kryer atë mision që e lypte atdhetaria e orës së parë, për të ndihmuar kryengritësit në jug e veri ku ndodheshin shqiptarë, momente si këto e të tjera që mbetën pika orientimi dhe ngjarje të veçanta në historinë e rilindjes shqiptare që vepronte në Egjipt (Koço, 2015: xvii).

Kemi universin e emrave përkatës dhe një tjetër univers paralel, të dendur e të mbingarkuar me pseudonime apo reticensë firme. Vetë procesi i shkrimit mundohet

apo lehtësohet nga ky lloj kombinimi paralel. Tashko në gazetën “Shkopi” replikon, analizon, ngre çështje dhe ndalet në tema të rëndësishme të kohës. Shkrimet janë të mbujtura me ironinë dhe nxjerrjen në pah të dobësive të natyrës shqiptare, sikundër në rastin e atyre që shkonin të luftonin, por nuk e dinin nën shërbim të kujt ishin:

“Sa m’u droth zemëra njëditëzaj kur pashë n’ Aleksandri ca zabitë Shqipëtarë që po vinin në Jemen të luftojnë.

– Ku vini, o!? U thashë.

– Vemë në Jemen të luftojmë, më thanë.

– Për kë, o! Për Baba Dovletnë?

Jo mor kush . . . tani Baba Dovletnë . . .

– E po për kë, o!?

– Për kombin tonë, o!

– Për kombin Shqipëtar, ore!?

Firmosur nga “Dora”, ky artikull shpreh një shqetësim koral të asaj kohe. Pamundësinë e shqiptarëve për të pasur një vezullim të qartë të origjinës dhe ideale ku duhej të frymëzoheshin. Pseudonimi i jep mundësi autorit të shkruajë, duke u identifikuar me atë lëvizje patriotike, me atë rrymë mendimi që përpiquej të shumëzohej dhe të kapte sa më shumë shpirtra të lëkundur shqiptare.

Përmes tij, autori shumëzon vetveten, me qëllim që të shumojë idetë e tij në njerëzit që lexojnë shkrimin. Ky lloj interpretimi na mundëson afrimin e misionit të krijuesit, me botën e ideve që e frymëzon të shkojë përpara. Nëpërmjet pseudonimeve të tij, Tashkoja i jep jetë një ideje që e tejkalon jetën e një njeriu të vetëm, bëhet pjese e një koraliteti që nxjerr në pah vlerat dhe misionin e çdo shqiptari që e do kombin e vet.

Përfundime

Kohët “moderne” dhe moderniteti ku lëvizim akoma sot, karakterizohen nga një numër i madh botimesh, revistash, gazetash, përmbledhjesh kritike dhe shkencore, e njëherësh numri i lexuesve potencialë dhe realë është shumë herë më i madh sesa ishte njëqind vjet më parë. Rrjetet sociale i lejojnë kujtdo të shprehë opinionin pas emrit real apo të rremë, ka një vrap të pandalshëm në përdorimin e shumimeve të identitetit, apo pas një anonimatit që pranohet dhe përkrahet gjerësisht nga të gjithë. Krahasimi me fillim shekullin e kaluar nxjerr në pah një distancë të madhe, duke nisur nga mundësia e identifikimit të krijuesit që përdorte pseudonim, apo nuk i firmoste

shkrimet e tij. Nëse lexuesit ishin të paktë në numër, po të rrallë ishin edhe krijuesit e përfshirë në procesin e rimëkëmbjes të kulturës dhe identitetit kombëtar.

Athanas Tashkoja, na nxit mundësi interpretuese dhe rivlerësuese në këtë kontekst. Në tërësinë e punës së tij, ne ndeshim këtë veçori, që e bashkon me publicistikën evropiane, të kohës; anonimatin apo përdorimin e pseudonimit për të nënshkruar artikujt përkatës.

Këtu mund të kapim vështirësinë për të rivlerësuar si duhet të kaluarën tonë. E tashmja që duhet të fshijë çdo gjë prej së djeshmes është sindroma e tranzicionit që ende vonon të mbarojë gjatë këtyre 25 viteve, prandaj monografia mbi Tashkon mund të cilësohet si nxitje e rëndësishme për të bërë një përballje me të kaluarën e kombit, të njerëzve që shkrinë pasionin dhe intimen, kulturën dhe dashamirësinë, kundrejt idesë së identitetit dhe vlerës së kombëtares.

Po atëherë ku qëndron rëndësia e veprës mbi një autor që krahasuar me të barabartët e kohës së tij, pat zënë pak vend në analet e historisë, studimit të publicistikës dhe letërsisë shqipe?

Mund të sugjerojmë një alternativë përgjigjeje, nën shembullin e shkrimtarit Bernard Shaw, të cilën e pyetën dikur nëse besonte që Biblën e kishte shkruar Shpirti i Shenjtë. Dhe ai u përgjigj kështu:

“Çdo krijim që ia vlen ta rilexosh, është shkruar nga Shpirti. Ta themi disi më ndryshe. Një krijim duhet të shkojë përtej qëllimeve të autorit. Qëllimi i autorit është një gjë e varfër, njerëzore që mund të dështojë, kurse krijimi është më shumë.”

Nën këtë nxitje, duke marrë në shqyrtim materialet publicistike të përmbledhura në monografinë mbi Tashkon, mund të themi që krijimtaria e këtij autori e nxjerr atë nga Anonimati dhe pseudonimet e përdorura, duke i dhënë një fizionomi të dallueshme stilit dhe frymës kritike, pa lënë pas dore edhe profilin njerëzor që e nxit të orientojë krijimtarinë e tij në këtë drejtim.

Bibliografi

“*Dielli*”, Boston, 22 maj 1909, No. 9, f. 9; dalë 1909–1915(Biblioteka Kombëtare).

“*Drita*”, Sofje 1905-1906; *Vjersha e Tashkos* 15 maj 1906,(Biblioteka Kombëtare).

“*Kombi*”, Boston, “*Letër nga Misiri*” – dërguar Sotir Pecit, 11 gusht 1906, No. 8, f. 1, 2 (Biblioteka Kombëtare).

Antonio, Tabucchi, *Un baule pien di gente. Scritti su Fernando Pessoa*, Collana universal eonica Feltrinelli, 2001.

C. Moreschini, P. Parroni (a cura di), *Pensiero e poesia. Antologia da Cicerone, Lucrezio, Catullo, Orazio. Per le Scuole superiori*, Libreria Universitaria, Roma, 2012

Eno Koço, *Athanas Tashko, (1863-1915)*, Botime Flesh, Tiranë, 2015

Floresha Dado, A. Z. Çajupi—1983, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Nasho Jorgaqi, “*Letërkëmbimi i Fan Nolit*”, Botimet “Erik”, 2013

Nasho Jorgaqi, “*Jeta e Fan S. Nolit: (në dy volume)*, vol. 1—2005, Ombra GVG

Qemal Haxhihasani (përgatiti), *Thimi Mitko—Vepra*—1981, Akademia e Shkencave.

Dr. ILIR SHYTA

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

THANAS TASHKO DHE EPISTOLARI FAMILJAR

Letrat e njerëzve të shquar, shpesh përmbledhen në vëllime të veçanta, të quajtura epistolarë. Epistolarët na japin mundësi të njohim njerëzit e mëdhenj në intimitet, na bëjnë si të thuash, ta rijetojmë jetën e tyre. Në të njëjtën kohë na japin njoftime të drejtpërdrejta në lidhje me epokën historike, gjendjen shoqërore, zakonat dhe traditat e kohës (AShSh, 1972:59-60).

Nisur nga këto përkufizime, qartësisht letërkëmbimi nuk ka pikë takimi me ligjërimin letrar, pra, epistolari mbetet jashtë formave të letrares.

Në *Fjalorin e shqipes së sotme* nuk është përfshirë termi i huaj epistolar, i cili vjen nga greqishtja, por gjegjësit e tij në shqip, korrespondencë dhe letërkëmbim (FShS, 2002:605-606).

Në shumëllojshmërinë e zhanreve letrare, letërkëmbimi shfaqet më së shpeshti si një zonë e ndërmjetme apo midisëse. Nga njëra anë, letërkëmbimi është një zhanër i mirëfilltë letrar, si një lloj hapësire letrare vetërrëfimi, porse, nga ana tjetër, falë natyrës dhe tipareve tejet të veçanta që ky zhanër ka, letërkëmbimi del jashtë sferës së letrares, duke u shfaqur jo vetëm si më i tkururi, por edhe si më i tjetërsuari, ndër tërë zhanret letrare. Letërkëmbimi bart vlerë të paçmuar, pasi mund të shërbejë fare mirë si pjesë e poetikës krijuese të autorit. Letërkëmbimi shërben jo vetëm si pjesë e zbërthimit të krijimtarisë së një autori, por edhe si çelës për të zbërthyer dhe për të kuptuar krijimtarinë e tij.

“Epistolari shkruhet në vetën e dytë dhe merr parasysh personalitetin e të adresuarit dhe jo lexuesin e papërcaktuar anonim, që do ta lexojë atë kur të publikohet.” (Çausi, 2005: 115).

Në vitin 200, në biografinë e tij mbi Nolin, studiuesi Nasho Jorgaçi e përshkruan kështu Thanas Tashkon: *“burrë me sy depërtues e flokë të shtruar, me mustaqe të hijshme, që mbante herë pas here papion dhe kapele republike, por që kish mbetur rrënjë prej Frashëri të Dangëllisë dhe kish hedhur farën e shqiptarizmit në Fajum... Askush sa ai nuk i kish ngjallur deri atëherë aq besim e shpresa”* (Jorgaçi, 2002: 124-125). Te Thanas Tashkoja mbizotëronte gjykimi e urtësia, këshillat dhe forca e arsyetimit. Njeriu me mendje esëll, praktik dhe mbi të gjitha prindi dhe shoku

i fëmijëve.

Epistolari familjar nën qasjen e kumtesës sonë përmban 11 letra të Thanas Tashkos me familjarët dhe anasjelltas (vitet 1910-1928), si edhe një numër tjetër prej 12 të tillash të Anastasit, (1933-1954) që vetëm sa përmenden në botimin e Eno Koços si më poshtë vijon:

Paris, 3 qershor 1933 (Anastasi drejtuar Gaqos);

11 mars 1934 (Anastasi drejtuar Alekos);

24 maj 1936 (Anastasi drejtuar të ëmës dhe Alekos);

Kartolinë nga Bostoni 1936 (Anastasi drejtuar të ëmës);

Evanston, Illinois, 26 mars 1939 (letër e Elsa Tashkos drejtuar të shoqit, Anastasit/Arturit); Marseille, 22 qershor 1942 (Anastasi drejtuar Gaqos dhe Koços);

Bari, 3 gusht 1944 (Anastasi dërguar Koços, Gaqos dhe Lekos);

Bari, 20 Nov. 1944 (Anastasi: Dear Brothers);

Bari, 18 prill 1945 (Anastasi dërguar Koços);

Brookline, Massachusetts, 17 July 1946 (Elsa Tashko drejtuar Koços, 20 faqe);

Marseille, 9 Shtator 1949 (Anastasi drejtuar Koços, 8 faqe); 21 tetor 1949 (Anastasi drejtuar Koços);

12 janar 1954 (Anastasi drejtuar Koços dhe Gaqos). (Koço, 2015: 510).

Këto letra janë më së shumti shfaqje e lidhjeve të tij njerëzore, janë komunikim shpirtëror mes njerëzish, siç thotë edhe vetë Lansoni, se bota nuk njih tjetër kënaqësi komunikimi, veç asaj që të shkruajë. Epistolarin e Tashkos e shenjojnë edhe letrat e njerëzve të tij në jetën e zakonshme. Përmes tyre fiksohet bota njerëzore e zbrëthyer në plane të ndryshme jetësore, zbrëthet personaliteti i shkruarit.

Përmes këtij epistolari jepen veçoritë e karakterit dhe të shpirtit, parimet, besimi dhe bindjet që ushqenin kredon e tij “*Atdhetarja ime nuk’ është për reklamë, për qejf, a për interes, është detyrë njeriu me ndjenja të njerëzinjtë*”(Po aty,441).

Natyrisht një vëmendje zë në epistolar edhe qyteti i Korçës. Letrat janë të mbushura plot mall dhe nostalgji për Korçën, për shoqërinë, për familjen. Çdo verë familja Tashko shkonte në Korçë për të qëndruar tek familja e së shoqes, Zografëve. Çdonjëri prej fëmijëve i lindur në Fajum do ta sillnin edhe në Korçë. Në një letër që i dërgon nga Korça, e ëma, të birit, Athanasit, më 6 mars 1911, tregon se Tefta ishte larguar nga Misiri dhe ndodhej në Korçë kur ende ishte tre muajshe. Letra në dorëshkrim është e përkthyer nga greqishtja. “*Fëmijët tuaj, Caci, Katina, Gaqoja,*

Lekoja dhe Tefta ju puthin të djathtën dhe janë mirë deri tani, shëndeti s'u ka pësuar asgjë. Po ashtu, edhe zonja tënde, Eleni, të përqafton ngrohtësisht dhe është mirë. Motrat e tua, Zoica dhe Parashqevi të përqaftojnë” (AQSH, F 9, D. 15, : 4)

Ky letërkëmbim familjar shpirtëzohet edhe nga fotografitë e kohës, të cilat i kanë të fiksuara këto momente familjare. *“Fotografinë e mora e u gëzova shumë, Tefta është madhuar dhe zbukuruar, po më vjen keq, siç thua ti Leko, që është bërë korçarkë fare. Keti xhani është zbukuruar. Po Kristua është madhuar shumë. Duket që shkoni kohën mirë me të J. Mitkos”* (Koço, 2015:509).

Përmes këtij epistolari familjar zërthehet qenia njerëzore mes humanizmit, altruizmit, dashurisë, intimitetit, urtësisë, taktit, vendosmërisë, ngushëllimit, tolerancës, kritikës, sqimës dhe vlerës intelektuale. Këto letra janë të mbushura me të vërteta të natyrës njerëzore, mbi të gjitha janë të qarta dhe janë më së shumti të stilit bisedor. Te njëra shtrohet mendimi dhe te tjetra jepet përgjigjja, herë e rëndësisë utilitare dhe herë si një vrojtim gjakftohtë i ngjarjes apo situatës rrethore të shkruar.

Në stilin e shkrimit të këtyre letrave pozicionohet vetë stili i autorit të rrathëve të tyre, të cilin do ta përkufizoja si të saktë dhe të rrjedhshëm dhe mbi të gjitha me sens mase, i cili përcjell emocion sinqeriteti. Letrat bëhen edhe më interesante nga fakti se kujt i adresohen ato, sikurse janë pjesë e tyre nëna, vëllai apo fëmijët.

Fatin altruist të Thanas Tashkos do ta përafroja me atë të xha Gorioit të Balzakut, por më një ndryshim të madh. Të dy shtrydhen si kokërr limoni për të hollat e tyre, por i pari nuk hidhet në rrugë sikurse i dyti. Mirënjohja mbetet e madhe për këtë gjest të madh human që nga Fan Noli dhe deri tek familjarët apo të afërmit, të cilët prekin altruizmin e tij njerëzor në vlera monetare. Mesa duket në familjen e Athanas Tashkos edhe djemtë ndihmojnë nga pak me të ardhura, ndërsa trau kryesor i saj mbetet vetë kryefamiljari.

“Mora letrën t’uaj të fundit e shkrojtur më 23 korrik 1925 dhe ku më thoni për marrjen të \$40 që ju dërgova për muajin Korrik. Tani besoj të kini marrë dhe të muajit Gusht, \$45.00. Më vjen shumë keq t’ju gjej të pa kënaqur. Gjer sa t’ju dërgoj këto të 45.00, lipset të bëj theror shumë gjëra.” (ANASTAS TASHKO, 1925) (Po aty: 508).

Sigurisht, këto janë disa nga mendimet kryesore të letrave që Tashkoja merr dhe dërgon në rrethin familjar. Ato ngrenë dhe shtrojnë probleme të rëndësishme në aspektin njerëzor. Një pjesë e tyre kanë edhe karakter utilitar, përveç kundrimit estetik të shkrimit. Prej tyre burojnë një sërë rregullash të shkruara dhe të pashkruara në

ligjësitë e jetës. Ndërkaq, këshillat vijnë edhe nga të afërm për Thanas Tashkon. Petro Tashko, vëllai i tij, vijon të jetë stoik në porosi. *“Si nga ana hime një kumandar duet të ketë katër sy, katër duar, shtatë shpirtë që në ju mbushtë shpirt’ i parë, vrer e farmaq, të mos nxitoet ta zbrazë po ta lerë të ftoet pa nevojë, edhe të ketë katër ... po jo, dy këmbë të shkurta (mos themi katër se mos’ e zësh për bagëti) edhe sa më tepër ti lëvizë këto, aq m’i fituar dot’ jetë, pra si për neve që kemi dalë kurbetit, mua mu mbush koka që sa më tepër të lodhet njeriu aq mi çlodhur është, dhe që puna se vret njerinë, po janë të tjera ato që e vrasin, pra sa për mua o vëlla të mos them që jam i math, as që i vogël po tridhjetë vjet jam, edhe pas naturës që thonë ca të kënduar, më mbeten katër vjet për të përparuar d.m.th. për të zënë brumë për pleqëri se ndryshe ... s’ jam për roitje edhe mbetem me nder i dashur...”* (Po aty: 502).

Madje një pjesë letrash, si ato të Ilia Pines, e mbajnë (kunatin e letërshkruesit) në informacion me ngjarjet e rëndësishme historike që ndodhin në Korçë më 7 maj të vitit 1914.

“Shyqyr gjer më këtë ditë s’kemi pësuar gjësendi si do që ngjanë këtej shumë trazime, po shpëtoj edhe Korça me fshatrat. Të fala shumë pe nuses time, dhe fëmijës teme, zotëris sate, zonjës tënde dhe djemët. Mëso në trazirën e Korçës përpara një muaj e gjysmë këtu në Korçë u vranë në dyfek e sipër që mbajti 5 dit shumë njerës, midis këtyre u vra Llukaj, i dhëndri i xhaxhajt, Kostës.” (Po aty: 503).

Duhet thënë së letrat e botuara nën kujdesin e Eno Koços nuk mbartin kronologjinë e rregullt të viteve. Theksohen vetëm ato që ai i shikon të arsyeshme për botimin e tij. Gjithsesi brenda tyre gëlon jeta me mund, përpjekje dhe sakrifica njerëzore që rrjedhin nga një familje dhe fis atdhetarësh, një familje që mbetet në lartësinë e misionit të saj (etër-fëmijë). Lidhja si vëllezër gjaku dhe me gjerë mes tyre dhe fëmijëve, mbeten raporte që pasqyrohen në këtë epistolar. Këtë e fakton letra e Anastas Tashkos nga Korneburgu me 10 korrik, më 1922, drëguar mamasë së tij.

“Ti mama xhani mos pandeh se të haruam, unë gjithë një ju kujtoj dhe ju shëkoj në hëndër, po nuku dhe mentoj shumë se pastaj më vjen keq. Mua më ka zënë malli shumë për ty mama xhani se neve kemi shkuar shumë kohë bashkë, kemi parë të mira dhe jo të mira, si është e mundur që të të haroj. Pastaj Katushën time xhani gjithë një e kujtoj. Shkaku se nuku ju kam shkrojtur dendur është se jemi bërë ca dembelë, unë e lë në Gaqua dhe ay te mua, po që tani e tutje do t’ju shkruajmë gjithënjë nga dy herë në javë kini postolka.” (Po aty: 507).

Letrat në familjen Tashko, dërguar mes tyre sipas rasteve, mbeten dokumente

që flasin jo vetëm për marrëdhëniet e mira mes familjarëve, por provojnë edhe njëherë tjetër vijën e drejtë të truallit ku ata ishin rritur, formuar dhe vijonin ta tejçonin si një vlerë të shtuar morale. Ndikimi i shëndoshë që pati krijuar kjo familje jo vetëm brenda rrethit të saj, shpjegohet nga idetë e shëndosha që burojnë nga ky epistolar familjar, mbi të gjitha nga dashuria dhe respekti për njëri-tjetrin.

Ndërkaq letrat në këtë korrespondencë nisin me formën e politesës (duke të kujtuar formën klasike të komunikimit) *i dashur...*, *shumë e dashur...*, *të dashur* dhe përfundojnë me *të falem me shëndet...*, *u falem me mall të gjithëve...*, *ju uth me mall të madh...*, *të uth dorën me mall...*; Këto letra me këtë formë të shkruari të përfocojnë edhe njëherë bindjen se ato u drejtohen njerëzve të dashur, pasi personave të tjerë të largët apo titullarëve të ndryshëm u drejtohem *në forma të tjera të shumës të respektit*(Shkurtaç, 2008:184)

Bibliografi:

AQSH, F 9, D. 15, fl. 4

Eno Koço. *Athanas Tashko (1863-1915)*. Botimet Flesh, Tiranë, 2015

Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, Tiranë, 1972, f. 59-60

Fjalor shqipës së sotme, Tiranë, Toena, 2002, fq. 605-666

Gjovalin Shkurtaç. *Si të shkruajmë shqip*. Botimet Toena, Tiranë, 2008, fq. 184

Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbim i Fan Nolit*. Shtëpia botuese Erik, Tiranë, 2012..

T. Çausi, *Fjalori i Estetikës*, Shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2005, f. 115

Prof.as. dr. IRENA NIKAJ
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

**ATHANAS TASHKO-FRASHËRLIU ENTUZIAST. RILINDASI QË ME MENDJE
DHE SHPIRT PUNOI PËR SHQIPËRINË PERËNDIMORE EVROPIANE**

Në këtë 100 vjetor të ndarjes nga jeta të Athanas Tashkos, do të ishte me vend të flisnim disa fjalë edhe për vizionin e Athanasit në lidhje me Shqipërinë dhe rrugën evropiane të ecjes së saj, një ecje e vështirë, ashtu si nuk ka qënë ndonjëherë rrugëtimi i Shqipërisë nëpër kohë, përkundrazi, shumë i vështirë. Mundimet e shqiptarëve ngjajnë me ato të Sizifit, apo ndërtuesve të Kalasë së Rozafës, që u shembej gjithmonë natën puna e bërë gjatë ditës.

Veprimtaria e rilindasve frymën e qenies e krijon jashtë Shqipërisë, për shkak të rrethanave tejet të vështira që ekzistonin në të dhe e vazhdon në Shqipëri si veprimtari e drejtpërdrejtë praktike, në përhapjen e shkrimit, kulturës, kultit të heronjve shqiptarë, për t'i dhënë ngjizjen kombit dhe ndjenjës kombëtare.

Në publicistikë dhe në letërkëmbime dëshmohet se pa shumë zhurmë, por përmes sarkazmës dhe satirës Athanas Tashkoja ka punuar me sistematicitetin dhe këmbënguljen e milingonës për të ndërtuar vazhdimësinë e lëvizjes atdhetare në të mirë të Shqipërisë, të ndihmonte përhapjen e gjuhës shqipe, të ndihmonte atdhetarët që kishin talent, por nuk kishin para për t'i çuar deri në zgjidhje përpjekjet për të pavarësuar Shqipërinë e kështu me radhë.

Lëvizja rilindase ishte e ndarë në shumë qendra të diasporës ku ishin ngulur shqiptarë, ndaj ndoshta ende dhe sot ne nuk kemi mundur të bëjmë një histori përmbledhëse të lëvizjes që çoi në shpalljen e pavarësisë dhe, në këtë kuadër, kontributi i kësaj konference dhe i librit të botuar nga z. Eno Koço, sipas mendimit tonë, është një ndihmesë me shumë vlerë për të ndriçuar ngjarje me shumë peshë në historinë e Shqipërisë. Mbase dhe më tej, për shkak të mundësive të kufizuara që kanë institucionet, nisma të tilla shfaqen historike për të plotësuar muzeun e mendimit rilindas që solli pavarësinë, duke ndihmuar që tabloja e saj [pavarësisë], të jetë e provuar përmes dokumentacionit dhe provave gjithmonë e më shumë si fryt i përpjekjeve rilindase, madhështore, të përkushtuara deri në sakrificën ekstreme e të mos e vlerësojmë si vendimtare diplomacinë apo kombinacionet/intriga që vinin nga Evropa apo fqinjët.

Noli, te “50 vjetori i Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë (1960)”, na dëshmon se “Në Fajum, ai [Noli], pati rastin të takojë dy pionierë entuziastë të lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Thanas Tashkon dhe Jani Vruhon, që të dy pronarë restorantesh. Të gjitha të hollat që mundën të kursejnë ata i shpenzuan për çështjen shqiptare. Ata botuan për tre vjet, nga 1906 në 1909, gazetën e quajtur ‘Shkopi’, në të cilën mbrojnë çështjen e pavarësisë shqiptare dhe që e shpërndanin pa të holla”.

Vetë Tashkoja shkruan : *Më gjithë këto zëmra imë më thotë shprëso o i varfër, dhé për shëmbëll më rrëfën, se këta Shqipëtarë që sot marrin të gjithë nga dy é nga tri gazeta të Grekut a të xhon Turqve, dhé i paguajnë më léhtësi të madhe, do të marrën dhe gazetat e mëmës së tyré é t’ i paguajnë më atë léhtësi, dhé kështu pra do të shtohénë gazetat Shqip e do të përhapét gjuha é kombit ténë, do të sqohen Shqipëtarët, do ndérohén, do mos quhén égërsira, é do rrojnë në botë si njërés të vërtétë.*

Një pjesë nga letra drejtuar S. Koleas shfaqet shumë domethënëse për të treguar dhe gjykimin dhe praktikitetin atdhetar të rilindasit frashërlli: *Unë të lutem edhe një erë të mentohesh mirë dhe mos pandesh se çdo shërbim, është shërbim; jo dhe kur i nxjer sytë të thuash se e shërbeve mëmëdhenë! Istorja do të gjykonjë dhe ap sytë.*

Kombi është një qenie që tashmë frymon nga përjetësia. Natyrisht, për të punuar edhe këta atdhetarë të përkushtuar, por na duhet ende punë sepse, sipas Nolit, ende nuk ia kemi dalë që të ngremë statujën e hijshme të egoizmit të përgjithshëm të kombit.

Prof. as. dr. JONELA SPAHO
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

ATHANAS TASHKO DHE GAZETA “SHKOPI”

Shoqëria shqiptare e Misirit të befason me aktivitetin e saj, me idealizmin, me përkushtimin për çështjen e lirisë, të mahnit me plejadën e atdhetarëve, publicistëve, shkrimtarëve, folkloristëve, që do të shkëlqenin në lëvrimin e gjuhës shqipe, në përkushtimin ndaj çështjes kombëtare, mbledhjen e trashëgimisë popullore, etj. Por jo vetëm kaq, siç pohon dhe studiuesi Stilian Adhami, në fund të shekullit XIX dhe në dekadën e parë të shekullit XX, Misiri u bë qendra e shtypit shqiptar si nga numri i gazetave, ashtu dhe nga përhapja e tyre; si gazeta “Besa- Besë”, e M. Duçit, gazeta “Toska” nga Vruho e Duçi, “Besa”, “Shqipëria”, “Pellazgu” etj. Gazetat dhe revistat të cilat u botuan në Egjipt, në gjysmën e parë të shek. XX, ishin sa të larmishme aq dhe të pasura në përmbajtjen e tyre. Titujt evokonin zërin e kushtrimit ndaj çështjes shqiptare, që ishte në procesin e gjetjes së zgjidhjes e të shtetformimit (Koço, 2015:12).

Një nga këto ishte dhe gazeta “Shkopi”, nën drejtimin e Athanas Tashkos, në bashkëpunim të ngushtë me kolegun e tij Jani Vruho. Athanas Tashkoja ka hyrë në historinë e jetës politike dhe kulturës shqiptare, veçanërisht me publicistikën e tij plot mendime të thella dhe të rëndësishme, në shërbim të kohës kur ai shkroi dhe botoi. Publicistika e tij është me gjerë, por ky organ prej të cilit kemi vetëm 4 numra ishte iniciativë e Athanasit, i cili jo vetëm kontribuoi me shkrimet e tij, e mbështeti vetë financiarisht dhe akoma më tepër e përhapi falas me shënimin:”Kush të dojë sa të sojë”. Sipas autorit të librit mbi jetën dhe veprën e tij, E.Koço, kjo gazetë ka vlerën e kontributit sa personal të Tashkos, aq edhe misionar të tij. Artikujt pa emër, anonimë të gazetës (sipas J.Vruhosh) ishin të tijat: ”Sa shkrime me shënim *Dora* patën qënur mendimet e tij. Të katër numrat e “Shkopit” do të pasqyrojnë veprat e atdhetarit të madh, i cili kurrë nuk mendohej për punët vetjake aqë sa mendohej për ato të përbashkëtat” (Koço, 2015:44).

Shkopi u botua në Kajro dhe u shtyp në shtypshkronjën “Mrodhësia” të Kristo Luarasis në Sofje. ”Shkopi” gjeti përhapje përveç Egjiptit dhe Evropës edhe në Amerikë e deri në Siberi.

Po ashtu në nr.3 të “Shkopit”, pohohet se: ”Të gjitha ato artikulla që janë pa

nënshkrim janë të direktorit të “Shkopit”, zotit Dora, të tjerët janë të bashkëpunëtorëve të “Shkopit”. Athanas Tashkoja i nënshkruante artikujt e tij me pseudonimin “Dora”. Sipas F.Tarifës, “Si titulli i gazetës, ashtu dhe pseudonimi i editorit të saj, kishin një kuptim alegorik domethënës;”Shkopi” nënkuptonte armën e kritikës e të ndëshkimit kundër armiqve të kombit shqiptar. “Dora” ishte ajo që mbante dhe drejtonte shkopin”(Drita, 1982:11). Kjo gazetë kishte idenë e të qëlluarit me shkop për të gjithë ata që nuk kontribuonin apo pengonin çështjen shqiptare, prandaj dhe në krye të gazetës, në numrin e parë të saj deklarohet:”Mpron të drejtat e kombit shqiptar. Lëvdon ata që janë për të lëvduar dhe qorton ata që janë për të qortuar në punëra kombësie, me mërira të veçanta nuk ngatërrohet. Direktor Dora e redaktor çdo njeri me mend e pa mëri të veçantë” (Shkopi,1907:1).

“Shkopi” e deklaroi që në fillim veten si gazetë satirike, duke hapur kështu siparin e së parës gazetë satirike shqiptare:”Gazetë shqip satirike, del kur të mundet në Kajro të Egjiptit shpërndahet pa të holla”(Po aty: 1). Duke lexuar këtë citim të habit vizioni i këtij njeriu për shkrimin publicistik e gazetarinë në përgjithësi, këtu e një shekull më parë. Sinqeritet i tejskalshëm por edhe gazetari e pastër, pa mllefe personale, shembull i një ndërgjegjeje të pakorruptuar, jo vetëm kombëtare, vetjake, por edhe profesionale. Një model për t’u marrë shembull edhe për gazetarinë, shpeshhere, plot mllefe personale të kohëve tona. I gjallë, dinamik, entuziast, njeri i veprimit, Athanas Tashkoja, siç ishte në jetën shoqërore, ashtu e transmetonte këtë vrull, energji dhe dinamizëm edhe në shkrimet e tij.

Nëpërmjet pseudonimit “Dora”, ai kërkonte që mendimet e tij të arrinin misionin. Ai nuk pëlqente anonimatën për kamuflim, por sepse çështjet që shtronte në artikujt e tij kërkonte t’i përhapte në masë të gjerë, jo vetëm si mendimet e një njeriu të vetëm, por të çdo patrioti dhe misionari të dedikuar për kauzën e kombit, duke u rekur t’i shndërronte ato në mendime kolektive. Akti i tij ishte ai i një idealizmi e përkushtimi të përkryer, përderisa sakrifikonte buxhetin e vet të emigrantit për botimin e gazetës, që sigurisht kishte kosto të lartë, por edhe rast i rrallë ky, në ato vite që gazeta shpërnduhej falas, madje mbulonte me shpenzimet e tij edhe dërgimin me postë. Pra, qëllimi i Tashkos ishte të mbillte farën e shqiptarisë ndër shqiptarë, pa marrë marasysh sa kostonte kjo. Ka disa dëshmi të tilla nga Noli, Sotir Kolea, lexues të tjerë emigrantë, që vërtetojnë këtë të fundit. Në një letër të një emigranti shqiptar në Amerikë shkruhet: “Mi gazetat e tjera që kam kënduar, jam habitur e që më ka ngritur leshrat e kokës, është gazeta juaj e nderçmjës “Shkopi”. U habita më tepër kur pashë

që e shpërndani pa të holla”(Koço,2015:107). Numri i parë i gazetës doli në vitin 10.3.1907 dhe vazhdoi deri më 1908, kur do të vijonin punën dy gazetatat satirike të Jani Vruhos; ”Rrufeja” dhe “Sëpata”.

“Shkopi” ishte një gazetë e karakterit satirik dhe satira ishte elementi kryesor i përshfaqjes së një mendimi të fortë fshikullues dhe shpeshherë i karakterit polemik. Nëpërmjet satirës kjo gazetë trajtonte kryesisht çështjet më të nxehta politike të kohës, që kishin të bënin me gjendjen e Shqipërisë së asaj kohe. Megjithëse doli vetëm në katër numra, kjo gazetë ishte nga më goditëset dhe më luftaraket e kohës, fshikulla e satirës dhe e sarkazmës të së cilës nuk linte pa prekur asnjë dukuri negative ndër Shqipëri e ndër shqiptarë. Në gazetën “Koha” të drejtuar nga Grameno në Xhejmston, me rastin e vdekjes së Tashkos shkruhej: ”Gazeta ”Shkopi” që përndaheste pa të holla ishte e Thanas Tashkos edhe shërbimet që ai solli janë pemët e sotme! Përpara Atdheut nuk njiheshin në Thanas Tashkoja hatëri e miqësia, ai dhe vëllanë e godiste rreptësisht po të ishte kundër atdheut!(Koha, 1915:1)

Sipas Eno Koços satira dhe sarkazma ishin tipare të vërteta të Tashkos, tipare këto që mëshirohen edhe në qenien e tij, por dhe që u transmentuan në gazetën e tij. Tipari kryesor që manifestohet në të gjitha shkrimet e kësaj gazete është atdhedashuria dhe, siç shprehet vetë Tashkoja, në një letër drejtuar S.Koleas te “Liri e Shqipërisë”: ”Atdhedashuria ime nuk është për reklamë, për qejf, a për interes, është detyrë njeriu me ndjenja të njerzinjta.”(Koço, 2015:44).

Që në krye shënohej që do të përdreshin për gazetën të dy gjuhët; shqip dhe greqisht, por artikujt greqisht erdhën gjithnjë dhe duke u tkurrur deri në numrin e fundit. Ndërkohë, me transparencën më të plotë, bën me dije se: ”Çkopi dalë nga dalë do të përbotojë emrat e gjithë mëmëdhetarëve të flaktë, po më tepër të atyre grekomanëve e të turkoshakëve të fëlliqur që të dijë e varfra Shqipëri me kë ka punë” (Shkopi, 1907:1). Dhe e mban fjalën. Në numrin e parë të gazetës, ai flet për vrasjen e Spiro Kosturit: “*Të dërguarin Spiro Jovan Kosturë na e vranë grekëtë me të pabesë se pse shpirtmadhi përpiqeshe për kombin shqiptar, d.mth grekët na vrasën po të punojmë për vathënë tonë. Të na vrasin shënjt papa Kriston, të na vrasënë dhe bandillë Spiron, që mezi e kishëm. Spiro, Spiro hap qiejtë dhe lësho rruftet përmbi krerët tona, po të mos marrëm hakën! As fare të mos të të vinjë keq, diqna si u dogje dhe ti o shpirt i bukur për ne! Diqna dhe përvëlona po të heshtimë! Ndjesë pastë shpirti yt o burrë shqiptar dhe ndjesë mos pastë shpirti i atij shqiptari që do të heshtnjë. Amin!*”.(Po aty: 1). Prej këtyre toneve panegjirike që shkojnë deri te

identifikimi i dëshmorit me një shenjtor që lëshon rrufetë nga qielli, del adhurimi i tij për ata që përpiqen për çështjen shqiptare, ashtu siç del dhe neveria për grekomanët të cilët nuk ua kursen sulmet e drejtpërdrejta: ”Më i madhi, më i ligu, më i poshtri shqiptar këtu në Misir është Vani i Godesë dhe ky qen ka pjesë në vrasjen bashkë me Vanin e Mongolecit të dhëndrin...” (Po aty: 3). Natyrisht, që duke i shpotitur njerëzit drejtpërdrejt, ishte e natyrshme që kjo gazetë t’i sillte Tashkos sa shumë miq, aq edhe armiq. Një nga këto raste shprehet dhe në një shkrim drejtuar gazetës “Shpresa”, që e sulmonte “Shkopin”, duke e quajtur botuesin e saj “Rrogëtarë pa rrogë”. Athanas Tashkoja, me mendimin e tij të drejtpërdrejtë dhe sulmonjës i përgjigjet: ”Shkopi me të vërtetë është rrogëtar pa rrogë, po jo vetëm i cave, po i gjithë kombit”.

Si në shkrimin për Spiro Kosturin e në shumë të tjera, por edhe në artikuj dhe letra të tij, duket se marrëdhëniet më të vështira shqiptarët e Misirit i kanë pasur me komunitetin progrek, të cilët nuk donin që Shqipëria të njihej si komb më vete dhe të lëvronte gjuhën e saj. ”Grekët na e vranë Spiron si njeri që përpiqueshe për gjuhën e vet të cilët grekët e kanë halë në sy dhe duan ta shuajnë nga faqja e dheut me çfarëdo mënyre”(Po aty: 1), ndërsa në artikullin “Shkopi ka dalë nga xheneti”, po të nr.1 të revistës thuhet: “Sa për grekomanët duhet një tjetër përorje, kundër këtyre të fëlliqurve ndyracakëve s’duhet bërë gjë tjetër veçse turpërimi, prandaj themi se “Shkopi” i ep lejë çdo atdhetari t’i përdorë këto të pakta porosi mbi fytyrat e çnderuara të spiunëve grekomanë”⁵, artikull ky nga Jani Vruho, i nënshkruar me pseudonimin “Qaf” e Sinjes”. Po e njëjta antipati është edhe për ata shqiptarë, idhtarë të Turqisë, të cilët janë një lloj me grekomanët. Në artikullin “Çështë Turqia?, Ç’janë shqipëtarët”, duke mos kursyer lumin e sharjeve për Turqinë dhe turqit, duke zbuluar të vërteta në mënyrë të drejtpërdrejtë, me një kurajo të pastër e vetëdije të kthjellët kombëtare, ai i quan turqit të pabesë, pa mëmëdhe dhe të pagdhendur. Me një paralelizëm ngjethës ai më pas vazhdon të shtjellojë idenë se ç’janë shqiptarët që i ndjekin ata. Satira vazhdon për të gjithë ata shqiptarë që shesin për interesat e të huajve veten dhe kombin. Sipas tij, ky është shkaku pse nuk bëhet Shqipëria: “Për besët e tyre shqiptarët nuk vriten. Vriten për kryetarët e besëve të tyre, porsa që pagahun mirë”(Po aty: 2) dhe sikur të mos mjaftonte ky rrebesh poshtërimesh mbi këtë soj tradhtarësh, jo rrallë, në të katër numrat e “Shkopit” gjejmë dhe vargje të karakterit të bejteve, që përforcojnë më shumë idetë e artikujve dhe rrisin ndjeshëm

⁵ Po aty, f.2

notat e satirës dhe sarkazmës që arrijnë deri në grotesk. Edhe pse vargjet nuk shquhen për nivel artistik, ideja dhe mesazhi përcillet qartë dhe është plotësisht brenda natyrës satirike të revistës: “O zagarë, o gomarë, / pse u bëtë për të vrrarë?, / Ata vetë grekët thonë, / na vjen turp prej njerëzisë, / që të quhemi Elinë”, / Këto punë do ti kishit kupëtuarë me hop, / me nder e jo me shkop”(Po aty: 2). Po me një vjershë satirike e përshëndet “Shkopin” dhe Mihal Gramenoja: “Të fëlliqur xhuxh majmunë, / na hëngri të gjithë...në, / U erdh “Shkopi” i Shqipërisë, / O kafshat e Perëndisë, / jetër herë mos pëllisni, / që me grekërit ju ngjisni”(Shkopi, 1907, Nr.2:2). Me sa duket puna, qëllimi dhe misioni i “Shkopit” ishte në rrugën e duhur dhe fshikullima e tij ishte një domosdoshmëri, ndërsa në një vjershë të gjatë me 14 strofa, e nënshkruar me emrin P.Raullasi thuhet: “Ti je thelb i Shqipërisë, / je brum’i naturës’sanë, / je ndihmës i Perëndisë, kundër armiqve t’anë, / Ti je dor’ e Perëndisë” (Po aty: 4).

Gazeta shprehte hapur simpatinë për ata që përpiqeshin “me mish e shpirt” për kombin e tyre. Nga ana tjetër, ajo fshikullonte e satirizonte me “shkop” parinë feudale të vendit, “kamësit’ që” prishnin para pa fund nëpër kafene dhe nuk ndihmonin me asnjë grosh çështjen shqiptare. Ndërsa luftëtarët e lirisë, “Ata që pa pyetur as komitet as njeri, po vetëm zemrën e tyre dhe marrin hakën për të këqijat që heq kombi i tyre nga ata të mëdhenjë shkaktarë, quhen shenjtorë të kombit të tyre”. (Shkopi, 1908, Nr.3:1). Me një krahasim shumë sinjifikativ në shkrimin “Gamilet e Anadoli”, ai i cilëson kështu turkomanët dhe grekomanët: “Nuk janë njërëz, janë gamile, bukën që hanë e hanë haram, duhet të hanë gjemba të gomarit”(Po aty:3).

Në gjirin e shoqërisë së Egjiptit në ato vite kishin lindur mosmarrëveshje midis shqiptarëve. Në faqet e gazetës “Shkopi” dalin në shesh fakte që dëshmojnë për grindje e mospajtime të thella. Në këtë lufte u përfshi dhe Çajupi, i cili gjatë veprimtarisë së tij do t’u kundërvijë elementëve shqiptarë që i përcaktonte si oportunistë. Për këtë ai botoi në faqet e gazetës “Shkopi” vjershën “Shkopi”, ku përgëzonte gazetën dhe bashkohej me frymën demaskuese të saj dhe që i shkonte për shtat qëllimit të vetëdeklaruar të gazetës: “Si bariu kur vete ndë tufë, / dhe ndan shqerrat nga gjedha e liq, / kështu dhe ti do ndash grekomanët, / të këqinj të atdheut armiq”(Shkopi, 1907, Nr.2:1).

Një problem tjetër të mprehtë që shtron A.Tashko ja është çështja e një alfabeti unik të shqipes, në artikullin “Shkronjat e gjuhës tënë”. Në kushtet e politikës shkombëtarizuese të mohimit të gjuhës dhe shkollës shqipe, çështja e një alfabeti të vetëm ishte urgjente. Kjo çështje zhvillohej në gjirin e një lufte të dyfishtë sa ndaj

turqve dhe grekërve, që përpiqeshin me çdo kusht të pengonin përhapjen e gjuhës shqipe, aq edhe kundër mosmarrëveshjeve që kishin shoqëritë dhe grupet e ndryshme kulturore të shqiptare në mërgim. Domosdoshmërinë e përhapjes së gjuhës shqipe Athanas Tashkoja e shihte si parësore në çështjen kombëtare dhe i jepte një rëndësi të dorës së parë: "Sot për sot kombi Shqiptar ndahet nga shkaku i mos pasjes gjuhë të liruar në dy degë pa trup; Degë tyrke dhe degë Greku. Po të bënet gjuha shqipe e liruar me shkolla me vete, degët do të bëhn trup, trupi do të jetë e thuhet shqiptar"(Po aty: 1). Ndërsa për çështjen e alfabetit, ai duke qenë në korent të polemikave të ndryshme që zhvilloheshin aso kohe, përkohësisht mbron idenë e përdorimit të alfabetit të Shoqërisë së Stambollit, por i vetëdijshëm se hëpërhë ai mund të plotësonte nevojat urgjente të kohës, por që kishte vend për përmirësim: "Na duket se është më e mirë dhe e drejtë të ngrohemi tani në këtë oxhak, pak të shtrembërë, i cili na shpie tymin drejt sesa të rimë me duar lidhur e të ngordhim nga të ftohtët duke u grinder për oxhak"(Po aty:1) dhe vizionari mendjekthjellët u dërgon porosinë e tij ironike bashkëkombasve të tij: "Për oxhak të mirë e të drejtë, të bukur me boj' e me varak duhet të mendohemi pasi të ngrehim shtëpinë tonë e pasi të futim kokën tënë brenda"(Po aty: 1).

Një pozicion të drejtë e të vendosur mbajti gazeta "Shkopi" ndaj pushtuesit të huaj e sidomos ndaj ngjarjeve të korrikut të 1908-s, që sollën në fuqi regjimin konstitucional të xhonturqve. Përsëri, me idealizmin e atdhetarit dhe me mendimin e qartë dhe largpamës të patriotit, ai nuk ushqen asnjë iluzion rreth politikës së re të xhonturqve dhe konstitucionit të tyre. Këtë e përforcon botimi në nr. 2 të "Shkopit" një shkrim i Çajupit; "Kostitucioni në Greqi", në të cilin Çajupi argumenton me një stil të ashpër (sipas F.Dados), se shpallja e konstitucionit nuk e shpëton Turqinë dhe se e mira dhe e ardhmja e vendit tonë është shkëputja e plotë nga perandoria anadollake: "Turqia mund të vejë mbarë, mund të rrojë më shumë vjet, po Shqipëria nuk do të jetë siç dëshirojnë shqiptarët e vërtetë nuk do të qeveriset kurrë dhe do të jetë një copë e Turqisë. Fort mirë për turqit e rinj"(Shkopi,1908, Nr.4:4). Programi vizionar i Çajupit, Tashkos dhe patriotëve të tjerë, ishte që Shqipëria të rrokte rrugën e Evropës së qytetëruar dhe të shkëputej sa me parë nga Turqia: "Në duam të jetojmë kombëtarisht duhet të rrokim qytetërimin e perëndimit, meqënëse gjendemi në palcë të Evropës, se ndryshe si komb jemi të dënuar me vdekje". Në shkrimet e Tashkos reflektohen qartë pikëpamjet dhe stoicizmi i tij për të mos pasur asnjë mëdyshje ndaj politikave turke dhe greke. Me një mprehtësi logjike, me nje thjeshtësi stili dhe me një

të folur të drejtpërdrejtë, ai thekson: "Turqit e rinj janë më të dëmshëm se të vjetrit, se janë ustallarë dhe do na e shuajnë kombësinë tonë më kollaj. Të vjetrit të dërgonin në djall po të thoshe jam shqiptar, të rinjtë të presin gjuhën po të thuash: "Rroftë Shqipëria" (Po aty: 1). Iluzioni dhe mashtrimi i xhonturqve me atë pak liri që i dha gjuhës shqipe, është plotësisht i qartë nën optikën e Athanas Tashkos, të filtruar përmes një përvoje të gjatë dhe të dhimbshme për ne si komb, ndaj deklaron: "Konstitucioni do të na humbasë në kombësinë", duke dashur t'u bëjë me dije shqiptarëve dhe turkomanëve rrezikun evident të fshehur nën petkun e mashtrimit. Si të vetmen rrugë të shpëtimit të shqiptarëve ai propogandon luftën me armë në dorë, ndaj dëshmorët dhe luftëtarët e lirisë ai i ngre në rangun e shenjtorëve.

Një vend të veçantë zë në gazetë dhe problemi i mosmarrëveshjeve që ekzistonin aso kohe mes anëtarëve të shoqërisë atje. Këtë situatë e përcjellin më së miri dy shkrime të nr. 2 të gazetës "Shkopi"; "Vetë vrasësi" dhe "Cmiret e veçanta. Mëritë e poshtëra". E para mer shkas nga një akt gjaknxehtësie i Nikolla Naços ndaj Vasil Zografit, për çështje mosmarrëveshjeje. "Shkopi" e fshikullon rëndë këtë akt në këta dy artikuj, pa kursyer gjuhën e satirës dhe sarkazmës therrëse, por dhe tonet e forta këshilluese që i bashkëngjiten kësaj satire: "Çdo patriot i vërtetë, i cili ka punuar e punon për çështjen kombëtare me mish e me shpirt është i nderçëm e i shtrenjtë në gjirin e popullit të tij. Ata që e quajnë të lig' e të keqe shtimn' e bashkimin në dashurinë e njësinë, s'mund që të jenë tjetër veç tradhëtorë e sharlatanë" (Shkopi, 1907, Nr.2: 2).

Me këtë vështrim të shpejtë që u hodhëm disa prej problematikave dhe mënyrës se si i trajtoi "Shkopi" ato, arrijmë në përfundimin se kjo gazetë luajti një rol të rëndësishëm në shtypin e periudhës 1900-1912, në zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare në prag të Pavarësisë dhe organizimin e një kryengritjeje të armatosur. Faqet e "Shkopit" sipas S. Adhamit i përshkonte tej e ndanë ndjenja e një patriotizmi të kulluar e të panjollë. Edhe pse nuk dilte periodikisht dhe në mënyrë të çrregullt, gazeta luajti një rol të rëndësishëm në kohën e vet, çka, siç e përmendëm, u manifestua në shumë letra dhe shkrime dërguar Tashkos. Pse "Shkopi" zgjodhi për të folur gjuhën e satirës dhe fshillullimit? Koha nuk priste. Kishte kaluar ajo periudhë e këshillimit të shqiptarëve për bashkim, vëllazëri, dashuri që propogandonin rilindasit, tani ata duhet të zgjoheshin. Vetëm vënia e gishtit mbi plagë mund ta bënte këtë. Njeri me logjikë të mprehtë, largpamës me një intuitë të fuqishme, që orientohej vetëm nga atdhedashuria, Tashkoja përdori satirën dërmonjëse dhe therrëse për të treguar të

vertetën e dhimbshme. Satira dhe sarkazma përdoren me mjeshtëri nga njerëz që vuajnë thellë dhe këtë vuajtje preferojnë ta japin përmes talljes dhe goditjes. Kjo është aftësia e njerëzve të mençur që e shndërron satirën dhe sarkazmën në një mjet për propagandimin e një qëllimi të lartë ashtu siç bëri Tashkoja. Por, ajo që duhet theksuar te Athanas Tashkoja, është fakti se ai hodhi themelet e publicistikës satirike shqiptare, se u përpoq në shkrimet e tij të pulsonte me pulsën e atdheut dhe aspiratave, se u përpoq ta ruante të pastër shqipen në shkrimet e tij dhe jashtë stilit të gazetarisë vulgare, sepse krijoi një gazetë independente që nuk iu nënshtrua asnjë klani dhe qëllimi antishqiptar dhe antihumanist, se u mundua që në të shprehurën e vet të afrohej sa më pranë fjalës së latuar me penën e mjeshtër, se pati kurajon të konstatonte, të akuzonte dhe të denonconte, jashtë çdo lloji të tele politikë, se njihte mirë realitetin ndërkombëtar dhe historinë e kombeve, çka i shërbente për krahasime dhe polemika, se ishte tepër vizionar mbi ndërtimin e shtetit të ri shqiptar, ishte realist ironik dhe sarkastik i mprehtë se dinte të sulmonte kur duhej dhe si duhej, me forcën që i jepte mendimi i lirë dhe ëndrra për një Shqipëri ndryshe, se asnjë lloj mjegulle, sado e tejdukshme nuk e mbuloi për asnjë çast idealin e tij për progresin dhe qytetërimin.

Vetëm me idealizmin e purifikuar përmes atdhedashurisë, ai meriton të kthehet në një përmendore të aspiratave dhe sakrificave mbi altarin e shenjtë të kombit. Ideali i tij ishte Shqipëria e lirë, ndaj nuk mënonte të thoshte në të famshmet filozofi të “Shkopit: ”Që tani e tutje ay shqiptar që do të bëjë krushqi me komb të huaj, myslyman a i krishterë, do të jetë i mallkuar, që tani e tutje ata shqiptarë që shkruajnë në mes tyre letra të tjera përveç shqipes, janë viçer të palëpirë”

Referenca:

E.Koço, *Athanas Tashko(1863-1915)*, Botime FLESH, Tiranë, 2015

Gazeta Drita, 30 maj, 1982

Gazeta Koha, Jamestown, 9 dhjetor, 1915

Gazeta Shkopi, Kajro, 10 mars 1907, nr.1.

Gazeta Shkopi, Kajro, 28 prill 1908, nr.3.

Gazeta Shkopi, Kajro, 30 maj, 1907, nr.2.

Msc. NELI NAÇO

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

IDE DHE MESAZHE NË LETRAT E ATHANAS TASHKOS DËRGUAR VEPRIMTARËVE SHQIPTARË

Letrat që Athanas Tashkoja u dërgon veprimtarëve shqiptarë në vise të ndryshme, janë një dokument i një rëndësie të veçantë për të kuptuar pozicionin e tij intelektual, atdhetar dhe humanist. Letërkëmbimi i Athanas Tashkos vjen natyrshëm si një mënyrë komunikimi, dinamikë e kohës së para pavarësisë. Nathalie Clayer shprehet: “Kjo dinamikë ndërmjet kolonive mbështetej mbi nënrrjete të veprimtarëve të shqiptarizmit, lidhjet e të cilëve merrnin formën e lidhjeve epistolare, e kontakteve në rastet e zhvendosjeve dhe kur bëhej fjalë për financime. Ajo mbështetej gjithashtu mbi rrjete krahinore, të fshatit ose familjare.” (Clayer, 2009:385).

Letrat dërguar veprimtarëve shqiptarë fillojnë prej datës 27 Mars 1908, me një letër që Tashkoja ia dërgon Zotit Mitko Mitko dhe mbyllen me “Letr’ e hapur Dhimogjerondisë Voskopojare të Korçës” të shkruar më 19 Korrik 1912. Po t’i shohim në mënyrë të përmbledhur letrat , do të gjejmë: letra e parë i dërgohet Zotit Mitko Mitko, pesë prej tyre i drejtohen Zotit Jani Vruho, njëzet letra zotit Sotir Kolea dhe letra e fundit është ajo që Tashkoja i dërgon Dhimogjerondisë Voskopojare të Korçës në datën e sipërpërmendur.

Letërkëmbimi që Tashko ka lënë me këta veprimtarë shqiptarë, kryesisht me Sotir Kolean, është i një rëndësie të veçantë për të kuptuar karakterin dhe natyrën e tij, botëkuptimin atdhetar dhe kryesisht orientimin e psikikës së tij drejt çështjes shqiptare. Ato problematika që Athanas Tashkoja artikulon në letërkëmbim, janë ato problematika që shqetësojnë mendjen e tij, janë ato problematika me të cilat përballet çështja shqiptare në përgjithësi ose janë ato problematika që kolonisë shqiptare e Egjiptit i shtrohen për t’i zgjidhur eventualisht.

Kryesisht , në letrat e Tashkos drejtuar Sotir Koleas, të bie në sy që ndarja e opinionëve me këtë të fundit është e hapur dhe artikulli mesazhi që Tashkoja i përcjell, është i plotë dhe i qartë, pa nënkuptime, me mendje të hapur. Në letrën e tij dërguar Koleas, Tashkoja shprehet qartazi “unë di se tek ti kam më të mëdhatë besime dhe shpresa, unë të di ty si vehten time, dhe të lutem fort, të më besosh, të fsheur prej teje nuk kam, prandaj të shkruanj kështu xhveshur, xhveshur edhe pa

komplimenta. Unë nuku të shkruanj letra, unë të qanj halln' e zemrës se në ty gjen prehë.”(Koço, 2015)⁶. Ndaj, në hyrjen e kapitullit : “Mbi letërkëmbimin dhe letra të dërguara nga Athanas Tashko”, Eno Koçoja shprehet: “Letërkëmbimi i Tashkos me veprimtarët e ndryshëm shqiptarë përshkohet nga një gërshetim i ndjenjës atdhetare me atë të një mirëbesimi e çiltërsie të ndjesive personale. Ndërgjegjja atdhetare është sa e rrënjosur në vetvete aq dhe e shprehur mes tij dhe letërkëmbyesit, ndërsa ndjesitë personale janë mjaft më të rezervuara dhe këto shprehen vetëm ndaj tyre me të cilët Tashkoja mund t’u hapte zemrën apo dhe anasjelltas.”(Po aty).

Në mjedisin shqipfolës të Egjiptit shfaqet edhe procesi i akulturacionit që ndodh rëndom kur një grup kulturor përballet me një grupim tjetër më i fuqishëm kulturalisht se ai. Nathalie Clayer thotë se: “Duhet mbajtur parasysh se në fillim të shekullit, numri i emigrantëve (dhe, në një masë më të vogël, i refugjatëve politikë) shqiptarë në Egjipt po shkonte drejt rritjes, porse, disa prej tyre kishin prirjen të shkriheshin në shoqërinë turko – egjiptiane (midis myslimanëve) dhe në bashkësinë greke (porsa i përket ortodoksëve).”(Clayer, 2009: 126). Një dukuri e tillë, e brendshme, bie në sy edhe në shoqërinë “Bashkimi”. Dy prirje vërehen në fenomenin që ndodh në mesin e shoqërive patriotike dhe atdhetare me orientim nacionalist në Egjipt. Letërkëmbimi i Tashkos dëshmon për këtë. Në letrën e 21 shkurtit 1911 ai shprehet : “Qëllimi i kësaj shoqërie sot për sot është ndarë në dy mendje; njëra mendje është e doktorëve Turtulli, Adhamidhi, Voilla, dhe e këshilltarëve Thomaidhi, Jatru dhe L. Logori. Tjatra është e Sekretarit, Arkëtarit dhe këshilltarëve L. Naçi, Th. Dine, V. Logori, A. Tashko. Këshilltarët L. Kotta, J. Armodhi janë laraska. E para mendje si e shohim neve është jo për të mirën e kombësisë Shqipëtare po për të mirën e kombësisë Greke. E dyta është thjesht për të mirën e kombit Shqipëtar.”(Koço, 2015).

Këtë dukuri do ta cilësoja si një akulturacion të pjesshëm që ndodh në mesin e një organizate. Kjo letër na jep tipologjinë e ndërtimit të dy formave të nacionalistit shqiptar. Athanas Tashkoja e fut veten në grupin e veprimtarëve të shqiptarizmit, ndërsa grupi i dytë është për një nacionalizëm dypjesësh i cili përshkruhet kështu nga Clayer: “Kishte edhe një numër individësh, të cilësuar si “grekomanë” nga veprimtarët e shqiptarizmit, që kundërshtonin helenizmin, që në të vërtetë ishin edhe ata veprimtarë të shqiptarizmit, porse shqiptarizmin e shikonin të bashkuar me

⁶Letër e Tashkos drejtuar Koleas, 11 maj 1911, dorëshkrimi.

helenizmin. Në Egjipt në këtë kategori futeshin “doktorët” Turtulli dhe Adhamidhi. Me origjinë nga Korça, Dr. Adhamidhi ushtronte mjekësinë në Kajro... Atë e paraqesin si një intrigant, që mendonte para së gjithash për interesin personal dhe se ishte shumë në favor të një bashkimi midis Shqipërisë dhe Greqisë. Në të vërtetë, ky personazh ishte pa dyshim prototipi i “patriotit shqiptar” i bindur në nevojën për të bërë kauzë të përbashkët me Greqinë. Në vitin 1901, një raport austro – hungarez e paraqiste si një patriot shqiptar me ndikim, të cilin ministria greke e punëve të jashtme u përpoq ta bënte për vete. Ai u ftua disa herë në atë kohë në Athinë dhe në vazhden e diskutimeve do të prekej çështja e futjes së gjuhës shqipe në shkollat greke si dhe hapja e një shkolle shqiptare në Korfuz” (Clayer , 2009: 451-452). Clayer duket se i pranon të dyja shfaqjet si forma të nacionalizmit shqiptar, por mendimet e shprehura qartazi në letrat e Tashkos mund të na qartësojnë disa aspekte të paktën për atë çka mund të ngjiste, nëse nacionalizmi do të shihej vetëm nga kjo pikëpamje.

Tashkoja shprehet në një letër drejtuar Sotir Koleas më 1 qershor 1911 “*Neve shqipëtarëtë gjasim me gamiletë të cilat po s’u hoqnë prej kapistre nga një shtazë e huaj, nuku ecijn dot: Malësorët i heq Malzezi, Mirditasit Austria, Vlonjakët e Beratasit Italia, Orthodoxët Greqia, Myslimanët e Shkodrës Turqia. Unë, sikundër të thashë dhe tjetër erë, do përpiqem sa më mundet të mos lë të hiqemi nga të huajtë për fitim t’ atyre e për dëm tonë. Pa edhe në më kafshoftë ndonjë Gamile, unë nuku do prapsem. Tani kaurët e Misirit hiqen nga D-rët për përfitim të Greqisë e për dëm të Shqipërisë. Mua detyra ma do që ti praps kaurët nga D-rët, pa edhe në u zëmërofshin këta, ajo s’është puna ime. Pa edhe në thënçinë se unë dua ta mar monopol dashurinë e Shqipërisë, s’është puna ime. Në thënçin se unë kam mërira të veçanta për njërin e për tjetrin, edhe ajo s’është puna ime. Unë di se po të mos isha unë këtu në Misir, Adhamidhi dhe Turtulli do i kishin bërë shumë të këqia Shqipërisë. Unë i kam thyer këta armiq edhe unë do i thyenj prapë.*” (Koço, 2015)⁷. Në gjithë linjën e veprimtarisë së tij, Athanas Tashkoja është unik. Në letrat e shkruara prej tij nuk gjen shkarje, lajthitje, divergjenca. Mendimi i tij konverton drejt një çështjeje unike: çështjes së shqiptarizmit dhe rruga e ndjekur prej tij është e njëjtë dhe e pandryshueshme. Ai nuk pranon qasje të tjera drejt çështjes dhe kjo e bën atë unik në mendimin dhe punën e tij. Një ndërgjegje mesianike do ta quaja, duke mbajtur parasysht përkufizimin e thukët që ka dhënë Kristaq Jorgo për mesianizmin. Ai thotë: “Do të kuptojmë me këtë term

⁷ Letër e Tashkos drejtuar Koleas, 1 qershor 1911

bindjen në aftësinë e parathënë të një entiteti për të katalizuar ndryshime pozitive përtej vetvetes.”(Jorgo, 2000: 75). A nuk është gjithë veprimtaria e Tashkos një ndërgjegje mesianike e politike që katalizon ndryshime pozitive përtej vetvetes. Këtu dallohet diferenca e nacionalizmit të tij unik nga ai nacionalizëm i parashtruar prej Clayer dhe që Tashkoja e sheh si ndikime malazeze, austriake, italiane, greke dhe turke. Atë çka ndodh në Egjipt, ai e sheh të shtrirë në një nivel më të gjerë mbarëshqiptar dhe katalizon një mendim të tijin të pakontestueshëm.

Si një pjesë e mesianizmit të tij politik është edhe përhapja e identitetit kulturor shqiptar, i cili duhet të kthehet në një formë mbizotëruese për udhëheqës dhe drejtues. Këtë formë të identitetit kulturor shqiptar, shumë të rëndësishme për udhëheqësit e Pleqësisë, Tashkoja ia kundërvë pasurisë dhe kulturës së fituar globale. Ja si shprehet Thanas Tashkoja duke ju drejtuar Jani Vruhosh më 17 Dhjetor 1911: “Prandaj vinj me këtë letër të të kujtonj që të zësh të bësh propagandë për të zgjedhur Pleqësinë jo nga ata më të pasurit, po nga ata më të flaktët e më punëtorë për çështjen shqipëtare, pa le të jenë edhe pa *parle franse* edhe pa qostekë të florinjte.”(Koço, 2015). Ky identitet kulturor shqiptar, besnikëria ndaj tij duhet të kthehet në një lajtmotiv të zgjedhjes së elementit të ri drejtues. Pak më poshtë ai vazhdon: “Të flaktë shqiptarë këtu në Misir unë shoh vetëm këta, në të vjen ndër ment ty edhe nonjë tjetër, kujtoma.—Emrat e punëtorëve:—Thanas Tashko, Jani Vrouho, Vasil Logori, Milo Duçi, S. Kolea, Vani Mitko, A. Giovani [Aleksandër Xhuvani].” (Po aty).

Mesianizmi politik i Tashkos bie në sy në përgjigjen e tij ndaj *Thirrjes* së Sotir Koleas më 14 Mars 1911. Vërejtjet dhe ndreqjet e tij ndaj *Thirrjes*, janë konstruktive dhe të shkruara pas linjës së tij të koherente. Ai sugjeron për *Thirrjen*: “Sikundër që, pa mos u ndarë me të shkruarë a me nom, u bë zakon që të jenë dhe dy ministër të Krishterë, njëri Grek dhe njëri Ermen; kështu duhet që të jetë të pakënë edhe një ministër Shqipëtar, sepse edhe Shqipëtarëtë syre të mbretërisë Otomane, edhe më të zotërit nga të gjithë janë.” Duke shpallur kështu synimet patriotike të periudhës para pavarësisë për të rritur rolin e kombësisë shqiptare brenda perandorisë turke, një lloj lobimi që do të riste rolin e shqiptareve në këtë perandori.

Forcimin e identitetit shqiptar e sheh të rëndësishëm dhe ofron dy sugjerime për *Thirrjen* që artikulojnë: “Rogëtarëtë të Guvernësë të Shqipëris të jenë Shqipëtarë, ose qofshin dhe të huajë, po të dinë me do e mos gjuhënë e venditë, sepse edhe konstitucioni të cilinë jve e bëtë recka (paçavure) kështu urdhëron.”

Një çështje e rëndësishme për gjithë nacionalizmin shqiptar ishte çështja e

racës. Raca e mbivlerësuar e periudhës së Rilindjes Kombëtare është një nga çështjet e prekshme dhe të rëndësishme në të arsyetuarit e Tashkos. Ja si shprehet ai, përsëri për thirrjen: “Ushtarëtë Shqipëtarë të mos dërgohenë në vende të largë, me qëllim që të shuëtë raca jonë, po të stërvitenë dhe të përdorenë për të ruajturit të Rumelisë.”

Identiteti kulturor shpallet në një shtojcë që për të ka qenë shumë e rëndësishme. “Të njihen zyrtarisht shkronjat Latine për gjuhën shqipe dhe të ndiqen nga Guverna ata që kallinë spica me shkronjat Ebraishte.” Qëndrimet e Tashkos që formulojnë një posturë intelektuale dhe të formuar, nuk gjejmë një vërejtje të tij, e cila të jetë e frymëzuar nga interesat të vogla, të ulëta, personale; ato frymëzohen nga pasionet e mëdha të Rilindjes Kombëtare, gjuha, raca, identiteti kulturor.

Në letrat e tij të hapura vërehet tensioni që e shndërron Tashkon në një karakter unik. Aty ku gjen zhgënjimin, ai gjen edhe motivin për të vazhduar më tej. Më 14 Maj 1911 ai i shkruan Koleas: Tani mëso se unë jashtë dëshirës së shpirtit tim dhe me zemër të dërmuar të them se: “Nuku jam mâ Shqyptar”. Po, jo! dale se të gënjeva; zëmra më thotë ji shqipëtar po jo nga të “Bashkimitë”. Më thotë edhe një tjetër; më thotë bjeru “Bashkimnxhinjëve” edhe mos ki frikë për prishje pune, se këtu nuku prish punë, po i prish punë atij që do prishnjë punë.” Vargu që është gegërisht “Nuku jam mâ Shqyptar” duket se është përdorur në një kontekst tjetër nga ai i sarkazmës së Fishtës, megjithatë zhgënjimi i thënë me mllef, vetëm ringjiz energji të reja për të vazhduar më tej.

Literatura

Eno Koço, *Athanas Tashko (1863 - 1915)*, Botime FLESH, Tiranë, 2015.

Kristaq Jorgo, *Identiteti i Qendrës së Panjohur: Rasti Shqipëria*, në Tempulli, Nr. 2, Korçë, faqe 75.

Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Botime Përpjekja, Tiranë, 2009.

Msc. OLGIER BRAME
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

KUNDRIME GJUHËSORE MBI PUBLICISTIKËN DHE LETËRKËMBIMIN E ATHANAS TASHKOS

“*Bir i bekuar i Shqipërisë*” dhe “*Shok i kryqëzatës kombëtare*” do të ishin vlerësimet e Nolit për Athanas Tashkon, këtë figurë që zuri një vend të veçantë në historinë e Rilindjes sonë Kombëtare duke bërë emër të nderuar jo vetëm si një nga organizatorët dhe veprimtarët aktivë, por dhe si publicist i talentuar, me shkrimet kombëtare që botoi në shtypin e diasporës, nëpër faqet e gazetave autoritare si “Drita”, “Kombi”, “Dielli”, “Liria e Shqipërisë”, “Koha”, “Rrufeja” etj. (Jorgaqi, 2005:123-124). Emri i tij do të zinte vendin e merituar në radhën e patriotëve të shquar të këtij kombi dhe siç do të shprehej Gramenoja, *Historia kombëtare do ta ketë në faqet e saj Athanas Tashkon duke zbuluar shtyllat e saj me veprat dhe patriotizmin e tij.*

Krijimtaria e Athanas Tashkos dallohet për vlera të rëndësishme publicistike dhe epistolare me sfond patriotik e nacionalist, por nuk mund të anashkalohen dhe të mos përmenden vlerat e mirëfillta gjuhësore në këtë krijimtari.

Në punimin tonë jemi ndalur në disa kundrime gjuhësore, kryesisht të natyrës dialektologjike, të publicistikës dhe letërkëmbimit të Tashkos, vlerat të cilat janë krijuar duke u mbështetur në traditën shkrimore të shqipes, leksikun popullor, në vlerat e mëdha gjuhësore të bashkëkohësve të tij etj.

Në një kumtesë është e pamundur të kundrosh e të shtjellosh, sado në mënyrë të shkurtuar e të përmbledhur, një krijimtari kaq të larmishme publicistike dhe epistolare nga pikëpamja gjuhësore e dialektologjike, por do të përqendrohemi në aspektet më tipike që lidhen me gjuhën e përdorur nga Athanas Tashkoja në krijimtarinë e tij. Për këtë, si material burimor është përdorur libri i autorit Eno Koço, “Athanas Tashko”. Që në sqarimet e dhëna në fillim të librit të tij, vetë autori thekson se gjuha shqipe e Tashkos e përdorur në letërkëmbim apo shkrimet në gazeta është ruajtur bazuar më tepër mbi dialektin e folur se sa atë të shkruar të shqipes që përdorej aso kohe në Egjipt. Në këtë mënyrë kemi patur mundësi që kundrimin tonë ta bëjmë mbi tekste origjinale të letrave dhe artikujve të shtypur a në dorëshkrim të Tashkos.

Do të përpiqemi të bëjmë një renditje të disa prej dukurive kryesore të vërejtura në gjuhën e Tashkos sidomos në publicistikën e tij , por edhe në letërkëmbim.

Së pari vihet re gjerësisht përdorimi i apostrofit, kjo mesa duket nisur edhe nga tradita shkrimore e variantit letrar jugor. Përdorimi i tij haset dendur kryesisht në zëvendësimin e zanores *ë* të patheksuar në pozicion fundor, e cila zakonisht në të folur reduktohet për shkaqe të ndryshme fonetike. *Vjesht'* (76), *Gazet'* (fq.78), *nyj'*(89), *djemt'*(90), *pjes* (92), *her'*(93), *shum'*(95), *ark'*(96), *dor'* (170), *ësht'*(151), *drejtësin'*(151), etj. Ky apostrofim, në fjalë të këtij tipi, vihet re në mënyrë të qëndrueshme, në të gjitha ato raste kur fjala që vjen pas, fillon me një zanore dhe elizioni i zanores së temës apostrofohet rregullisht.

Nga ana tjetër, në të gjitha rastet e tjera, vihet re se ruajtja apo vendosja e kësaj zanoreje në fund të fjalës dhe pozicione të tjera brenda saj, në mjaft raste i përgjigjet traditës dialektore të toskërishtes duke sjellë në këtë rast përdorime tipike dialektore në fjalë si: *errësirësë* (78), *të huajë* (78), *zonjatë* (80), *gazetatë* (82), *Shqipëtarëtë të Misiritë* (82), *fjalëtë* (82), *shkollatë* (90), *siguruarë* (105), *gamiletë* (107), *ngatërimetë* (114) etj.

Përkundrazi, ndeshet rregullsi në përdorimin e apostrofit në rastet e trajtave të shkurtra dhe trajtave të shkurtra të bashkuara, përemrit pyetës *ç'* , pjesëzave mohuese etj., si: *t'i* jepet (80), *s'e* kërkove (86), *ç'të* doni (86), *t'ua* japë ...(89), *s'u* do zemra...(94), *t'ju* dërgonj...(96), *ç'u* bë ...(97) , me *ç'të* drejtë ...(98) , *ç'* duan..., *ç'* kërkojnë ...(98), *s'* kemi...(107), *t'u* dërmojmë... (163), *t'i* bëjmë ...(166) etj. apo dhe në emrat e farefisnisë të tipit: *t'ëmën e t'anë* (89).

Me mjaft interes janë disa dallimet e tjera fonetike, kryesisht të disa fonemave tipike, siç është rasti i zanores *e/ë* ,si një dallim i pakushtëzuar fonetik, ku gjendja paraqitet e përzier; tek disa fjalë zanorja e parahundoreve shkruhet si e tillë dhe në disa raste nuk ruhet rregulli, madje edhe brenda të njëjtit artikull, (të datës 13.V.1910), e njëjta fjalë paraqitet në dy variante të ndryshme si: *mendje* dhe *mëndje* (112), *qënkërka* (95), por edhe *qenka* (116) , *gjendje* (113), por *gjëmba* (112), *me qenë* (95), por edhe *me qënë* pra...(po aty) etj...

Përgjithësisht nuk dalin të konsoliduara në një pjesë fjalësh tipike grupet e bashkëtingëlloreve: *mb, ng, nd*, ku, në një pjesë të përdorimeve mungon ruajtja e tyre në trajtën e plotë, kurse në një pjesë tjetër përdoren pa qenë nevoja p.sh: *nonjë/ndonjë* (84), *nonjëherë/ndonjëherë* (88), *nër/ndër* (98, 101, 103), *gjan/ngjan*

(99), por edhe *ndë/në* (81, 93,120...), etj., dukuri kjo me interes dialektologjik duke marrë parasysh të folmen nga vjen autori.

Karakteristikë e të folmes së toskërishtes veriore e cila ruhet e konsoliduar në gjuhën e autorit, është dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fjalë të tipit:

njerës / njërëz (78), *mpron/mbron* (78), *muntnë/mundnë* (79), *funt/fund* (80), *njëqint / njëqind* (80), *të math/madh* (82), *munt/mund* (82), *mënttë/mendtë* (84), *të lik/të lig* (86), *liksht / ligsh* (99), *mblith / mblidh* (104), *komp / komb* (104), *bint / bind* (108) etj.

Nuk është konsoliduar dhe ruajtja e zanores *e* të theksuar para hundoreve *m*, *n*, *nj*, e cila, në fjalë të ndryshme ndeshet herë si *e* dhe herë si *ë*, madje edhe tek e njëjta fjalë në përdorime të ndryshme nuk është e konsoliduar, p.sh: *mëndje* (94) / *mendje* (96) ; *mëndje/mendja* (113), *zemër* (94) / *zëmëra* (124)/ *zëmërohem* (95), *vent* (95) / *vënt* (99), *brenda* (96) / *brënda* (101), *mënt* (117), etj.

Një veçori që ndeshet në mjaft raste dhe vlen për shqyrtim nga pikëpamja dialektologjike, është ajo e cila lidhet me përdorimin e disa trajtave të fjalëve karakteristike për dialektin e gegërishtes, të tilla si:

-Përemri vetor V. I. shumës në trajtën geqe *na /ne*

...edhe *na* shqipëtarët e Egjyptes do të përpiqemi...(80);

...na fut *na* në dhe të gjallë, ndë është që kupëtojmë dhe *na* nga kjo botë (81);

...që të dukemi dhe *na* se jemi gjallë...(82) ;

Puna thotë se *na* Shqipëtarët të Misirit ...(82);

Nuku jam *mâ Shqyptar* etj.

Pjesorja e foljes së kaluar në mbiemër me paranyjëzim, e cila haset në të dy variantet:

Letr' *e hapët* S. Koleas...(93)

Letr' *e hapur* Dhimogjerondisë Voskopojare...(100)

Letr' *e hapët* L.M.T. Sulltan Mehmetit të V...(108) etj.

-Fakte që kanë të bëjnë me dukurinë e rotacizmit. Ndërrimi i *n*-së në *r*, i cili ka ndodhur shumë herët në dialektin jugor të shqipes dhe, në shkrimet e Tashkos, ndeshet si në gegërisht, pavarësisht se në fjalë të izoluar. Këto përdorime ndeshen si në letërkëmbimin e botuar edhe në ato dorëshkrim. Mendojmë se kjo lidhet ose ndikohet nga fakti se kujt i drejtohet me këtë emër dhe në ç'rrethana.

...sekretari i Shoqëris “Bashkim” dhe në të cilën *zotëni* e tij ...(97)⁸

Mblith mendjen pra o *zotëni* se na plase shpirtin.(104);⁹

- Krahas formës *tënde*, gjenden të dy variantet e formave të pronorit *tat /tate* në përdorim, forma që gjenden kryesisht në Shqipërinë e Mesme.

...ç’bënet brenda në shtëpi *tënde* dhe fëmijërinë *tate*, po nuku ditkërke...(110),

Prej ndryshimeve fonetike që pësojnë disa bashkëtingëllore ose grupe bashkëtingëlloresh, në të folme të ndryshme, përftohen dallime në përbërjen fonematike të fjalëve. Një rast tipik që haset në shkrimet e Tashkos, çka bën dhe një karakteristikë tipike të të folmes së Toskërishtes Veriore e, veçanërisht të të folmes së Korçës, është edhe prania e fonemës *nj*, në mbaresën e foljeve në mënyrën dëftore e lidhore. Raste të tilla mund të përmendim: *bënj* (79), *të urdhëronjë* (85), *kërkonjë* (85), *t’ju dërgonj* (96), *kupëtonj* (97), *prisnja* (103), *të gjenjë* (124), *të na turbullonjë* (141) etj., të cilat përbëjnë njëkohësisht dallime morfologjike të cilat prekin pjesërisht dhe karakterin strukturor, duke marrë rëndësi të madhe në dallimet midis dialekteve të një gjuhe dhe duke spikatur njëkohësisht këtë formë të vjetër të mbaresës *-nj* që ndeshet kryesisht në Toskërishten Veriore.

-Një karakteristikë tjetër që vihet re në trajtat foljore është ruajtja e disa mbaresave të shumësit të së kryerës së thjeshtë: *-më, -të, -në*, në folje të tipit: *ritnë*, (78), *muntmë* (79), *u trazuanë* (80), *pyetnë* (86), *përgjigjtë* (95), etj. Edhe për trajtat foljore të mënyrave e kohëve të tjera, te Tashkoja hasen karakteristikat tipike, ku sa për ilustrim, mund të sjellim variantin fonetik me mbaresën *-ish*: *do japish; ta japish* (110, 111) ose variantin ku *-tsh* ka dhënë *-ç*: *heshtçim* (117) etj.

-Lëkundshëm paraqitet edhe dukuria e trajtave rasore, ku përveç trajtave të rregullta, gjenden edhe variantet e gjinore - dhanores shumë në fomat: *e prindërvet* (165), *të hallevet* (167), *punëravet* (168), *armiqëvet* (169) etj.

-Të pakonsoliduara gjenden disa dukuri që lidhen me fjalëformimin e fjalëve siç janë rasti i kompozimit dhe përngjitjes ose ndonjë rast prejardhjeje, sepse ka lëkundje nëse fjalët janë konsideruar si një e vetme (kompozitë ose përngjitje) apo fjalë të veçanta. Edhe nga mënyra e paraqitjes, kur janë konsideruar si kompozita apo përngjitje, në shkrim paraqiten me ose pa vijë lidhëse në mes, të tilla si: *me qenë se* (79), *as një herë* (79), *me qënë që* (82), *ndonjë herë* (87), *do -me-thënë* (87), *do-e-mos* (114), *këmbë-kryq* (118), *të pa ditur* (120), *gjak pirës* (120), *faqe -*

⁸ Letr’ e hapët S.Koleas, P.O.B. 490, Aleksandrie, “Liri e Shqipërisë”, 20 Maj 1912 (No. 42),

⁹ Shkrime me dorë të pabotuara. Z. Faik Konitza, Boston, Mass. Fayoum, 18/12/1912

zezë (124), *mendje shkurtër* (124), *nonjë erë* (127), *këpucë –grisurit* (149), *bashkë-gjindje* (154), *mos-pasjesë* (157), *për-një-herësh* (166), *pesë-dhjetë* (173), *një-qint* (175), etj.

Me luhatje paraqitet edhe përdorimi i nistoreve *sh-/zh-/ç-* në fjalë të ndryshme si: *çpallur* (80), *xhvishetë* (91), *xbreç* (103), *të çquarit* (106), *squarë* (120), *çquajnë* (122), *çporrë* (124), *cmirë* (125), *çpallë* (154), *xbraz* (167) etj., por në fjalë të tjera ai paraqitet i rregullt.

U përpoqëm të sjellim disa prej dukurive gjuhësore tipike të vërejtura në publicistikën dhe letërkëmbimin e Athanas Tashkos, pasi gjerësia e veprës së tij përbën një korpus burimor shumë të rëndësishëm edhe në aspektin gjuhësor, veçmas në atë dialektologjik. Sikundër e theksuam më herët, një pjesë të këtyre dukurive autori i librit i ka përmenduar që në hyrje në shënimet mbi gramatikën.

Leksiku i Tashkos, ndërtimet sintaksore, fjalët e frazeologjizmat e përdorura në shkrimet e tij, paraqesin interes dhe mund të bëhen objekt studimi i rëndësishëm në leksikologji e leksikografi, dialektologji e gramatikë, kjo, edhe nëse marrim parasysh faktin se një pjesë e mirë e shkrimeve të Tashkos janë dorëshkrime në formën fillestare.

E parë në këndvështrimin gjuhësor-dialektologjik, gjuha e Athanas Tashkos në letërkëmbimin dhe publicistikën e tij, mund të shërbejë si një burim dhe visar për të nxjerrë paralele me interes studimor rreth dukurive dialektore dhe gjuhës letrare apo gjendjes gjuhësore të dialekteve dje dhe sot.

Referenca

- AShSh, *Dialektologjia Shqiptare*, (I-VII), Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë
Gjinari J., Shkurtaj Gj. (2009), *Dialektologji*, SHBLU, Tiranë
Jorgaçi, N. (2005). *Jeta e Fan S. Nolit, vol I*. Tiranë: Ombra-GVG.
Koço, E. (2015). *Athanas Tashko (1863-1915)*, Botimet FLESH, Tiranë

Dr. SOKOL SUPARAKU
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

SHEMBULLI I ATHANAS TASHKOS MBI ZHVILLIMIN E IDENTITETIT ETNIK SHQIPTAR

Figura e Athanas (Thanas) Tashkos (1863-1915) është trajtuar shumë pak nga shkencë humane shqiptare, që merret me studimin e figurave të rëndësishme të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Kjo ndoshta për faktin se për ambientin akademik shqiptar, personazhi i tij nuk i “përmbush” kriteret e “intelektualit të kompletuar” ose të njeriut të penës¹⁰.

Në fakt edhe autori i këtij shkrimi, edhe pse i interesuar mbi studimin e zhvillimeve sociale të periudhës historike në fjalë, e cila nuk mund të zbardhet pa studimin e personazheve historike, nuk do t’i ishte qasur figurës së Tashkos nëse nuk do të kishte pasur shtysën e ambientit akademik dhe shoqëror ku bën pjesë, gjithashtu edhe ky ambient, po të mos kishte lidhje shpirtërore me bashkëqytetarin Athanas Tashko, ndoshta, do të kishte qenë po aq indeferent sa pjesa tjetër. Sidoqoftë edhe duke u nisur nga këto premisa studimore, në dukje të lidhura më shumë me qëllime përkujtuuese, arrihet të zbulohet një personazh shumë i rëndësishëm nëpërmjet të cilit mund të kuptojmë më mirë ambientin politiko-kulturor, ku jetoi dhe veprroi Tashkoja, duke dhënë një kontribut në lëmin e studimeve socio-historike.

Kështu, duke studiuar veprën dhe vullnetin e Tashkos (sepse nga ajo që kemi kuptuar bëhet fjalë për një njeri shumë të vullnetshëm sa i përket vënies në jetë të idealeve politike që kishte përqafuar), ne përfitojmë një figurë simbolike që mbart një botëkuptim politik dhe kulturor original, që na ndihmon të kuptojmë panoramën e larmishme të zhvillimeve politike dhe formimit të identiteve politike dhe kulturore gjatë periudhës së lindjes së nacionalizmit shqiptar dhe ballkanas.

Duke u nisur pra nga konteksti historik, mendojmë se është me vlerë shkencore krahasimi i pozicionit të Tashkos me atë të bashkëkohësve. Nisur edhe nga përvoja studimore personale e autorit të këtyre rreshtave, vendosëm ta nisim këtë

¹⁰ Fakt domethënës për këtë është se i vetmi burim material dinjitoz, që na mundësoi të krijojmë një ide të qartë në lidhje me jetën dhe veprën e Athanas Tashkos, është një përmbledhje me dokumente, akoma e pabotuar, e punuar nga nipi i tij Eno Koço, që siç e dimë është një figurë e rëndësishme e artit shqiptar. Si profesionistë të botës akademike i jemi borxhlinj Eno Koços për këtë përmbledhje dinjitoze, që i jep shkencave humane një pasuri të madhe me burime parësore mbi figurën e Tashkos.

hulumtim mbi figurën e Tashkos , duke i bashkangjitur atij dhe shembullin e ofruar nga bashkëqytetari i tij Thimi Mitkoja, me të cilin Athanasi ndan edhe një përvojë shoqërore të përbashkët, siç ishte përkatësia e tyre sociale prej borgjezësh, të cilët e arritën ngritjen e tyre shoqërore falë profesionit të tregtarit që e ushtruan që të dy në koloninë shqiptare të Egjiptit.

Gjithashtu, me rëndësi është dhe fakti se që të dy e morën edukatën e parë në qytetin e tyre të fëmijërisë, që ishte Korça. Ndoshta, është domethënës fakti se ky qytet ishte i vetmi me një fizionomi kulturore që i përngjasonte një bote kulturore borgjeze, ndryshe nga pjesa tjetër e qyteteve e tjera shqiptare. Për arsye të vlefshme, nuk po zgjatemi sërish në mënyrë të përsëritur në trajtimin e kontekstit të zhvillimeve shoqërore të lindjes, formimit dhe rrugëtimit të leëvizjeve kombëtariste në gjirin e shoqërisë europiane dhe, më konkretisht asaj shqiptare, sepse personalisht e kemi trajtuar në rastin e punimit mbi Thimi Mitkon¹¹, por edhe për faktin se tashmë lexuesi është i njohur me studimet e shumta teorike që trajtojnë këtë epokë historike.

Ajo që mund të na shërbejë këtu si një kontestualizim teorik është përmendja e “Epokës Moderne” si koncept me referim socio-historik, nga ku lexuesi i këtij punimi do të mund të historizojë (të interpretojë në lidhje me momentin historik në fjalë), pozicionin e Tashkos, ashtu siç kemi bërë me Mitkon. Pra ashtu si Mitkoja edhe Tashkoja, si figurë me pozicion shoqëror të caktuar, është “produkt” i një momenti të veçantë historik; moment që ndikon në lindjen e klasës së re borgjeze, klasë kjo që pozicionohet ndërmjet aristokracisë dhe fshatarësisë dhe që bëhet promotore e një organizimi të ri shoqëror dhe të idologjisë politiko-kulturore, që do të mund ta propagandonte në pjesën tjetër të shoqërisë; bëhet fjalë për *Shtetin Kombëtar* dhe *Nacionalizmin*. Ishte kjo periudha ku lulëzuan shkencat nacionaliste si *Historia kombëtare* dhe *Filologjia*, të cilat kishin për qëllim të ndërtonin origjinat e kulturave dhe grupeve etnike. Sigurisht që “hambari” nga ku do të dilnin shkencëtarët e rinj ishte klasa e borgjezisë, e cila e kishte lidhur ekzistencën e saj duke u legjitimuar nëpërmjet kësaj ideologjisë të re. Siç e dimë Thimi Mitkoja është ndër të parët mbledhës (në mos “Babai”) të folklorit shqiptar, por edhe një aktivist i zellshëm i çështjes kombëtare shqiptare. Ndërsa, nga ana tjetër, Athanas Tashko ndoshta nuk shkëlqeu në lëmin e krijimtarisë kulturore, por nga ana tjetër ishte shumë determinant

¹¹ Për më shumë informacione mund të konsultoni artikullin e Sokol Suparaku. *Thimi Mitko si aktor i epokës moderne dhe i përhapjes së nacionalizmit*, në përmbledhjen e materialeve të “Konferencës Shkencore Ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos, në 195 vjetorit e lindjes”, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, Mars 2015, f. 539-545.

me diskursin e tij politik, në kuptimin më të gjerë të fjalës. Është ky profil, i nxjerrë nga diskursi i tij, që e bën Tashkon një burim të vyer për sociohistorianin, që përpiket të hedhë dritë mbi këtë periudhë historike.

Kështu pra dimë që Tashkoja ishte një *mecenat* i çështjes kombëtare shqiptare, sepse ishte publikuesi i Gazetës “Shkopi”, që dilte pa pagesë. Siç e thotë dhe vetë emri i gazetës, kjo ishte një lloj “arme” që Tashkoja, bashkë me Jani Vruhon, e përdorte për të goditur ata që ishin kundër ose nuk punonin mjaftueshëm në propagandimin dhe realizimin e idealit kombëtar, që ishte qëllimi kryesor i tyre.

Se sa i mirinformuar ishte ai në lidhje me realizimin e projektit nacionalist të sendërtimit të identitetit kombëtar, na e tregon gjuha e përdorur në gazetën “Shkopi” ku kishte zgjedhur një shqipe të shkruar që mund të quhej një lloj gjuhe letrare, e kuptuar nga të gjithë bashkëkombasit e tij (Koço,2015:19).

Përshkrimet e profesor Nasho Jorgaqit, ndërsa flet për Nolin, na japin informacione mbi mënyrën e jetesës së Tashkos dhe preferencat kulturore që tregonte mënyra e tij e jetesës prej borgjezi i lidhur ngushtë me atdheun e tij: “*që mbante herë pas here papion dhe kapele republike, por që kish mbetur rrënjë prej Frashëri të Dangëllisë dhe kish hedhur farën e shqiptarizms në Fajum*”. Gjithashtu, ai traditën kombëtare ua kishte mësuar dhe fëmijve të tij, siç ishte të mësuarit e kënduarit e gjuhës shqipe, përdorimi i kostumeve kombëtare si tirqet dhe fustanella, apo njohja e valleve shqiptare. Por aq i fortë ishte ideali kombëtar i Tashkos sa Jorgaqi arrin ta konsiderojë si udhëheqës shpirtëror të Nolit në çështjen e shqiptarizms (Jorgaqi, 2005:123-124).

Por çna ofron tjetër diskursi politik i Tashkos në lidhje me zhvillimet politike përjashtuese që po krijonte në mënyrë të pandalshme procesi i nacionalizimit të popujve ballkanikë dhe të atij shqiptar në veçanti? Edhe njëherë tjetër, theksojmë se terreni më i mirë për të nxjerrë në pah këtë proces *tjetërsimi* midis popujve fqinjë, të cilët deri në momentet për të cilët po flasim jetonin në një territor gjeografik dhe kulturor të përzier, është ai marrëdhënies greko-shqiptare. Në këtë kontekst, shembulli i Tashkos do të kuptohej më mirë nëse i referohemi edhe njëherë shembullit të Thimi Mitkos, i cili, në fillimet e veprës së tij prej intelektualit rilindas, e konceptonte zhvillimin e shoqërisë shqiptare, pra nga pikëpamja politike dhe kulturore, si të lidhur ngushtë me zhvillimet e shoqërisë greke; ky ishte thelbi i mesazhit që ai i përcillte në “Hyrjen” e “Bletës Shqiptare”, ndërsa kritikonte qëndrimin armiqësor ndaj gjuhës shqipe që vinte nga disa qarqe të shoqërisë greke,

ose më saktë nga politika “*e kalbur e pikëpamjes së padenjë të idesë së madhe*”. Por, vazhdonte Mitkoja, “*po të mësohej shqiptari në gjuhën e tij amtare nga mësonjësit dhe kleri me mendime greke, edhe në qoftë se mbillej tek ay idea greke me gjuhën, e tij shqipe, që flitet, kishte për të zënë rrënjë ay patriotizmi grek edhe dija e vetëtijat aqë shumë sa të ishte i zoti të mbrojë atdheun e tij [...] edhe kombësinë greke dhe [do ta mbështeste mëndjen] te mëma Greqi, duke sjellë ndërmend gjyshërit e tij epirotët dhe maqedonët*”(Haxhihasani, 1981: 61).

Mirëpo këto projekte të një nacionalizmi qytetar, ku etnitë e ndryshme ballkanike do të emancipoheshin dhe do të organizoheshin në *Nacione* multietnike nën shembullin iluminues që vinte nga Greqia e lashtë pagane dhe e konceptuar si laike, do të shuheshin nga avancimi i një shteti grek , politika ekspansioniste (karakteristikë e nacionalizmit evropian të asaj periudhe) e të cilës ndikohej nga ideologjia imperialiste e Megali Idesë e cila, në rastin e Shqipërisë, nuk pranonte ekzistencën e një kulture shqiptare të denjë për vetëqeverisje dhe vetorganizim shoqëror. Kjo ishte arsyeja që Mitkoja, më vonë, do të punonte politikisht për formimin e një identiteti dhe nacionalizmi ekskluzivisht shqiptar dhe të pandërthurur me kulturën greke (Suparaku, 2015: 539-545).

Nëse Thimi Mitkoja është pararendësi i diskursit që trajton marrëdhëniet midis identitetit shqiptar dhe e atij grek, Athanas Tashkoja duket sikur simbolizon shkallën e fundit të këtij evolucioni ideologjik dhe politik, ku ndjenja e një përkatësie kulturore të përbashkët dhe ideja e një entiteti politik të përbashkët mes shqiptarëve dhe grekëve, tashmë po shkon drejt fashitjes përfundimtare si “variabël” ideologjike e konsiderueshme në lidhje me transformimet socio-kulturore në të cilat ishin përfshirë shoqëritë greke dhe shqiptare. Ndër të tjera, si referencë e këtij pozicionimi, vlen të citojmë një histori të pashkruar, të sjellë nga Eno Koço, kur Tashkoja, me rastin e “*një feste që bëhej në Misir, Fajum, si kudo gjetkë edhe në hotelin e Athanasit ishin ngritur flamujt e kombeve të ndryshëm. [por kur] konsulli grek e pyeti Tashkon se përse nuk ndodhet flamuri grek mes atyre të kombësive të tjera, ky i fundit i tregon nevojtoresh ku ishte flamuri, shenjë kjo e protestës e padrejtësive që herë pa here bëheshin ndaj shqiptarëve*” (Koço, 2015: 52-53). Ose vlen të përmenden rastet kur i kundërvihet qëndrimeve filogreke të bashkëkombasve të tij intelektualë që vepronin në Egjipt, si në rastin e mëposhtëm:

Është e ditur sé llauxi (populli) do kryé krerë në Egjyptë dhe janë këta që thamë, po këta u ndodhë njëri Grekoman gjer në palcë, tjatri

intéresar i prapë. I pari e heq llauxë andëj nga nuk i pëlqen, i dyti é shtyn lark tija nga frika sé mos arçohet dhé ay, kështu pra dhe llauxi é humbi toruan, u loth, dhé u shti në gjumë të rëndë.

Éshtë é vërtetë sé llauxi ka në trup të tij ca gdhenjë që nukë gdhëndënë dot as mé sëpatë. Po në të kujt llauxi trup nuku ka? Këtë shembëll é sjëll për Z. Dr. G. Adhamidhi, i cili dukét se është mëmëdhetar i vërtetë, dhé i cili, po të dojë që të përpiqét me zëmërë të qëruar, munt të dalë gjë é mirë në shésht. Sa për Dr. M. Turtullin, nuku kam kohë për të humbur (“Dora”, Cairo 17 Korik 1906; cit., in. Koço,2015: 97).

Dhe nuk është hera e vetme që do të denoncojë po të njëjtët persona, me po të njëjtat akuza, ku spikat ajo e “grekomanit”, por edhe ajo e intelektualit “interesaxhi”: *“Sa për Adhamidhin dhe Turtullin, kush ju tha se këta zotërinj munt të bëhenë krerë? Që të dy s’duan se s’janë të zotërit për një të këtillë trimëri. Turtulli është Grékoman dhé s’hyn faré në hësap. Adhamidhi prapë është bésnik i një fëjë që quhét “viç i florinjte” (po aty, cit: 98). Dhe kjo këmbëngulje e Tashkos nuk duhet marrë si një mëri personale ndaj të dyve, siç do të shprehej Noli, por si një pasojë e karakterit të tij të drejtpërdrejtë besnik, deri në fund, ndaj idealeve vetjake, duke kundërshtuar pa kompromis qëndrimet e kundërta. Kjo mund të kuptohet edhe nga fakti se, siç do ta shprehej ai vetë në fillim të publicistikës së tij kur do të themelonte “Shkopin”, çështjen e mërisë do ta eliminonte që në krye të misionit të gazetës e cila: “Mpron të drejtat e kombit shqiptar. Lëvdon ata që janë për të lëvduar dhe qorton ata që janë për tu qortuar në punëra kombësie; në mërirë të veçanta nuk ngatëronet” (po aty). Kësaj deklaratë ai do t’i qëndrojë besnik disa vite më pas, kur thotë se atdhetaria e tij “nuk’ është për reklamë, për qejf, a për interes, është detyrë njeriu me ndjenja të njerëzinjta” (Letr’ e hapët, S. Koleas, “Liri e Shqipërisë” 20 Maj 1912; cit., in. Koço,2015: 90).*

Njëkohësisht, nuk besojmë se Tashkoja kishte ndonjë ndjenjë urrejtjeje ndaj kulturës dhe popullit grek. Kundërshtitë e tij drejtoheshin absolutisht kundër politikave antishqiptare të kujtdo shteti qofshin. Kjo bindje e jona përforcohet nga një dëshmi interesante që hasim në një fragment të diskursit politik të Tashkos. Kështu, teksa debaton me një bashkëkombas të cilin e akuzonte si “tradhtar” të quajtur Skënder, i cili me shumë mundësi duhet të ishte drejtues in një gazete të quajtur “Pellazgosi”, që botohej në Korçë, Tashkoja do të na japë, ndoshta për të parën herë, konceptin e *kombit osmanlli*:

Tani pyesim Skënderë, i cili [në gazetën “Pellazgosi”] qahetë nga e ndershimja gazeta jonë “Lirija” sepse i tha tradhëtor: Është tradhëtor i kombit Osmanlli ajy që vë spica midis kombevet të ndryshmë të kësaj mbretërie për të mos u bashkuarë kurrë: apo jo? Pyesim edhe qeverinë tënë: Ky është’ ajy nomi që bëri kabineti vjet për shtypin; që të mos sjellë ky me të shkruarat e tia grindje dhe çarje midis racave të ndryshme të Turqisë? (“Liri e Shqipërisë”, 10 Mars 1911, f. 3.in. Koço,2015:102).

Pra, pothuajse një vit e gjysmë para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Tashkoja bëhet mbrojtës i lirive dhe dinjitetit të kombeve të ndryshme që përbënin shtetin osman, duke treguar edhe besnikëri ndaj këtij “kombi”, i cili, sigurisht nënkupton një besnikëri ndaj “shtetit osman”.

Pra kemi të bëjmë me atë që në literaturën studimeve *moderniste/konstruktiviste*, quhet “nacionalizëm zyrtar”,- më saktë besnikëri e bazuar në një identitet shoqëror që mbështetet më shumë në përkatësinë politike dhe që prodhon një qëndrim patriotik që është i ndryshëm nga ai nacionalist, pa mohuar përkatësinë etnike (Hobsbawm, 1996). Sigurisht me këtë nuk duhet kuptuar që Tashkoja mund të ishte kundër mëvetësimit politik të Shqipërisë. Ky ishte sigurisht qëllimi i rilindasve të sojit të Tashkos, që punonin për zgjimin e identitetit kombëtar shqiptar, por që në atë kohë ndoshta kufizoheshin thjesht më këtë konstrukt kulturor. Gjithashtu, në fragmentin e mësipërm, është me rëndësi fakti se ndryshe nga sa *imagjinata historike* se shoqëria shqiptare është mësuar të kultivojë në lidhje me ekzistencën e një identiteti otomanist që manifestohej ekskluzivisht nga masat e popullsisë se thjeshtë, më saktësisht atyre të besimit islam dhe me përqëndrim një një rajon të caktuar të territorit shqiptar, shihet se ky identitet manifestohet edhe nga një intelektual, por ndoshta edhe nga të tjerë, i cili për nga origjina i përkiste besimit kristian-ortodoks, që si “fe” kulturore të tij kishte zgjedhur nacionalizmin, qoftë në versionin *qytetar* qoftë në atë etnicist.

Me shumë mundësi zhvillimet politike shqiptare në prag të shpalljes së Pavarësisë duhet të kenë shkaktuar ndonjë përmbysje të pritshmërive që shoqëria shqiptare kishte ndaj të ardhmes politike të vendit të tyre. Këtë e nxjerrim edhe njëherë tjetër nëpërmjet Tashkos, i cili na jep një përshkrim të vyer të procesit historik të vetëdeklarimit ose të vetëpërcaktimit politik dhe kulturor të popullsisë ortodokse shqiptare në kapërcyell të shekujve XIX-XX. Kështu, ndërsa polemizon sërish me gazetën “Pellazgosi” dhe në mënyrë të veçantë me personin e Skënderit,

zbulohet se ky i fundit na kishte filluar të deklarohej në favor të pavarësisë kulturore të shqiptarëve nga patronazhi grek. Pra, në këtë rast, Tashkoja shkruan si më poshtë:

Nuku di or zotërinj, pse u habita kaqe shumë kur lëçita Pellazgonë No. 51 (16). Ndofta sepse pashë të mpronjë Skënderi (?) gjuhën shqipe duke kërkuar leje nga Grekëtë e Korçësë që të thuhet Ungjilli edhe në gjuhën Shqipe. Dhe ndofta atere mu duk si kur se digjova nga një goj gallofi, zë prej Bilbili. Dhe prandaj u habita dhe po habitem dhe pyes vetë vehten: Vallë ç' e bëri Skënderë të kthejë fletënë? Pse Skënderi këtë radhë, këndoj si Bilbil? [...]Mirë po nga nonjerë them edhe se: Skënderit i ngjau si dhe neve, do-methënë ishte grekoman, po tani u bë shqipëtar si ndë kur është, edhe ryri (pak si vonë po neise) në udhën e Perëndisë dhe prandaj zuri të këndonjë edhe ay bilbilçe. Se mos dhe na Shqipëtarët e sotmë nuku këndonim para se të ryjmë në udhën e drejtë? Gallofçe dhe Guakçe? ("Koha", Korçë, 6 Prill 1912, (No. 8), Koço,2015: 102).

Përveç sa thamë më sipër, në këto rreshta, marrim dhe një informacion të vyer nga deklaratat e ndershme dhe të singerta të Tashkos. E kemi fjalën për procesin e fenomenit të tranzicionit të identitetit të shqiptarëve, që siç thotë Tashkoja, nga "grekomanë" u bënë "shqipëtarë" duke ndjekur "udhën e Perëndisë", pra duke ndjekur atë që mund të quhet "evolucioni natyral" i vetëpërcaktimit etnik.

Interesant është fakti se si Tashkoja bën ndarjen etike midis gjuhës greke dhe shqipe duke përdorur ironikisht cilësimet: "bilbilçe" për të kënduarit shqip dhe "gallofçe/guakçe" për të kënduarit greqisht, por ndoshta edhe për të kënduarit turqisht. Kjo është edhe dëshmia më e mirë e evolucionit të vetëpërcaktimit etnik, pra të ndjenjave nacionaliste, që karakterizonte një pjesë të popullit shqiptar deri afër shpalljes së Pavarësisë, por ndoshta edhe disa kohë pas. Për këtë arsye, Tashkoja do të vazhdojë polemikën me "Skënderin" e "Pellazgosit", kur do të denoncojë disa qëndrime që hasen në disa pika të rregullores (kanonizmes) së Mitropolisë së Korçës. Kështu Tashkoja nuk është dakort me faktin se: "Nyj' e parë thotë: Komunitatea Elinike Orthodhokse e Korçës formohetë (bëhetë) nga gjithë Orthodhoksët e krishterë Elinë". Mirë, po ata orthodhoksë të krishterë shqipëtarë të Korçës që nuku janë Elinë!? Pra bëhet fjalë për kërkesa që kanë të bëjnë me nevojën për pavarësi kulturore absolute, gjë shumë e nevojshme për dinjitetin kulturor të "Kombit".

Ndërsa në akuzat ndaj pikës së 7 të "Kanonizmës", Tashkoja do të prekë problemin e pavarësisë ekonomike të komunitetit ortodoks të Korçës: "Krerët e

Llasos duhet të jenë vënë në Bankën Kombëtare të Greqisë a në nonjë bankë tjetër Greke”. Mirë, përse zotëni duhet (!!!) të jemi vënë në bankët e Greqëve? Kaqë të sakta janë Bankatë Greke? Pa dhe pse? Parat’ e Korçës e të Korçarëve, t’i punojnë Greqëtë, e të mos i punojnë Korçarëtë? Më bataqçinj se Greqëtë janë Korçarëtë?

Edhe kjo, si pika e parë, për Tashkon, si për çdo nacionalist të kujtdo kombi tjetër, është një pikë kyçe e kombformimit, sepse pavarësia ekonomike është baza e ekzistencës e çdo shteti-komb. Pa këtë pavarësi do të ishte e pakonceptueshme edhe vetë ideja e “kombit”.

Në fakt, këtë na e shpjegon edhe vetë Tashkoja, kur i kundërvihet pikës 8 të “Kanonizmës” e cila kërkonte që: *“Tepëricat e fajdeve, të ardhurat e kishave, qiratë e dyqaneve, shtëpive, e çdo mylku¹² që ka Lasoja në Korçë, dhuratat që dhurojnë bota për shkollat e Korçës, duhen të vihenë dhe ata ashtu në një Bankë si ndë kur thotë Nyji 7 (“Koha”, Korçë, 16 Prill 1912, No. 9). Kjo për Tashkon, dhe për këdo që ndante të njëjtat parime me të, ishte e papranueshme sepse ishte kundër zhvillimit të arsimit dhe kulturës në gjuhën kombëtare. Sigurisht, që kjo politikë ndërhyrëse e Patriarkanës do të shihej nga Tashkoja si një imperializëm i ri ekonomik dhe kulturor që rrezikonte rritjen dhe zhvillimin e grupeve shoqërore ,të cilat e lidhnin fatin e tyre me liritë e reja politike që rridhnin nga njohja me ligj e lirive fetare dhe kombëtare, pra nga konsolidimi i parimit të identitetit etnik në gjirin e perandorisë osmane, gjë që disa muaj më pas do t’i mundësonte edhe popullit shqiptar të krijonte shtetin e tij, pra të realizonte programin e nacionalistëve shqiptarë, ndër të cilët sigurisht bënte pjesë dhe Athanasi.*

Si përfundim duhet të theksojmë se rasti i Athanas Tashkos, me aq sa patëm mundësi ta trajtonim në këtë punim, na ofron një panoramë socio-historike nga ku studiuesi i historisë moderne shqiptare, por edhe ballkanike, mund të zbulojë një realitet social shumë ndryshe nga ajo që shkenca historike tradicionale ka ofruar deri më tani në lidhje me ndërgjegjen etnike të popullit shqiptar.

Realiteti historik që përftojme nga studimi i jetës dhe veprës së Tashkos, është ai i një shoqërie ballkanike në fazën e zierjeve nacionaliste, kur koncepti i shtetit-komb të pastër etnikisht, i bazuar në veçantinë e racës dhe gjuhës, kishte filluar të fitonte terren kundrejt versionit pararendës. Gjithsesi, ky rast na tregon se në kontekstin shqiptar, ndoshta nacionalizmi etnik nuk ishte në pozita mbizotëruese as

¹² pronë.

në mentalitetin e asaj pjese të shoqërisë së lartë që ishte e impenjuar në ndërtimin e “kombit”, aq më pak pranë shtresave të ulta të popullsisë.

Gjithashtu, ky rast na jep edhe një shembull se si nacionalizmi dhe identiteti etnik shqiptar lindin dhe forcohen jo si një formë e vetme dhe përjashtuese ndaj të tjerave, siç ishte helenizmi dhe otomanizmi, por si pjesë përbërëse e këtyre të fundit. Vetëm me rritjen e etnicizmit , edhe në gjirin e helenizmit dhe otomanizmit lindën dhe instancat e shkëputjes së nacionalizmit dhe identitetit shqiptar prej tyre.

Bibliografia

- Haxhihasani, Q. (1981). Thimi Mitko. *Vepra*. Tiranë: ASH.
- Hobsbawm, E. J. (1996). *Kombet dhe nacionalizmi nga 1789. Programi, miti, realiteti*. Tiranë: Toena.
- Jorgaqi, N. (2005). *Jeta e Fan S. Nolit*, vol 1. Tiranë: Ombra-GVG.
- Koço, E. (2015). *Athanas Tashko*. Tiranë: Botime Flesh.
- Suparaku, S. (2015). *Thimi Mitko si aktor i epokës moderne dhe përhapjes së nacionalizmit*. Konferenca Shkencore Ndërkombetare kushtuar Jetës dhe Veprës së Thimi Miktos në 195 vjetorin e lindjes (p. 539-545): Universiteti "Fan Noli", Korçë.
- Tashko, A. (1906, Gusht 11). *Letër nga Misiri*. Kombi.
- Tashko, A. (1911, Mars 10). *Dy fjalë për “Pellazgosin” e Skënderit të Korçës dhe për qeverinë tonë osmane*. Liri e Shqipërisë, p. 3.
- Tashko, A. (1912, Prill 16). *Koha*.
- Tashko, A. (1912, Maj 20). *Letr’ e hapët, S. Koleas*. Liri e Shqipërisë.